



**AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË  
NË ROLIN E  
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS**

**RAPORTI I VEÇANTË VJETOR  
2015**

**Tiranë 2016**

Publikimi i këtij botimi u mundësua financiarisht nga Programi Danez i Fqinjësisë



The Danish Neighbourhood Programme

## TABELA E PËRMBAJTJES

1. Kuadri ligjor i funksionimit të MKPT-së .....	5
2. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet.....	6
3. Vizitat monitoruese, ecuria e çështjeve mbi rastet e dhunës dhe rekomandimet.....	8
3.1. Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare.....	8
3.2. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare.....	11
3.3. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore.....	14
3.4. Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura.....	15
3.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike.....	16
3.6. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra.....	17
3.6.1. Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve.....	17
3.6.2. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç.....	18
3.6.3 Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë.....	18
3.7. Niveli i respektimit të drejtave të personave në drejtoritë e policisë kufitare dhe komisaritet e stacionet e varësisë.....	19
4. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektiveve të kryera gjatë vitit 2015 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.....	20
4.1. IEVP Vaqarr - Datë 24.02.2015.....	20
4.2. Instituti i të Miturve Kavajë - Datë 26.03.2015.....	22
4.3. IEVP Durrës - Datë 09.04.2015.....	23
4.4. IEVP “Mine Peza” 302 Tiranë - Datë 21.04.2015.....	24
4.5. IEVP Zahari, Krujë - Datë 04.05.2015.....	26
4.6. IEVP Drenovë, Korçë - Datë 07.05.2015.....	28
4.7. IEVP “Ali Demi” (325), Tiranë - Datë 15.05.2015.....	30
4.8. IEVP Lezhë - Datë 11.06.2015.....	31

<b>4.9. IEVP Kukës – Datë 16.06.2015.....</b>	<b>33</b>
<b>4.10. IEVP Tropojë - Datë 17.06.2015.....</b>	<b>34</b>
<b>4.11. IEVP Peqin - Datë 08.07.2015.....</b>	<b>35</b>
<b>4.12. IEVP Berat – Datë 02.09.2015.....</b>	<b>37</b>
<b>4.13. IEVP Burrel – Datë 28.09.2015.....</b>	<b>39</b>
<b>4.14. IEVP Tepelenë – Datë 05.10.2015.....</b>	<b>41</b>
<b>4.15. IEVP Sarandë - Datë 06.10.2015.....</b>	<b>42</b>
<b>4.16. IEVP Elbasan - Datë 15.10.2015.....</b>	<b>43</b>
<b>4.17. IEVP Rrogozhinë - Datë 21.10.2015.....</b>	<b>45</b>
<b>4.18. IEVP Vlorë - Datë 22.10.2015.....</b>	<b>47</b>
<b>4.19. IEVP Kosovë, Lushnjë – Datë 11.11.2015.....</b>	<b>48</b>
<b>4.20. Institucioni i Veçantë Mjekësor i Burgjeve, Tiranë - Datë 25.11.2015.....</b>	<b>50</b>
<b>4.21. Rekomandim mbi transferimin e menjëhershëm të të arrestuarve dhe të dënuarve në seksionet përkatëse të IEVP sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi - Datë 03.09.2015.....</b>	<b>51</b>
<b>5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 në Drejtoritë e Policisë Vendore dhe në Komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>53</b>
<b>5.1. Komisariati i Durrësit - Datë 28.05.2015.....</b>	<b>53</b>
<b>5.2. DPV Shkodër dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>54</b>
<b>5.3. DPV Dibër dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>55</b>
<b>5.4. DPV Kukës dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>57</b>
<b>5.5. DPV Berat dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>58</b>
<b>5.6. DPV Korçë dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>59</b>
<b>5.7. DPV Gjirokastrë dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>61</b>
<b>5.8. DPV Elbasan dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>63</b>
<b>5.9. DPV Vlorë dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>64</b>
<b>5.10. DPV Fier dhe komisarariatet e varësisë.....</b>	<b>64</b>
<b>5.11. Komisariati nr.3, Tiranë – Datë 19.11.2015.....</b>	<b>66</b>
<b>5.12. Komisariati nr.6, Tiranë – Datë 19.11.2015.....</b>	<b>67</b>
<b>5.13. Komisariati nr.1, Tiranë – Datë 23.11.2015.....</b>	<b>68</b>
<b>5.14. Komisariati nr.4, Tiranë – Datë 23.11.2015.....</b>	<b>69</b>

5.15. Rekomandim për fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësit të Policisë A.P, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, Datë 08.08.2015.....	70
6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 në Forcat e Armatosura .....	74
6.1. Informacion për inspektimin e kryer në Repartin Ushtarak nr.1010, Vau i Dejës Shkodër - Datë 03.06.2015.....	74
6.2. Policia Ushtarake Sauk, Tiranë - Datë 18.11.2015.....	74
7. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 në Spitalet Psikiatrike .....	75
7.1. Shërbimi i Psikiatrisë, QSU, Tiranë, – Datë 04.03.2015.....	75
7.2. Shërbimi i Shëndetit Mendor me Shtretër, Shkodër, – Datë 02.06.2015.....	76
7.3. Spitali Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan - Datë 16.10.2015.....	77
7.4. Spitali Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë – Datë 23.10.2015.....	79
8. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera, gjatë vitit 2015, në Qendra.....	80
8.1. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç – Datë 18.03.2015.....	80
8.2. Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç - Datë 19.03.2015.....	81
8.3. Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, Babrru, Tiranë - Datë 17.09.2015.....	84
8.4. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, Linzë - Datë 25.09.2015.....	85
9. Rekomandime të dërguara në bazë të inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015, në Drejtoritë e Policisë Kufitare dhe komisariatet dhe stacionet e varësisë.....	86
9.1. Rekomandim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin.....	86
9.2. Rekomandim mbi marrjen e masave të menjëhershme dhe të nevojshme për trajtimin në përputhje me instrumentet kombëtare e ndërkombëtare të flukseve ekzistuese dhe atyre të pritshme të migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri, - Datë 30.03.2016.....	91
Aneks 1.....	96
Aneks 2.....	100

# AKTIVITETI I AVOKATIT TË POPULLIT TË SHQIPËRISË NË ROLIN E MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

## RAPORTI VJETOR 2015

### 1. Kuadri ligjor i funksionimit të MKPT-së

Institucioni i Avokatit të Popullit është përcaktuar nga Parlamenti si autoriteti i duhur për garantimin e funksionimit profesional dhe të pavarur të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Ngritja e MKPT-së është parashikuar në ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, ndërkohë që njohja ligjore e saj, si strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në ushtrimin e detyrave të tij të njohura nga legjislacioni vendas, udhëhiqet edhe nga parime e instrumente të sanksionuara në legjislacionin ndërkombëtarë si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollat e saj shtesë, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996; Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimin Mizor, Çnjerëzor e Degradues, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 7727, datë 30.06.1993; Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003; Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8135, datë 31.07.1996. Lista me këto instrumente të drejtave që udhëheqin punën e Mekanizmit nuk është shteruese, pasi ka një sërë rekomandimesh, veçanërisht të Këshillit të Evropës, të cilët janë të rëndësishëm në garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. Megjithatë, këta instrumente janë “gurët e themelit” për punën tanimë disa vjeçare të MKPT-së në Shqipëri. MKPT funksionon në përputhje me legjislacionin vendas, që është një mjet në duart e qytetarëve shqiptarë për të gëzuar të drejtat e tyre të sanksionuara në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”; Ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; Ligjin Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 437, datë 20.5.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”; Ligjin Nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin Nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”; VKM-në nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”. Sërisht, kjo nuk është një listë shteruese, pasi ka një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave, si edhe manuale dhe dokumente të tjera pune, zbatimimi i të cilave është një garanci për gëzimin e të drejtave.

## **2. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet**

Gjatë vitit 2015, MKPT ka funksionuar me një strukturë multidisiplinare të përbërë nga pesë ndihmëskomisionerë, pjesë e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë, prej të cilëve tre ekspertë ligjorë, një mjeke psikiatre dhe një psikologe klinike. Me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikohej që MKPT do të drejtohej nga një Komisioner, ndaj gjatë vitit 2015 Avokati i Popullit ka shpallur disa herë konkurrimin për vendin vakant të Komisionerit, por për shkak të mungesës së numrit të nevojshëm të kandidaturave pjesëmarrëse, si dhe të mosplotësimit të kriteve profesionale, procesi i përzgjedhjes së kandidaturave për Komisioner nuk ka qenë i mundur të realizohej.

Prej fillimit të tetorit të vitit 2014 deri në përfundim të tetorit të vitit 2015 MKPT-ja Shqiptare nën drejtimin e Avokatit të Popullit, kryesoi me sukses Rrjetin e MKPT-ve të Evropës Juglindore, rrjet ky i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në përmbushje të qëllimit të këtij rrjeti të specifikuar edhe në OPCAT për rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një realizim sa më të qenësishëm të mandatit të MKPT-ve në rajon, MKPT-ja shqiptare realizoi në Tiranë dy seminare dhe një konferencë. Seminari i parë, me titull “Shërbimet Shëndetësore të ofruara ndaj personave të privuar nga liria në rajonin e Evropës Jug-Lindore: Problematikat dhe arritjet e evidentuara gjatë ushtrimit të mandatit të mekanizmave si dhe sfidat për parandalimin e keqtrajtimit gjatë përdorimit të kufizimit fizik dhe izolimit”, i zhvilluar më datë 29-30 qershor 2015, mbledhi së bashku grupin mjekësor të rrjetit. Seminari i dytë me titull “Sfida, shqetësime, dhe nevoja për standarde të përbashkëta monitorimi të Mekanizmave të Evropës Jug-Lindore në kontekstin e Migracionit” i zhvilluar më datë 29 Tetor 2015, mbledhi së bashku grupin juridik të rrjetit. Konferenca “Drejt standardeve të përbashkëta të monitorimit të trajtimit të Azilkërkuësve, Refugjatëve dhe Emigrantëve të paligjshëm në Evropën Jug-Lindore”, zhvilluar më datë 30 tetor 2015 adresoi çështjen emergjente të migracionit të paligjshëm. Në të tre këto aktivitete ndërkombëtare morën pjesë jo vetëm përfaqësuesit e Rrjetit, por edhe përfaqësues të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor ose Poshtëruës, apo Ndëshkimit (CPT), Nën-Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruës (SPT), Shoqatës për Parandalimin e Torturës (APT), Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional të Kufijve të Jashtëm të Vendeve Anëtare të Bashkimit Evropian (Frontex), Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2015, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta, dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it. Vlen për t'u përmendur këtu pjesëmarrja e MKPT-së në Konferencën e organizuar Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (CPT), me rastin

e 25 përvjetorit të saj, që u zhvillua më 2 Mars 2015, në Strasburg, Francë, ku u diskutuan çështje me rëndësi të veçantë të tilla si lufta kundër mosndëshkimit në polici dhe në burgje, kujdesi shëndetësor në burgje, të miturit në paraburgim, dhe izolimi dhe standardet e CPT-së në psikiatri. Bashkëpunim tjetër me rëndësi gjatë vitit 2015 ka qenë ai i vendosur me Ombudsmanin Danez dhe MKPT-në brenda tij, Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut, si dhe Institutin Shëndetësor Danez kundër Torturës, veçanërisht gjatë vizitës studimore të kryer me mbështetjen e Projektit DANIDA, më datat 29 Mars - 2 Prill, vizitë gjatë të cilës u inspektua paraburgimi dhe komisarati më i madh në Danimarkë.

Gjatë vitit 2015 Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEx, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riadhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen me qëllimi transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riadhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues gjatë operacioneve të riadhesimit duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor dhe kushtetues si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2015 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile të specializuara në fushën e mbrojtjes të të drejtave të personave të privuar nga liria në vend. Bashkëpunim i frytshëm ka rezultuar ai me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në kuadër të Projektit “Matra” ku së bashku me Komitetin Holandez të Helsinkit, QSHRT dhe MKPT e Republikës së Kosovës po punohet në drejtim të përmirësimit të kushtëve dhe trajtimit të të miturve në qendrat e paraburgimit në Shqipëri dhe në Kosovë. Gjithashtu bashkëpunim të frytshëm ka pasur dhe me Shoqatën Përthyerje, ku falë këtij bashkëpunimi është arritur që të realizohen inspektive të përbashkëta, inspektive këto që kanë pasur një karakter multidisiplinor dhe të thelluar si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisarate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to. Po ashtu, si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv janë prodhuar një sërë materialesh promovuese (fletëpalosje, postera, manuale) si dhe janë mundësuar një sërë trajnimesh me fokus të drejtat e njeriut me punonjës të policisë së shtetit dhe me stafin e sigurisë, atë shëndetësor e psiko-social të administratës së burgjeve. Trajnimet e materialet promovuese kanë pasur si qëllim rritjen e njohurive mbi të Drejtat e Njeriut në njësitë policore, në burgje dhe paraburgime me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të tyre, përmirësimin e njohurive mbi Institucionin e Avokatit të Popullit dhe rolin e tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe informimin mbi mekanizmat e tjerë mbikëqyrës. Trajnimet për stafet e burgjeve po ashtu janë fokusuar mbi Konventat e ratifikuara për sigurimin e respektimit të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri dhe më gjerë, duke u ndalur kryesisht në aspekte të tilla si pranimi, regjistrimi, lëvizja dhe transferimi, klasifikimi dhe vendosja, mjedisi fizik dhe kushtet e jetesës, kujdesi shëndetësor, edukimi dhe punësimi, aktivitetet fetare, njoftimi për problemet shëndetësore, njoftimi për humbjen e një të afërmi dhe lejet e veçanta, kufizimi fizik dhe përdorimi i forcës, masat disiplinore, inspektimet dhe ankesat përkundrejt personelit, takimet me familjet dhe komunikimi, gratë në paraburgim, dhe grupet e vulnerabël.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2015 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave për shtyp, takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

Një rol të veçantë në kryerjen e detyrave funksionale të MKPT-së gjatë vitit 2015 ka patur ndihma financiare e përfituar në kuadër të Programit Danez të Fqinjësisë “Mbështetje danez për Avokatin e Popullit Shqiptar (2012-2015)”.

### 3. Vizitat monitoruese, ecuria e çështjeve mbi rastet e dhunës dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer 130 vizita, nga të cilat 83 vizita monitoruese të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve për vitin 2015, dhe 47 ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe hetime administrative, në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, bazat ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve. Më konkretisht:

Inspektime të parashikuara nga plani i miratuar	83
Inspektime të kryera mbi planifikimin vjetor	8
Monitorime / hetime mbi planifikimin vjetor	39
<b>Total vizita për vitin 2015</b>	<b>130</b>

I gjithë aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen brenda vitit kalendarik 2015 të 76 rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara.

Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t’u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

#### 3.1 Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare

Për rastet e tejkalimit të forcës të evidentuara gjatë inspektimeve apo nga ankesat e marra përmes postës e telefonit, MKPT ka bashkëpunuar në kryerjen e inspektimeve *ad hoc* me Seksionin e Veçantë pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbushje të funksioneve përkatësisht parandaluese e reaktive të dy strukturave.

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore, si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit. Duhet theksuar se kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut, për të mos ju nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor,



çnjerezor ose poshtërues, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerezore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera çnjerezore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250).

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie, që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, cenon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasoja në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai cenon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetaret për ti denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend.

Nga përvoja disa vjeçare e institucionit tonë rezulton se, punonjësit e Policisë së Shtetit të përfshirë në këtë fenomen, për nga hierarkia janë punonjës zbatues të nivelit të ulët dhe të mesëm, sikurse mund të përmendim punonjësit e patrullës së përgjithshme, specialistët e policisë së zonave dhe inspektorët e policisë kriminale (oficerët e policisë gjyqësore). Gjatë vitit 2015, janë administruar 42 ankesa ndaj organeve të Policisë së Shtetit për ushtrim të dhunës fizike nga ana e punonjësve të saj gjatë shoqërimit, arrestimit në flagrancë, ndalimit apo gjatë marrjes në pyetje në njësitë policore. Disa nga këto raste janë bërë publike nëpërmjet organeve të medias, të cilat i kanë marrë rastet në mënyra e forma të ndryshme, si drejtpërdrejtë, nëpërmjet filmimeve të bëra me aparatet e telefonave celular nga persona të afërm të të dhunuarve, apo edhe kalimtarë të rastit. Këto raste Institucioni i Avokatit të Popullit i ka marrë në shqyrtim me iniciativë. Nga çështjet e shqyrtuara janë zgjidhur në favor të ankuesve 10 ankesa, janë vlerësuar të padrejta 26 dhe janë nxjerrë jashtë juridiksionit 4 prej tyre.

Në rastet për të cilat është bërë e mundur të provohet ushtrimi i dhunës ndaj qytetarëve nga punonjësit e Policisë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organit të Prokurorisë, për fillimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale të “Torturës” dhe të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Në total janë bërë 9 rekomandime për fillimin e hetimeve, nga të cilat 1 rast për veprën penale të “Torturës” dhe 8 raste, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Ndërsa për 1 rast i është drejtuar rekomandim strukturave drejtuese të Policisë së Shtetit për dhënien e masës disiplinore. Nga rekomandimet e bëra për fillimin e hetimeve, 8 raste janë pranuar dhe për 1 rast nuk është dhënë ende përgjigje. Nga hetimi administrativ i rasteve të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit ka rezultuar se shkaqet e ushtrimit të dhunës nga punonjësit e Policisë së Shtetit janë të ndryshme. Disa prej tyre lidhen me mungesën e përgatitjes të përgjithshme dhe asaj profesionale, mosnjohje të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, moszbatimi i procedurave standarde gjatë kryerjes së veprimeve nga punonjësit e Policisë, presionit të disa drejtuesve për zbulimin me çdo mjet të

autorëve, vrasja dhe plagosja e punonjësve të policisë, në një pjesë të rasteve mosndëshkim administrativ dhe penal i autorëve të ushtrimit të dhunës, etj.

Në fillimin me iniciativë të rasteve të bëra publike në media për ushtrimin e dhunës fizike ndaj qytetarëve prej punonjësve të Policisë së Shtetit në mjediset e Policisë, apo jashtë tyre, pas hetimit të gjithanshëm të këtyre rasteve është rekomanduar fillimi i hetimit për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, për 9 raste. Persona të dyshuar në kryerjen e kësaj vepre penale kanë qenë kryesisht drejtues të Policisë së Shtetit si zv/drejtor policie, shefa komisaratesh dhe punonjës policie të rolit bazë. Ka risi sa i përket qëndrimit të mbajtur nga Avokati i Popullit, për zgjerimin e hetimit në lidhje me përgjegjësinë edhe të personave të tjerë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës nga drejtuesit e Policisë në dëm të qytetarëve. Duke pasur parasysh detyrimin ligjor të punonjësve të policisë, që nuk kanë marrë masa për të ndërprerë gjendjen e paligjshme, organit të Prokurorisë i është rekomanduar ndaj tyre fillimi i hetimit për veprën penale, “Mos marrja të masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Në trajtimin e rasteve të ankesave të dënuarve apo të paraburgosurve, kur ndaj tyre është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e Policisë së Burgjeve, mund të përmendim rastet e keqtrajtmeve të një të dënuari në IEVP “Zahari” Krujë, nga punonjësit e policisë së Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, apo të një të dënuari në IEVP Durrës, nga policët e grupit të gatshëm. Ndërkohë shumë prej çështjeve penale të filluara nga organi i Prokurorisë në bazë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, pushohen ose edhe kur pranohen e fillohet hetimi, ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale nga torturë në kryerje të veprimeve arbitrare, sepse kjo e fundit parashikon lloje dhe masë dënimi më të butë. Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Drejtuesit e Policisë së Shtetit:

- Bërjen e një analize të thellë të këtij fenomeni, nxjerrjen e shkaqeve të ndodhjes dhe vendosjen e detyrave konkrete për parandalimin e tij.
- Përgjithësimin e rasteve të dhunës dhe të masave të dhëna ndaj autorëve të tyre.
- Përmirësimin e kurrikulës të Shkollës Bazë të Policisë dhe të Shkollës së Lartë të Sigurisë (Policisë), duke i dhënë prioritet e pasuruar atë me më shumë tema, për njohjen dhe respektimin rigoroz të të drejtave të njeriut.
- Drejtuesit e Policisë së Shtetit në qendër dhe ata vendorë, duhet të punojnë më shumë me efektivat për të bërë të mundur njohjen e tyre me aktet normative të brendshme dhe ato ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe sidomos, me përmbajtjen e dispozitës së Kodit Penal, të ndryshuar, për veprën penale të “Torturës”. Ata duhet të marrin të gjitha masat organizative që kjo shkelje ligjore, e cila kryhet nga individ të caktuar në organet e Policisë të parandalohet dhe nëse ndodh të kallëzohet menjëherë prej tyre në organet kompetente.
- Drejtuesit e Policisë së Shtetit duhet të jenë shembulli pozitiv për vartësit e tyre dhe në publik, lidhur me korrektësinë në kryerjen e detyrës, në zbatimin e ligjeve dhe veçanërisht lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe trajtimin me dinjitet të qytetarëve, qofshin ata edhe autorë të veprave penale.
- Trajnimin në mënyrë të vazhdueshme nga ana psikologjike e punonjësve të Policisë së Shtetit me qëllim zbatimin e rregullave të sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të kontrollit të veprimeve të tyre gjatë kryerjes së detyrave ligjore edhe në rastet kur kundërshtohen verbalisht apo fizikisht, nga persona të ndryshëm.
- Qartësimin e të drejtës së përdorimit të forcës nga punonjësit e policisë për të përmbushur detyrën ligjore, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

- Mos promovimin dhe ngritjen në detyrë të punonjësve të Policisë, që kanë qenë autorë të përdorimit të dhunës ndaj qytetarëve.
- Nga titullarët dhe drejtuesit e tjerë të organeve vendore të Policisë të ushtrohet më shumë kontroll dhe të mbahet qëndrim në rastet e ushtrimit të dhunës ndaj qytetarëve, qofshin ata kundërvajtës administrativ, ose edhe autorë krimesh.

Ndërsa ndaj organeve të Policisë së Burgjeve janë administruar 20 ankesa, të bëra nga të paraburgosurit dhe të dënuarit për ushtrim dhune fizike e psikologjike në institucionet penitenciare. Nga ankesat e administruara kanë përfunduar 19 raste dhe është në ndjekje 1 rast. Për ankesat për të cilat kemi mundur të provojmë ushtrimin e dhunës nga punonjësit e Policisë së Burgjeve ndaj personave të paraburgosur, ose të dënuar penalisht me burgim janë bërë 2 rekomandime drejtuar organit të Prokurorisë, për fillimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Rekomandimet janë pranuar, por pas fillimit të hetimeve, organi i prokurorisë ka vendosur pushimin e procedimit penal. Gjithashtu, në 2 raste të tjera ku pretendohet se ishte ushtruar dhunë fizike në ambientet e IEVP-së 302 dhe IEVP Korçë, nga verifikimet ka rezultuar se këto ambiente ishin të pa monitoruara. Për këto arsye iu dërguan rekomandime institucioneve përkatëse për vendosjen e kamerave.

### ***3.2 Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare<sup>1</sup>***

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përrjashtim kanë bërë pengesa në ushtrimin e detyrës së ekspertëve të MKPT-së gjatë dy hetimeve të kryera në IEVP Lezhë dhe IEVP “Mine Peza”, me krijimin e vonesave në dhënien e aksesit për të marrë kontakt dhe shqyrtuar dokumentacionet përkatëse.

Në inspektimet e bëra gjatë vitit 2015 u vunë re një sërë problematikash të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Kushte fizike tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të IEVP Zahari Krujë, IEVP Sarandë, IEVP Tepelenë, IEVP Kukës dhe IEVP Burrel, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje janë konstatuar në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm dhe mungesës së investimeve, Avokati i Popullit rekomandoi mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Mbipopullim me një mesatare vjetore prej 25% mbi kapacitet. Ndikim në uljen e ndjeshme të mbipopullimit krahasuar me një vit më parë, ka pasur hapja e IEVP Fier dhe IEVP Berat, si dhe rikonstruksioni i IEVP “Jordan Misja”. Megjithatë problematike paraqitej situata në IEVP-të Lezhë, Krujë, Lushnjë, Rrogozhinë, Tepelenë, “Jordan Misja”, Burrel, Elbasan,

<sup>1</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Institucionet Penitenciare janë hartuar 20 rekomandime

Drenovë, Durrës, Kukës, Vlorë e Sarandë, të cilat funksiononin në pjesën më të madhe të kohës dukshëm mbi kapacitetin zyrtar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, nga një pjesë e IEVP-ve ishin marrë masa për shtimin e numrit të shtretërve, gjë që kishte pakësuar numrin e personave që flinin me shtroje përtokë, por që kishte sjellë si pasojë cenimin e standardeve të hapësirës jetike për person. Në disa prej IEVP-ve situata paraqitej edhe më problematike, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit ambientet e aktiviteteve të përbashkëta, observimi e izolimi ishin kthyer në ambiente banimi. Ndërkohë veçanërisht shqetësuese paraqitej situata në seksionin e observimit të IEVP Drenovë ku pjesa dërrmuese e personave qëndronin me shtroje përtokë e për ta ishte e pa mundur realizimi i ajrosjes.

- Mos zbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në IEVP, në kushtet kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe në problematikën e përgjithshme të mbipopullimit.
- Pretendime për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga disa punonjës të IEVP Burrel, IEVP Lezhë, IEVP Vlorë, IEVP Drenovë dhe IEVP “Mine Peza”. Ankesat e gjetura të bazuara u pasuan nga rekomandime ndaj IEVP-ve përkatëse dhe DPB-së për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Mbajtje e personave të cilët ishin dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat respektive, në disa prej IEVP-ve të parashikuara si institucione paraburgimi si dhe në seksionet e paraburgimit të disa IEVP-ve të tjera. Në disa raste këta të dënuar ishin vendosur në të njëjtat dhoma me të paraburgosurit, e për rrjedhojë të gjitha aktivitetet i kryenin bashkë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Procedura disiplinore që nuk zbatoheshin në mënyrë korrekte për të miturit në IEVP Vlorë ku vijonin të përdreshin penalizimet kolektive dhe përjashtimi i të miturve me masa disiplinore nga aktivitetet mësimore, duke mos marrë në konsideratë udhëzuesin administrativ të DPB-së.
- Probleme me ofrimin mundësisë për arsim. Në IEVP Lezhë, Lushnje, Tepelenë, Sarandë dhe Burrel, nuk ofrohej arsimi i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, përfshirë këtu Institucionin e Veçantë të të Miturve Kavajë, nuk ofrohej arsimi i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet përjashtuar IEVP Burrel bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore. Sa i përket IEVP Burrel, e drejta e uljes së dënimit për punën e kryer nuk njihet pasi ekzistonte një vendim gjyqësor i formës së prerë nga gjykata e rrethit Mat i pasuar nga një praktike shkresore midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe asaj Mat.

- Infrastruktura në pjesën më e madhe e I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin I EVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rogozhinë, Burrel, Sarandë, Lezhë, Tepelenë, “Mine Peza”, e në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve. Gjithashtu, ambientet e takimit me familjarët/ të miturit ishin të papërshtatshme. Përrjashtim bënin I EVP-të e reja dhe ato të ri konstruktura.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të I EVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi, apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatua plotësim në mënyrë formale i dosjeve psiko-sociale, sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale, të cilat ndonëse shënoheshin si të realizuara, realisht nuk rezultonin të ishin kryer.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përrjashtuar I EVP Vlorë, Berat, Fier, Durrës, dhe Elbasan, ishin përrgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Vonesa në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me libreta shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej I EVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I EVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes pothuajse në të gjitha I EVP-të ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit përdornin batanijet dhe teshat e fjetjes si të vetmet mjete ngrohjeje.
- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I EVP-ve.
- Mungesat në dollapë e raftë të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndesh kryesisht në I EVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, “Jordan Misja”, “Mine Peza”, Sarandë, Kukës e Tropojë.
- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të I EVP-ve.
- Mbetej shqetësuese thuajse në të gjitha I EVP-të cilësia dhe larmia e ushqimit.

### ***3.3 Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë policore<sup>2</sup>***

Inspektimet në njësitë policore kishin si qëllim vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikatat e ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore” miratuar me Urdhrin nr. 763, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe të verifikimit e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhënë gjatë vitit 2014. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përfundimisht kanë bërë pengesa në ushtrimin e detyrës së ekspertëve të MKPT-së gjatë një hetimi në DPV Tiranë, me vonesa në dhënien e aksesit, për të marrë kontakt dhe shqyrtuar dokumentacionin përkatës.

Nga inspektimet e kryera në organet e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

- Mbipopullim i konsiderueshëm në DPV Tiranë dhe në disa prej Komisariateve në varësi të saj, në Komisariatin e Policisë Korçë, Komisariatin e Policisë Fier, ku punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e ndaluar/arrestuar vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për arsye të mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimit fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë, sidomos ndaj atyre që dyshohen si autorë të veprave penale në Komisarimatet e Policisë nr. 2 dhe 5 Tiranë, në DPV Tiranë, në Komisariatin e Policisë Pogradec, si dhe në Komisariatin e Policisë Shkodër. Ankesat e gjetura të bazuara u pasuan nga rekomandime konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Mbajtje dhe trajtim i personave të paraburgosur ndaj të cilëve gjykatat respektive kishin dhënë vendime për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit. Po ashtu, në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit, mbaheshin dhe trajtoheshin persona të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-20 ditore.
- Moskryerje të detyrimeve ligjore nga personeli policor dhe ai shëndetësor që shërben në ambientet e sigurisë, për raportimin e rasteve ushtrimit të dhunës ndaj të arrestuarve ose të ndaluarve, në DPV Tiranë.
- Mos përmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të papastra, të palyera, të pa pajisura me orënditë e nevojshme (karrige, stola, tavolinë) ose edhe atje ku kishte të tilla, ato ishin të dëmtuara.

---

<sup>2</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Njësitë Policore janë hartuar 44 rekomandime.

- Mos përmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Manuali “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”. Përfundim bënin ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisaritet e varësisë të DPV Tiranë me dhoma sigurie po ashtu ishin në shkelje të dukshme të standardeve. Në komisaritet që duhej të rezultonin me dhoma të sigurisë të nxjerra jashtë funksionit, u konstatua se nuk ishin të mbyllura sipas procedurave përkatëse me dyllosje e procesverbal. Përgjithësisht këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dry.
- Plotësim jo korrekt i zërave të regjistruara për personat e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar është hasur në pjesën më të madhe të komisariteve, kryesisht kjo mbi arsyet e shoqërimit, njoftimin e familjarëve apo të afërmeve të të shoqëruarve, si dhe shënimit mbi ankesat ndaj punonjësve të policisë.
- Mungesa në postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe atyre të ndaluar/arrestuar ose afishime në ambiente të pa aksesueshme prej tyre, në rreth 30% të komisariteve të policisë.
- Probleme në ofrimin e shërbimit shëndetësor të ofruar nga DPV-të, sa i përket plotësimit korrekt të regjistruara e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e shërbimit shëndetësor. Në një pjesë të konsiderueshme të këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.

### ***3.4 Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura<sup>3</sup>***

Inspektimet e përgjithshme në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë, në Komandën e Forcave Tokësore Vau i Dejës, Shkodër, kishin si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, zbatimin e rregullave të parashikuara në Instruksionin e Kryerjes së Shërbimit të Ruajtjes nga Përgjegjësi i Dhomave të Ndalimit Disiplinor në Policinë Ushtarake, lidhur me kushtet e dhomave të ndalimit disiplinor, procedurat e dhënies së këtyre masave, respektimin e të drejtave të ushtarakëve të dënuar, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhënë gjatë viteve të mëparshme. Gjatë inspektimeve u vunë re disa problematika të cilat paraqesin nevojë për përmirësim. Përmbledhtazi këto gjetje pasqyrohen si më poshtë:

- Urdhrat për masën “ndalim disiplinor” të dhëna në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës, Shkodër zbatoheshin në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë, si dhe për zbatimin e këtyre urdhrave dhe ndjekjen e të gjithë procedurave në zbatim të tyre ngarkohej një person përgjegjës i këtij institucioni.
- Kushtet në dhomat e sigurisë në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë ishin të papërshtatshme për t’u ofruar ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor” një akomodim dinjitoz dhe konform standardeve.

<sup>3</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Forcat e Armatosura është hartuar 1 rekomandim dhe 1 informacion.

- Kushtet e ambienteve të takimit me familjarët ishin të papërshtatshme krahasuar me standardet.
- Mungonte sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurisë së Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë.
- Mungonin zilet elektrike në dhomat e sigurisë.
- Nuk ishin afishuar posterat me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor” në ambientet ku të jenë aksesueshme nga ata.
- Mungonte ngrohja në dhomat e sigurisë së Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë.

### ***3.5 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike<sup>4</sup>***

Vizitat monitoruese në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër, Spitalin Psikiatrik Vlorë, dhe në Spitalin Psikiatrik Elbasan, (që kanë në funksionin e tyre trajtimin më të specializuar dhe rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët kanë shteruar të gjitha mundësitë ekzistuese për të marrë një shërbim të tillë në komunitet, nuk ka mundësi të trajtimit të tyre në kushte ambulatorie apo nevojitet konsultë psikiatrike nga kërkesat që vijnë nga urgjencat e spitaleve të përgjithshme), përveç objektit të përgjithshëm të vizitave kishin si qëllim specifik: vlerësimin e respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; vlerësimin e procedurave të kryerjes së shtrimeve të pavullnetshëm; masat shtrënguese e kufizimin fizik; kushtet në të cilat mbahen këta persona, trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitues dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të prezantuara për këto ambiente gjatë viteve të mëparshme. Nga vizitat monitoruese të kryera për vitin 2015 në spitalet psikiatrike të lartpërmendura u konstatua:

- Mosrespektimi i hapësirës jetike, kushte të papërshtatshme në dhomat e personave të shtuar, dhe mbajtja e tyre për një kohë të gjatë/kthimi në rezidentë të Spitalit Psikiatrik Elbasan dhe për pavijonet me pacientë kronikë në Spitalin Psikiatrik Vlorë.
- Mbajtja e personave me aftësi të kufizuara intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mungesa e dhomës të veçimit në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër si dhe problematika për sa i përket kushteve dhe përmbushjes së standardeve së kësaj dhome në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë.
- Mungesa e një sistemi monitorimi me kamera në ambientet e këtyre spitaleve, si dhe mungesa e regjistrave të unifikuar nga Ministria e Shëndetësisë në të katër institucionet e lart përmendura, veçanërisht për sa i përket dokumentimit të shtrimeve të pavullnetshme dhe aplikimit të kufizimit fizik.
- Mungesa e posterave të afishuar me të drejtat e pacientit në ambientet e këtyre institucioneve.

<sup>4</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Spitalet Psikiatrike janë hartuar 4 rekomandime.



- Mangësi në plotësimin e organikës me mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Shkodër, dhe shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në atë të Elbasanit.
- Mungesa e mjeteve të kufizimit fizik në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “ Nënë Tereza”, Tiranë, Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shkodër.
- Vonesa në revokimin e masës “mjekim i detyruar”, për personat të cilët trajtoheshin me këtë masë në Spitalin Psikiatrik Shkodër.
- Mungesa e një kabineti stomatologjik konform standardeve, e aparaturës së EKG-së në Spitalin Psikiatrik Elbasan.
- Kushtet higjieno-sanitare, thuajse në të gjitha ambientet e këtyre institucioneve, ishin jashtë standardit e me lagështirë, kryesisht e gjetur kjo në spitali Psikiatrik Elbasan dhe në pavijonet e “kronikëve” në Spitalit Psikiatrik Vlorë, pasi ky i fundit ishte ndërtuar së fundmi dhe pavijonet e urgjencës, ai akut dhe sub-akut përmbushnin standardet.
- Mungesa e një sistemi qendror të ngrohjes në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “ Nënë Tereza” dhe Spitalin Psikiatrik Elbasan.

### ***3.6 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra<sup>5</sup>***

#### ***3.6.1 Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve.***

MKPT, bazuar në ligjin nr. 121/2014, datë 18.09.2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, inspektoi Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, me objekt vlerësimin e trajtimit të shtetasve të huaj që marrin shërbime në këtë qendër, në përputhje me të drejtat e tyre për trajtim dinjitoz dhe rehabilitues. Gjatë vizitës monitoruese në këtë qendër, u konstatuan zbatime të një pjese të rekomandimeve të bëra më parë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Problematikat që vazhdonin të ishin të pranishme, paraqiten si më poshtë:

- Mungesa e një juristi, i cili duhet të merret kryesisht me pjesën e dokumentacionit që secilit individ të strehuar në qendër i nevojitet, duke marrë në konsideratë faktin se kjo qendër strehon shtetas të huaj.
- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf me edukatorë, kujdestarë, dhe staf mjekësor.
- Nuk ishte hartuar një marrëveshjeje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me ofrimin e mundësive për formim profesional në Qendrat e Formimit Profesional në varësi të kësaj Ministrie, si edhe mundësi për punësim pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, përsëri në varësi të kësaj Ministrie për të gjithë personat e strehuar në QKPA, që janë të interesuar.
- Personat e strehuar në QKPA nuk trajtoheshin me ndihmë ekonomike siç parashikohet në ligjin nr. 121/2014, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.
- Mungonte afishimi i të drejtave dhe detyrimeve të përfituesve të kësaj qendre.

<sup>5</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Qendra janë hartuar 4 rekomandime.

### ***3.6.2 Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç***

Inspektimi i Qendrës së Mbyllur për Të Huajt, Kareç, të ngritur me VKM nr. 1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83 të ligjit Nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, për strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme. Gjatë vizitave të shpeshta monitoruese dhe hetuese në këtë Qendër si rrjedhojë e ankesave të shumta mbi trajtimin e shtetasve të huaj në të, u konstatua se vijonin po të njëjtat problematika të konstatuara në vitin 2014:

- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf për komunikime në gjuhën dominante të të huajve, shërbime psiko-sociale, juridike dhe mjekësore.
- Mungonin pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive.
- Mungonin aparatet kartofonike, televizorët e antenat për të mundësuar informimin e të huajve mbi ato çfarë ndodhin jashtë qendrës e në vendet e tyre të.
- Mungonin aktivitete kulturore, argëtuese e sportive. i vetmi aktivitet sportiv ishte ai me top në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë.
- Mungonin aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë.
- Kamerate në perimetrin e jashtëm të godinës nuk ishin funksionale.
- Sistemi i ngrohjes ishte jofunksional.
- Kishte mangësi në furnizimin me produkte higjieno-sanitare, pajisje vetjake sipas grup-moshave.

Për këtë qendër një rekomandim i veçantë u dërgua më datë 26.03.2015 lidhur me ofrimin e shërbimit shëndetësor 24 orësh, për 19 shtetasit e huaj të parregullt në grevë urie.

### ***3.6.3 Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë***

Inspektimi i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut e cila strehon personat e identifikuar në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Kjo qendër e mbyllur, e sigurisë së lartë është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, i cili, ndër të tjera, përveçse nuk parashikon detyrat funksionale të këtij institucioni apo shërbimet që ofrohen në të, parashikon në pikën 3 të tij se në këtë qendër trajtohen edhe emigrantë klandestinë që kalojnë përmes Shqipërisë. Gjatë vizitës monitoruese në këtë Qendër, u konstatuan:

- Nevoja për ndryshime të bazës ligjore të funksionimit të QKPVT-ja, duke marrë në konsideratë vërejtjet sa më lartë.

- Nevoja për të kryer rikonstruktimin e brendshëm dhe të jashtëm të dy godinave ekzistuese.
- Probleme të mosfunksionimit të sistemit ngrohës.
- Probleme të mosfunksionimit të pajisjeve kompjuterike për përfituesit.
- Mangësi në organikë sa i përket pranisë së juristi dhe një psikologu me kohë të plotë në qendër.
- Problematika përsa i përket pajisjes me libra shëndetësore dhe vënies në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjitha përfitueset e kësaj qendre.

### ***3.7 Niveli i respektimit të drejtave të personave në Drejtoritë e Policisë Kufitare dhe Komisaritet e Stacionet e Varësisë<sup>6</sup>***

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në mbështetje të nenit 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë (UNHCR), gjatë vitit 2015 ka monitoruar disa prej pikave të kalimit/ndalimit kufitar të cilat konsiderohen si ato me lëvizje më të shpeshta të të huajve të parregullt në Shqipëri. Nga inspektimet u konstataua:

- Kapaciteti i tyre në hapësirë dhe në burime financiare e njerëzore është i pamjaftueshëm, jo vetëm për raste të flukseve masive, por edhe për raste të rritjes graduale të numrit të azilkërkuarve, apo të migrantëve të parregullt në një kohë të shkurtër.
- Po ashtu nga inspektimet në pikat e kalimit kufitar, si dhe në territoret e mundshme – kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin transit të migrantëve, konfirmuar edhe nga burime të Policisë Kufitare, u konstataua se ka shumë sfida që duhen tejkaluar – qoftë edhe në një kuadër emergjence, në mënyrë që ato të konceptohen si qendra funksionale jo vetëm për regjistrimin dhe ndihmesën shumë afatshkurtër ndaj personave në nevojë, por edhe si qendra rezidenciale që do të mundësojnë një qëndrim më afatgjatë të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në to.
- Probleme u konstatuan në bazë materiale të pamjaftueshme dhe në mungesat e shërbimeve të përkthimit. Ekipet duhet të jenë të pranishme gjatë kryerjes së procedurës së përzgjedhjes së të huajve të parregullt në kufi, apo në drejtoritë rajonale të kufirit në mënyrë që të sigurohet mundësia që, çdo i huaj që gjendet në mënyrë të parregullt në territorin shqiptar, të kuptojë qartë të drejtat e veta dhe të shprehë qartësisht nëse kërkon azil në Republikën e Shqipërisë.
- Po ashtu u konstataua se personat të cilëve u jepej urdhër largimi për t’u ekzekutuar prej tyre në mënyrë vullnetare, nuk u lihej në dispozicion afati minimal i përcaktuar nga ligji për këtë qëllim, por detyroheshin të largoheshin drejt territorit prej nga kishin hyrë të shoqëruar e në mënyrë të parregullt.

<sup>6</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Pika kufitare janë hartuar 2 rekomandime.

#### **4. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale**

**IEVP Vaqarr** - Datë 24.02.2015

Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtoria e Institucionit ekspertëve iu mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion, brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin. Gjatë takimit paraprak me Drejtorin e IEVP-së Z. Bardhyl Faskaj grupi monitorues u informua mbi situatën në institucion dhe problematikat e hasura nga ana e administratës në IEVP Vaqarr. Si rezultat i mbylljes së disa IEVP-ve në kuadrin e restaurimeve dhe reformave në sistemin e burgjeve së fundmi IEVP Vaqarr i është nënshtruar disa ndryshimeve duke kaluar nga burg i sigurisë së zakonshme në institucion paraburgimi. Sipas drejtorit transferimi dhe vendosja e të ardhurve kryesisht nga IEVP-të Mine Peza dhe Jordan Misja, Tiranë në këtë institucion ishte kryer normalisht dhe në mënyrë të qetë. Por nga ana tjetër transferimi i të dënuarve në IEVP- te tjera dhe akomodimi i të paraburgosurve të ardhur rishtas në këtë institucion ka qënë një ngarkesë pune e zgjatur dhe e lodhshme për stafin pasi ndryshimi i regjimit nga burg në paraburgim ka paraqitur problematikat e veta. Gjithsesi sipas drejtorit transferimi është përballuar me sukses dhe të paraburgosurit janë akomoduar nëpër dhoma dhe stafi është munduar që ti sistemoj duke studiuar dosjet e tyre dhe përshtatje sipas rasteve.

Si pasojë e kësaj situate të re të krijuar në këtë IEVP, Drejtori evidentoi si problemet më kryesore mbipopullimin, elementët e sigurisë në ambientet e ajrimit dhe numrin e kufizuar në organikë të stafit të sigurisë veçanërisht i atyre në funksionin e rojeve vëzhguese të perimetrave të sigurisë. Ndërkohë problematika të tjera që kanë rrjedhur si pasojë e transferimit dhe vendosjes së paraburgosurve në këtë institucion kanë qënë transportimi dhe administrimi i veshjeve dhe orendive personale dhe dorëzimi i tyre pranë të dënuarve dhe paraburgosurve si dhe informimi i të gjithë familjarëve për vendndodhjen e re të pjesëtareve të tyre të familjes. Gjatë procesit të transferimit kishte pasur ankesa të shumta nga ana e të paraburgosurve lidhur me mundësinë për telefonata duke qënë se për çdo seksion ka vetëm një aparat telefoni e pamjaftueshme për numrin aktual të paraburgosurve në atë seksion si dhe ankesa për moslejimin e transferimit të mjeteve elektroshtëpiake si TV dhe frigorifer të cilat kufizohen nga Urdhri në fuqi i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 3895, datë 09.04.2013, i cili lejon në mjediset e banimit vetëm pajisjet që blihen nga institucioni me një komision të posaçëm.

Grupi monitorues u informua se kapaciteti zyrtar i IEVP-së është 146 persona ndërsa aktualisht në momentin e inspektimit ndodheshin 179 të paraburgosur dhe 1 person i dënuar. Në institucion nuk kishte të mitur por kishte 18 të paraburgosur të cilët i përkisnin kategorisë së 19-21 vjeçarëve të cilët jo të gjithë ishin të grupuar në një seksion të veçantë. Ndarja e regjimeve dhe vendosja e të paraburgosurve në dhoma ishte akoma në fazën e studimit të dosjeve dhe përshtatja sipas rasteve. Në IEVP Vaqarr kishte katër persona të cilët trajtoheshin me metadon, shtatë shtetas të huaj mes të cilëve pesë shtetas Kosovarë, një Italian dhe një Gjerman. Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person me masë disiplinore. Gjithashtu grupi inspektues u informua

nga ana e administratës së I EVP Vaqarr se në muajin e fundit kishte patur disa ngjarje të rënda si një tentativë arratisjeje si dhe me datë 11/02/2015 një i paraburgosur i sapo ardhur në institucion kishte tentuar vetëvarjen por ishte ndaluar në kohë nga punonjësit e I EVP-së dhe menjëherë ishte marrë një plan masash për trajtimin e tij.

Organika e institucion ishte e plotësuar dhe nuk kishte mungesa në stafin civil apo në atë të sigurisë por me situatën e re të ndryshimit të funksionit të I EVP Vaqarr ishte kërkuar që të ketë shtesa në stafin e sigurisë prej të paktën 5 punonjësish të rolit të sigurisë. Gjithashtu në I EVP Vaqarr në momentin e inspektimit kishte 12 të paraburgosur të punësuar kryesisht në kuzhinë, pastrim, gjelbërim, shpërndarje ushqimi, bibliotekë dhe magazinë.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Marrja e masave të menjëhershme për shtimin në organik të një stafi prej 5 punonjës të rolit të sigurisë në përshtatje të rolit të ri të institucionit I EVP Vaqarr si institucion paraburgimi.
2. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin dhe rritjen e elementëve të sigurisë në ambientet rrethuese dhe në ambientet e ajrimit ku rrjetat ndarëse janë të dëmtuara;
3. Marrja e masave të menjëhershme për kryerjen e termo-izolimit të të gjithë godinës në mënyrë që të shmanget lagështira e cila në momentin e inspektimit ishte tej normave të lejuara;
4. Marrja e masave të menjëhershme për të shtuar nga një kabinë telefoni për çdo sektorë në mënyrë që komunikimi i të paraburgosurve me familjarët të zhvillohet normalisht;
5. Marrja e masave të menjëhershme për mundësimin e pajisjes së paraburgosurve me pajisjet elektroshtëpiake të cilat ato kanë patur në Institucionet nga vijnë para transferimit në I EVP Vaqarr.
6. Marrja e masave të menjëhershme për përshtatjen e regjistrave më terminologjinë e institucionit të paraburgimit dhe shtimi i regjistrit të ngjarjeve të rënda;
7. Marrja e masave të menjëhershme për rregullimin e menaxhimit të procesit të kërkesë/ankesave dhe vënien në funksion të kutive postare në seksione.
8. Marrja e masave të menjëhershme për shmangien e vonesave dhe pritjes së gjatë të familjarëve para takimeve me të paraburgosurit;
9. Marrja e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të dhomave të banimit në sektor dhe shmangies së lagështirës;
10. Marrja e masave për rregullimin e kanalizimeve të ujërave të zeza;
11. Marrja e masave të menjëhershme për gjetjen e teshave dhe sendeve personale të cilat kanë humbur gjatë procesit të transferimit të paraburgosurve në I EVP Vaqarr;
12. Marrja e masave të menjëhershme për krijimin e mundësive për ofrimin e shërbimit të lavanderisë për larjen e ndërresave personale;
13. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e të gjithë paraburgosurve me librezë shëndetësore dhe vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
14. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomës së stomatologut me materiale dentare, në mënyrë që të ofrohet një shërbim efikas stomatologjik nga ana e këtij institucioni.
15. Marrja e masave të menjëhershme për pajisjen sektorit shëndetësor me një regjistër të evidentimit të rasteve të dhunës.

16. Marrja e masave të menjëhershme për sigurimin e formateve të kontrollit mjekësor, të cilët bëjnë të mundur dokumentimin dhe evidentimin e rasteve të dhunës së ushtruar në komisarate, ndaj shtetasve të cilët sillen për vuajtjen e dënimit në këtë IEVP, si dhe për të evituar ekuivokët në lidhje me raste të tilla.

## **IM Kavajë – Datë 26.03.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në Institutin e të Miturve Kavajë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat e trajtimit të të paraburgosurve/ të dënuarve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. K4/I3-2 Prot., datë 14.05.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të miturve në Institutin e të Miturve Kavajë”.

Instituti i të Miturve funksionon prej vitit 2009 si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit e moshës 14-18 vjeçare. Kapaciteti i institucionit është 40 persona, 20 të paraburgosur dhe 20 të dënuar, të ndarë në katër sektorë. Në ditën e monitorimit në institucion ndodheshin 66 të mitur, prej të cilëve 52 të paraburgosur dhe 14 të dënuar. Një tjetër i dënuar i mitur ishte me leje shpërblyese. Në kushtet e mbipopullimit të ndodhur si rrjedhojë e transferimeve të një kontingjenti të miturish nga IEVP Jordan Misja, Tiranë dhe IEVP Shën Koll, Lezhë, institucioni kishte marrë masa që të miturit e dënuar të zhvendoseshin në një sektor të vetëm, ndërsa të miturit e paraburgosur të përshtateshin në tre sektorë. Ndonëse institucioni punonte në kushtet e mbipopullimit, të miturve u ishte siguruar vend i përshtatshëm fjetjeje dhe ishin përfshirë në aktivitetet ditore të institucionit. Të miturit e përfshirë në kurset profesionale së bashku me trajnerët e tyre të Qendrës së formimit Profesional Durrës kishin bërë të mundur prerjen dhe saldimit e krevateve të cilët ishin bërë marinarë, por edhe të rafteve të dollapëve për të gjithë dhomat.

Nga informacioni i grumbulluar në vend përmes kryerjes së intervistave private, pa dëshmitarë me të miturit e privuar nga liria dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi se ende një pjesë e rekomandimeve të bëra në shkresën e përmendur më lartë nuk kishte gjetur ende zbatim. Marrjen e masave për mbulim me sistem monitorimi përmes kamerave të sigurisë të mjediseve të korridoreve ku ndodhen klasat e mësimi, dhe dhomat e izolim/observimit me qëllim shmangien e mundësisë për të ushtruar dhunë psikologjike apo fizike ndaj të miturve apo të pretendimeve për dhunë.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave bashkëpunim të suksesshëm ndër-institucional me Prokurorinë së Përgjithshme për të zgjidhur vonesat në komunikim midis prokurorive të rretheve dhe IEVP-ve lidhur me revokimin, shuarjen, apo zëvendësimin e masës së sigurisë. Ngërçi administrativo-ligjor i shkaktuar qoftë dhe për arsye objektive, apo nga mungesa e koordinimit midis palëve duhet të rregullohet në mënyrë që të adresojë edhe problemin e

të miturve që qëndrojnë për një kohë të gjatë në masë arresti me burg pa pasur asnjë kontakt me prokurorët.

2. Marrjen e masave për ndryshimin/përshtatjen e udhëzimit të DPB për planifikimet e lejeve shpërblyese për të miturit duke ulur kohën e nevojshme të qëndrimit në institucion para se të fillojë planifikimi i lejes shpërblyese si dhe duke bërë parashikime më të shpeshta sesa ato vjetore në mënyrë që të gjithë të miturit e privuar nga liria të ndihmohen për t'u ri integruar në komunitet.
3. Marrjen e masave për aktivizimin e bashkëpunimit me DAR Kavajë për sigurimin e funksionimit të shkollës së nivelit të mesëm për vitin mësimor 2015-2016, për të miturit që kanë mbaruar nivelin 9-vjeçar.
4. Marrjen e masave për riparimet e nevojshme të infrastrukturës, veçanërisht në dhomat e observim/ veçimit dhe të dusheve të përbashkëta.
5. Marrjen e masave për afishimin e menysë javore në kuzhinën e institucionit si dhe për ruajtjen e kampioneve në kushte frigoriferike.
6. Marrjen e masave për riparimin e pajisjeve sportive të palestrës.
7. Marrjen e masave për vënien në funksionim të Autoambulancës.
8. Marrjen e masave për pajisjen me instrumente dentare të dhomës së stomatologut.
9. Marrjen e masave për monitorimin e procesit të larjes së teshave personale.
10. Marrjen e masave për përfshirjen në kurse të të gjithë të dënuarve/paraburgosurve.

### **IEVP Durrës – Datë 09.04.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në I.E.V.P. Durrës për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e të paraburgosurve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. K4/I40-2 Prot., datë 19.11.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të paraburgosurve në IEVP Durrës”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me individët që u është hequr liria, si dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që vetëm rekomandimi mbi krijimin e një ambienti të posaçëm për takimin e të paraburgosurve me familjarët e mitur kishte gjetur zbatim, ndërkohë që mbeteshin të parealizuar të gjitha rekomandimet e tjera.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për transferimin e të dënuarve në IEVP të përcaktuara për këtë kategori.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në regjim, veçanërisht në katin e parë dhe respektimin e hapësirës personale.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në funksion të të gjitha kamerave vëzhguese të këtij institucioni.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/veçimit.
5. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në katin e parë dhe dezinfektimin e dhomave të banimit dhe të mjedisit të jashtëm.
6. Marrjen e masave që punonjësi i autorizuar për marrjen në dorëzim të kërkesë/ankesave të jetë pjesë e sektorit të edukimit.
7. Marrjen e masave për organizimin e aktiviteteve të ndryshme sociale, fetare dhe rehabilituese, duke vënë në funksion ambientet e përbashkëta të këtij institucioni, si dhe riparimin dhe vënien në punë të kompjuterëve.
8. Marrjen e masave për verifikimin e çmimeve në dyqanin e institucionit me qëllim adresimin e shqetësimit të të paraburgosurve për çmimet e larta të tij, si dhe çmimit të kartave telefonike për impuls.
9. Marrjen e masave për plotësimin e organikës së sektorit të kujdesit shëndetësor me mjek psikiatër, dhe infermierë, si dhe ofrimin e trajnimeve specifike për shëndetin mendor për stafin shëndetësor dhe atë policor.
10. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një autoambulancë.
11. Marrjen e masave për pajisjen e plotë të farmacisë me medikamente të urgjencës.
12. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të sëmurët akut.
13. Marrjen e masave për pajisjen e dhomës së stomatologut me autoklavë, vënien në funksion të unitit dhe furnizimin me materiale dentare.

### **IEVP “Mine Peza” (302), Tiranë – Datë 21.04.2015**

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në IEVP 302 Mine Peza në Tiranë, për vitin 2015. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 170 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 223 persona të paraburgosur. Rrjedhimisht, mbipopullimi ishte problematikë e dukshëm e qenësishme.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve iu bë me dije se IEVP 302 Mine Peza është institucion paraburgimi, por ka edhe 3 persona të dënuar. Sipas Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë



ky institucion është kategorizuar në dy seksione: një i sigurisë së lartë dhe tjetri i sigurisë së zakonshme. Të paraburgosurit e moshës 18-21 vjeç ishin vendosur në 4 dhoma brenda katit të parë.

Në kohën e monitorimit, kishe 1 dhomë observimi dhe 2 dhoma veçimi të cilat rezultuan problematike.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për marrjen në analizë të rasteve të pretenduara të tejkalimit të forcës fizike, si edhe marrjen e masave përkatëse administrative ndaj personave përgjegjës.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndryshimin e pikës 7/3 të Urdhrit të DPB nr. 274, datë 14.10.2014 “Për zbatimin e përshkrimit të detyrave të policisë së burgjeve dhe skemave të vendosjes së shërbimeve në IIEVP “Mine Peza”, që jep mundësinë për të bërë apelin me grup të gatshëm në çdo turn, pasi kjo procedurë lë vend për ngritje dyshimi dhe pretendimesh për dhunë fizike e presion psikologjik.
3. Marrjen e masave për trajtimin me pagëse monetare për të gjithë të punësuarit në IIEVP 302 Mine Peza.
4. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me uljen e mbipopullimit në këtë institucion.
5. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të mjediseve të banimit.
6. Marrjen e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme të takimit të të paraburgosurve me familjarët, veçanërisht me fëmijët.
7. Marrjen e masave për përshtatjen dhe krijimin e kushteve sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të veçimit.
8. Marrjen e masave lidhur me kushtet higjieno-sanitare dhe lagështirën në tualete dhe dushe dhe kryesisht paisjen me produkte higjieno-sanitare çdo të paraburgosur.
9. Marrjen e masave për kryerjen e më shumë aktiviteteve, kryesisht ato sportive.
10. Marrjen e masave për mbulimin e një pjese të mjedisit të ajrimit, në mënyrë të tillë që ky i fundit të shfrytëzohet edhe në raste shiu.
11. Marrjen e masave për kryerjen në vizitave më të shpeshta të mjekes së institucionit brenda në regjim.
12. Marrjen e masave për ofrimin e një shërbimi më efikas shëndetësor duke i dhënë mundësinë të paraburgosurve për ekzaminime dhe konsulta në qendra spitalore të specializuara sipas rasteve që paraqesin nevoja për konsulta më të specializuara.
13. Marrjen e masave për ofrimin e një shërbimi stomatologjik të plotë dhe efikas nga ana e stomatologut.
14. Marrjen e masave për pajisjen e dhomës së stomatologut me materiale dhe instrumente dentare.

15. Marrjen e masave nga ana e stafit drejtues të institucionit për furnizimin e farmacisë me ilaçe si për rastet akute ashtu dhe ato kronike duke vënë në zbatim e skemën e rimbursimit të ilaçeve më me efikasitet.
16. Marrjen e masave për kryerjen e riparimeve të dusheve dhe tualeteve.

### **IEVP Zahari, Krujë – Datë 04.05.2015**

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në I EVP Krujë për vitin 2015. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Vizita u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Nga ana e drejtuesit të institucionit, ekspertëve të grupit inspektues iu ofrua mundësia që të kishin akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të monitoronin.

Gjatë takimit, grupi inspektues kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve/paraburgosurve, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit me anë të shkresës me Nr. prot. K-4, I 23-2, datë 09.07.2014. Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacionit të marrë nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se dy rekomandime të kësaj shkrese kishin gjetur zbatim. Përkatesisht, i pari mbi prezencën e mjekut në Komisionin Disiplinor, si person përgjegjës për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të të dënuarit/paraburgosurit dhe nëse kjo e fundit lejon mbylljen e tij në izolim, dhe i dyti mbi vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve. Ndërkohë që dy rekomandime të tjera ishin pjesërisht të realizuara, pasi pajisja e farmacisë me ilaçe dhe ajo e stomatologut me instrumente apo materiale dentare nuk ishte bërë e plotë.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

- ❖ Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, ku të sigurohet transferimi, sistemimi dhe trajtimi i të gjithë personave me masë “mjekim i detyruar”, që mbahen në I EVP Krujë, konform nenit 28 të ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.

### **Deri në zgjidhjen sa më të shpejt të rekomandimit të mësipërm u rekomandua:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në të gjithë sektorët e regjimit dhe respektimin e hapësirës personale.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për shmangien e abuzimit me tejkalimin e forcës fizike apo çdo lloj presioni psikologjik nga ana e stafit policor dhe grupit të gatshëm në këtë institucion.

3. Marrjen e masave për mbulimin me kamera vëzhguese të ambienteve apo shkallëve që realizojnë daljen e të dënuarve/paraburgosurve në ajrim.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për ndarjen dhe akomodimi në sektorë të veçantë të të dënuarve/paraburgosurve, ku dushet apo edhe aktivitetet e tjera të jenë gjithashtu të ndara.
5. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjiëno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën dhe me amortizimin e të gjithë ambienteve të brendshme të institucionit, bazuar në nenet 23 dhe 26, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në funksion të dhomës së kufizimit fizik dhe furnizimi e këtij institucioni me mjetet (rripa lëkure, këmisha force) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, për rastet e veçanta të trajtimit (axhitim psiko-motor, tentativa suicidale apo homicidale).
7. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit shëndetësor të këtij institucioni me dy mjekë psikiatër dhe kujdestarë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e godinave me mjedise të përshtatshme për aktivitete kreative dhe rehabilituese, përmirësimin e dusheve dhe të tualeteve.
9. Marrjen e masave për trajtimin dhe zgjidhjen në kohë të ankesave/kërkesave nga ana e stafit drejtues të institucionit.
10. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës të dhomave të observim/veçimit, sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për dezinfektimin periodik të të gjithë institucionit.
12. Marrjen e masave nga ana e stafit psiko-social për të bërë plane individuale trajtimi sipas grupeve vulnerabël që ka ky institucion.
13. Marrjen e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me ilaçe si të urgjencës, ashtu dhe të ilaçeve për sëmundjet kronike.
14. Marrjen e masave nga ana e stafit të sektorit shëndetësor për shpërndarjen dhe administrimin me rigorozitet dhe sipas vakteve, të mjekimeve ditore të të dënuarve/paraburgosurve të sëmurë, kryesisht të atyre me probleme të shëndetit mendor.
15. Marrjen e masave për rivlerësim të mjekimit të sëmurëve mendorë me konsulta periodike me psikiatrin, duke bërë të mundur përshtatjen e dozave e të llojeve të neuroleptikëve në varësi të diagnozës e të gjendjes së të dënuarve, deri në plotësimin e organikës së institucionit me psikiatër.

16. Marrjen e masave për furnizimin e dhomës së stomatologut me autoklavë, instrumente e materiale dentare.
17. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen urgjente të institucionit me një autoambulancë të re.
18. Marrjen e masave për vënien në punë të EKG-së dhe të laboratorit, duke plotësuar organikën e sektorit shëndetësor me specialistët përkatës.
19. Marrja e masave për t'u dhënë akses të dënuarve paraplegjikë në mënyrë që të lehtësohen lëvizjet e tyre në të gjithë ambientet e institucionit. Banjat dhe dushet të pajisen me mjete ndihmëse në funksion të nevojave të tyre.

### **IEVP Drenovë, Korçë – Datë 07.05.2015**

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në IEVP “Drenovë” Korçë për vitin 2015. Institucioni ka kapacitet maksimal prej 312 personash ndarë në 4 seksione, konkretisht seksionin e sigurisë së lartë, seksionin e sigurisë së zakonshme, seksionin e parburgimit dhe seksionin e parburgimit për të mitur.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit, duke ofruar akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhej të monitoroheshin. Grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion mbi situatën aktuale në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Drejtori i institucionit parashtroi situatën duke theksuar si problemin më kryesor mbipopullimin, i cili kishte sjellë për pasojë reduktimin e kushteve të jetesës brenda institucionit si dhe vështirësi në ofrimin e shërbimeve cilësore. Në ditën e inspektimit në institucion ndodheshin 459 persona (147 persona mbi kapacitet), prej nga 10 persona të moshës 18-21 vjeçare, 2 të mitur, 3 persona me probleme të shëndetit mendor dhe 22 persona me varësi nga substancat. Për të miturit dhe personat me probleme të shëndetit mendor ekzistonte një seksion i veçantë.

Sipas drejtorit ngjarje të rënda ishin disa raste me tentativa vetëvrasje të cilat ishin parandaluar në momentin e duhur nga stafi.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 30 të punësuar të gjithë të dënuar.

Organika nuk ishte e plotësuar. Gjatë vëzhgimit të dokumenteve dhe intervistave me stafin dhe vetë të dënuarit dhe parburgosurit rezultoi se kishte disa mungesa. Konkretisht ishin bërë disa shkurtime në organikë dhe kryesisht 8 punonjës të sigurisë dhe mjekun part-time.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit të institucionit lidhur me eliminimin e mjeteve të forcës në ambientin e izolimit, me qëllim evitimin e rasteve të përdorimit të tyre ndaj personave që vuajnë masën e izolimit.
2. Marrjen e masave urgjente për plotësimin e organikës sipas parashikimeve.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit dhe kryesisht në ambientin e Veçim/Observimit ku trajtimi i personave që ndodhen aty është çnjerëzor dhe degradues.
4. Marrjen masat e menjëhershme për pajisjen me shtroje, karrige dhe dollapë dhe furnizim të të dënuarve dhe të paraburgosurve, paisja e tyre me detergjente dhe mjete të higjienës vetjake dhe të ambientit ku ato qëndrojnë.
5. Marrjen e masa për ofrimin e shërbimeve si ajrim, aktivitete dhe mundësi për dush brenda godinës, në të gjithë sektorët ku ato janë të limituar për shkak të mungesës së hapësirave dhe mbipopullimit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për t'i dhënë zgjidhje problemit të mundësit të dusheve dhe të ujit të ngrohtë, në sektorin e observimit dhe sektorin e shëndetësisë ku gjenden të akomoduar të paraburgosur dhe të miturit, si dhe në të sektorët e paraburgimit dhe të të dënuarve.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të ambienteve të spitalit, në mënyrë që të ofrohet një trajtim njerëzor e dinjitoz për personat të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion.
8. Marrjen e masave për kryerjen e vizitave më të shpeshta të mjekut/ndihmës mjekut të institucionit brenda në regjim dhe ofrimin të një shërbimit më efikas mjekësor nga ana e tij.
9. Marrjen e masave për ofrimin e një shërbimi stomatologjik me të gjitha ndërhyrjet e nevojshme.
10. Marrjen e masave për sigurimin e ushqimit cilësorë për personat me diete diabetike nga kuzhina e institucionit për të dënuarit e diagnostikuar me Diabet Mellitus.
11. Marrjen e masave për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për sëmundjet akute për të gjithë shtetasit që vuajnë dënimin në këtë institucion.
12. Marrjen në shqyrtim të mundësisë për krijimin e një sektori të veçantë për personat me probleme të shëndetit mendor.
13. Marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga stafi psiko-social, si për shtimin e kontakteve ashtu edhe për shtimin e aktiviteteve riintegruese dhe social-kulturore në përgjithësi dhe në veçanti për të miturit dhe 18-21 vjeçarët.

14. Marrjen e masave për rifillimin e aktiviteteve mësimore dhe kurseve profesionale për të miturit.
15. Marrjen e masave për zgjerimin e organikës së punësimit jo vetëm për të dënuarit por dhe për të paraburgosurit.
16. Marrjen e masave për verifikimin e çmimeve të produkteve dhe cilësisë së tyre në njësinë tregtare pranë institucionit si dhe për rritjen e mbulimit me artikuj.
17. Marrjen e masave për sigurimin e përshtatshëm me ngrohje për një periudhë më të gjatë se 4 orë në ditë marrë në konsideratë kushtet klimaterike ku ndodhet institucioni.
18. Marrjen e masave për drenazhimin e bokseve të ajrimit si dhe mbulimit të një pjese të bokseve të ajrimit në mënyrë që kjo veprimtari të mos ndërpritet në raste reshjesh apo temperaturash të larta.
19. Marrjen e masave për vlerësimin me vëmendjeje dhe prioritet të lejeve shpërblyese e të veçanta ku të bëhet një verifikim i qartë dhe adekuat i vlerësimeve dhe kushteve të besueshmërisë së personit i cili pretendon se e meriton këtë leje dhe i është mohuar.

#### **IEVP “Ali Demi”- Datë 15.05.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në IEVP “Ali Demi”, Tiranë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat e trajtimin e të paraburgosurave/ të dënuarave në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit gjatë vizitës së fundit në këtë institucion të dërguara me shkresën me Nr. K4/I10-2 Prot., datë 15.05.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në IEVP “Ali Demi”.

Në kuadër të ristrukturimit të Institucioneve penitenciare, IEVP “Ali Demi” funksionon aktualisht si institucion i posaçëm për trajtimin e grave të paraburgosura dhe të dënuara. Në institucion nuk disponohej një kopje e urdhrit, dhe as në faqen zyrtare të DPB-së ku IEVP “Ali Demi” vijonte të klasifikohej si burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion për gratë e dënuara dhe një seksion për gratë e paraburgosura me fëmijë deri në moshën 3 vjeç. Në faqen e DPB po ashtu kapaciteti zyrtar i IEVP “Ali Demi” është 80 persona (kundrejt kapacitetit prej 148 personash të deklaruar nga drejtori i burgut gjatë takimit paraprak. Në ditën e monitorimit në institucion trajtoheshin 69 të paraburgosura dhe 41 të dënuara, të vendosura përkatësisht në seksionin e paraburgimit dhe në seksionin e të dënuarave. Dy gra ishin shtatzënë përkatësisht 5 dhe 3 muaj. Në çerdhe nuk kishte fëmijë të trajtuar. Në seksionin e kujdesit të veçantë ndodheshin dy persona me çrregullime psikiatrike ndërkohë që në institucion trajtoheshin një total prej 11 personash me probleme të shëndetit mendor. Po ashtu në institucion trajtoheshin dy të mitura dhe dy vajza të moshës 18-21 vjeçare të vendosura në një dhomë, si dhe 5 shtetase të huaja.

Nga informacioni i grumbulluar në vend përmes kryerjes së intervistave private, pa dëshmitarë me gratë e privuara nga liria dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi se ishin marrë masa për të përmbushur rekomandimet e bëra në shkresën e përmendur më lart, por ende tre prej rekomandimeve nuk kishin gjetur zbatim.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave që punonjësi i autorizuar për marrjen në dorëzim të kërkesë/ankesave të jetë pjesë e sektorit të edukimit.
2. Marrjen e masave për pajisjen e institucionit me regjistrin e dokumentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës.
3. Marrjen e masave për mos përfshirjen me të drejtë vote në Komisionin Disiplinor të mjekes së institucionit.
4. Marrjen e masave për garantimin e kontakteve të shpeshta të juristit me të paraburgosurat dhe të dënuarat në regjim në mënyrë që të mundësohet informimi i tyre mbi procedurat e përfitimit nga lejet shpërblyese e të veçanta, shërbimi i provës, etj.
5. Marrjen e masave për pajisjen e të dënuarave/paraburgosurave me paketa bazë të higjienës vetjake si dhe të higjienës sanitare.
6. Marrja e masave për riparimin e aksesorëve të dëmtuar në mjediset e tualeteve dhe dusheve.

#### **IEVP Lezhë - Datë 11.06.2015**

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në IEVP Lezhë për vitin 2015. Sipas të dhënave zyrtare të DPB, institucioni ka kapacitet maksimal prej 700 personash. Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 760 persona, numër ky që tregon dukshëm mbipopullimin në institucion.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtues të institucionit, përkatësisht me Shefin e Sigurisë, si edhe me Drejtorin e Zyres Juridike të institucionit, të cilët u shprehën të gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Në përmbyllje të inspektimit, ekspertët takuan dhe ndanë problematikat e konstatuara me Drejtorin e Institucionit. Gjatë takimit fillestar, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve dhe paraburgosurve, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura në inspektimin e mëparshëm pranë këtij institucioni.

Në bisedën paraprake me përfaqësuesit e institucionit, grupi monitorues evidentoi problemet e konstatuara gjatë vizitës së kryer në këtë institucion në datën 16.06. 2014 dhe të evidentuara në raportin përkatës Nr. K4/124-2 Prot. të datës 17.07.2014. Nga vizita pararendëse, në këtë institucion ishin konstatuar probleme në lidhje me mbipopullimin, higjienën në përgjithësi në ambientet e banimit dhe në veçanti në dhomat e observim-veçimit, pajisjes me aksesorë për mbajtjen e higjienës, përdorimin e ambienteve të observim-veçimit si ambiente paraburgimi; krijimit të një seksioni të posaçëm për të rinjtë e paraburgosur të moshës 18-21 vjeçarë etj<sup>7</sup>. Këto të meta të verejtura në monitorimin pararendës dhe masat e marra në lidhje me reduktimin apo përmirësimin e tyre ishin gjithashtu pjesë e diskutimit paraprak.

---

<sup>7</sup> Shiko me gjatë përmbajtjen e Raportit të Monitorimit të grupit të ekspertëve të MKPT-sw për I.E.V.P.-në Lezhë, Nr. K4/ 124-2 Prot. datë 17 Korrik 2014.

Nga ana e përfaqësuesve të lartë të institucionit, në lidhje me problemet e evidentuara në vizitën pararendëse, u bë me dije se nga ana e institucionit, brenda mundësive që disponon ishin marrë të gjitha masat për të minimizuar apo eliminuar problemet e evidentuara nga vizita e kaluar.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në IEVP Lezhë me objektivin që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person konform nenit 22, pika 1 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit në IEVP Peqin në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 *”Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”*, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit të Institucionit lidhur me dhënien fund të situatës degraduese dhe kushteve të trajtimit jonjerëzorë të 34 të burgosurve/paraburgosurve të sektorit të Veçim/Observimit në respekt të plotë të Rregullores së përgjithshme e Burgjeve, nenit 21, pika 1, *“I burgosuri qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë dhe më pas vendoset në ambientin e banimit. Në vendosjen e të burgosurve nëpër dhoma mbahen parasysh kritere që lidhen me masën e dënimit, moshën, gjëndjen shëndetësore,...*
4. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimeve të brendshme në IEVP Lezhë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me riparimin dhe eliminimin e lagështirës në ambientet e dusheve dhe tualeteve dhe përmirësimin fizik të këtyre të fundit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me dezinfektimin (dezinfektimin) e mjediseve të dhomave të banimit.
7. Marrjen e masave për krijim e kushteve normale higjieno-sanitare të mjediseve për takime me familjarët dhe pajisjen e tyre me orënditë e domosdoshme.
8. Marrjen e masave për krijimin e mjediseve të punës për punonjësit e sektorit të kujdesit social brenda në regjim.
9. Marrjen e masave për ndarjen e të dënuarve të grup moshës 18-21 vjeç, në sektor të veçantë.
10. Marrjen e masave urgjente për të rregulluar ambientet e dhomave ku sektori shëndetësor kryen shërbimet; dhomën ku mjeku bën vizitat, dhomën e infermierisë dhe ato të farmacisë.
11. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organikë të të paktën dy mjekëve të tjerë në sektorin shëndetësor.
12. Kompletimin e dhomës së stomatologjisë me instrumente dhe materiale dentare të domosdoshme për kryerjen me efikasitet të këtij shërbimi
13. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të dënuarve me libereza shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumentet përkatëse në rastet e transferimeve nga një IEVP në tjetrën.
14. Marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e telave të korrentit të paizoluara dhe instalimin e prizave në ambientet e dhomave, si dhe të dusheve.



15. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin si të ujit të rrjedhshëm, ashtu edhe të energjisë elektrike 24 orë në ditë.

#### **IEVP Kukës – Datë 16. 06. 2015**

Vizita periodike inspektuese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në I.E.V.P Kukës për vitin 2015 u krye në përputhje me metodologjinë dhe procedurën e zhvillimit të inspektimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Objektivi kryesor i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i personave të paraburgosur që ndodheshin në këtë institucion në momentin e inspektimit.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës, me urdhër nr. 329, datë 15/01/2009, "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", kategorizohet institucion paraburgimi.

Në bisedën paraprake me drejtorin e I EVP Kukës z. Dida, grupi inspektues evidentoi të njëjtat probleme të konstatuara në këtë institucion gjatë vizitës inspektuese të vitit 2014 kryesisht mbi ambientet tejet të amortizuara të këtij institucioni, kushteve të higjenës së përbashkët e asaj personale, mbi mungesën e kushteve për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, etj. Në këtë takim, grupi inspektues u informua për situatën e përgjithshme në institucion dhe mbi gjendjen aktuale të këtij institucioni duke evidentuar si problematikën më kryesore faktin që I.E.V.P. ndodhet nëntokë. Z. Dida, në zbatim edhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit, për mbylljen e kësaj godine, na informoi se tashmë është gjetur godina e re për I.E.V.P-në Kukës, (me Vendimin nr. 22, datë 10.02.2015 të Këshillit Bashkiak Kukës është vendosur t'i propozohet Këshillit të Ministrave për kalimin e ish Spitalit Ushtarak Kukës, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, I.E.V.P Kukës) por që ky proces transferimi dhe kalimi pronësie është shumë i ngadaltë. Ndërkohë që rekomandimet e tjera të bëra nga Avokati i Popullit për vitin 2014, mbeteshin të porealizuara e më konkretisht:

- Gjetja e zgjidhjes për vendosjen e kutisë së kërkesë/ankesave që duhet të ekzistojë në seksione, mundësisht afër me telefonin, që të dënuarit ta shfrytëzojnë të drejtën e ankimit.
- Mundësimi brenda skemës së sigurisë për hapjen e dyerve për të lehtësuar ajrosjen në ambientet e paraburgimit.
- Pajisja e institucionit me autoambulancë.
- Shtimi në organikë i mjekut me kohë të plotë në sektorin shëndetësor.
- Pajisja e të gjithë të paraburgosurve me librezë shëndetësore.

Gjatë vizitës inspektuese në institucion gjendeshin 58 të paraburgosur prej të cilëve një me probleme të shëndetit mendor, i cili ndodhej nën hetim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë, si dhe 2 shtetas kosovarë. Kapaciteti zyrtar i paraburgimit ishte 36 persona. Pra ky institucion ishte në kushte mbipopullimi. Gjithsej regjimi kishte 17 dhoma dhe të paraburgosurit ishin të vendosur në dhoma teke, dyshe dhe treshe. Organika institucionale ishte e plotësuar.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

- Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e I.E.V.P-së Kukës dhe përshpejtimin e procedurave të kalimit, transferimit të pronësisë së godinës së re të ish Spitalit Ushtarak Kukës tek Ministria e Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për I.E.V.P Kukës si dhe gjetjen e mundësive (financiare dhe materiale) për përshtatjen e godinës së re të I.E.V.P-së Kukës, sipas standardeve ligjore me qëllim trajtimin e të paraburgosurve sipas të drejtave të tyre legjitime.

Deri në përfundimin e procesit të transferimit nga godina e vjetër në godinën e re, të merren masa për:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në këtë I.E.V.P.
2. Mundësimin brenda skemës së sigurisë për hapjen e dyerve për të lehtësuar ajrosjen, për arsye se korridori është shumë i ngushtë dhe dhomat ndodhen në katin përdhes të godinës, gjë e cila nuk lejon ajrosjen e mirë të dhomave.
3. Gjetjen e zgjidhjes për vendosjen e kutisë së kërkesë/ankesave që duhet të ekzistojë në seksione, mundësisht afër me telefonin, që të dënuarit ta shfrytëzojnë të drejtën e ankimit.
4. Marrjen e masave për pajisjen me produkte higjieno-sanitare të të paraburgosurve.
5. Marrjen e masave për shtimin në organikë e mjekut me kohë të plotë në sektorin shëndetësor.
6. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me librezë shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse edhe në rastet e transferimeve nga një I.E.V.P në tjetrën.
7. Marrjen e masave për pajisjen me medikamente të farmacisë, si për sëmundjet akute gjithashtu dhe ato kronike.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me autoambulancë.
9. Marrjen e masave për përmirësimin e shërbimit dentar dhe pajisjen e kabinetit të stomatologut me instrumente dhe materiale dentare.
10. Marrjen e masave për pajisjen e kuzhinës së institucionit me frigorifer për kampionët ushqimorë.

### **IEVP Tropojë – Datë 17.06.2015**

Vizita pranë institucionit të I.E.V.P Tropojë shënoi vizitën e radhës së grupit të inspektimit të MKPT-së sipas planit të punës miratuar nga Avokati i Popullit. Vizita inspektuese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë tepër të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtori i Institucionit na u ofrua mundësia që të kishim akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhet të vizitonim. Objektivi kryesor i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i personave të paraburgosur dhe të burgosur që ndodheshin në këtë institucion.

Sipas urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tropojë, kategorizohet institucion me dy regjime; paraburgimi dhe burgimi. Megjithatë ambientet e brendshme të këtij institucioni, nuk kishin një ndarje të tillë por të dënuarit/ paraburgosurit gjendeshin në regjim të ndarë në dhoma të veçanta sipas kategorive përkatëse.

Institucioni i I.E.V.P Tropojë ka kryer transferimin e të paraburgosurve në ambientet e godinës së re, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, të datës 06.05.2015.

Aktualisht në këtë institucion gjendeshin 29 persona të privuar nga liria, nga të cilët 17 ishin të dënuar dhe 12 të paraburgosur.

Edhe në këtë monitorim, qëllimi i vizitës së grupit monitorues, përfshiu verifikimin e përmbushjes së standardeve në godinën aktuale të I.E.V.P Tropojë.

Grupi i ekspertëve konstatoi se marrëveshja e bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe asaj të Policisë së Shtetit, në lidhje me dhomën e paraburgimit të këtij institucioni të venë nën administrimin e Komisarariatit të Policisë Tropojë, ishte rivënë në fuqi me shkresën nr. Prot 2157/1, datë 17.03.2015. Nga ana e Drejtorit të I.E.V.P-së Tropojë, na u bë me dije se është kërkuar shfuqizimi i kësaj marrëveshje pasi kapacitetet e I.E.V.P-së janë të vogla dhe mbajtja e një dhome paraburgimi për llogari të Komisarariatit të Policisë Tropojë i shkaktonte probleme mbipopullimi.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Të merren masa të menjëhershme për zgjidhjen e situatës së mbipopullimit në I.E.V.P Tropojë, nëpërmjet transferimit të të dënuarve, vendbanimi i të cilëve apo familjarëve të tyre është jashtë Bashkisë Tropojë.
2. Shfuqizimin e marrëveshjes për përdorimin e dhomave të sigurisë nga ana e Komisarariatit të Policisë Bajram Curr në ambientet e I.E.V.P Tropojë.
3. Të merren masa për mbështetje me bazë materiale e financiare për të mundësuar realizimin e aktiviteteve e veprimtarive me karakter edukativ, social, artistik, kulturor e fetar. Të krijohet mundësia e zhvillimit të kurseve të formimit arsimor e profesional në I.E.V.P.
4. Të gjenden modalitetet që marrëveshja tre palëshe për medikamentet të funksionojë edhe në I.E.V.P të cilat janë të vendosura në zona ku nuk ka depo farmaceutike.
5. Marrjen masave urgjente për furnizimin me medikamente të farmacisë së I.E.V.P-së, si për sëmundjet kronike ashtu edhe ato akute.
6. Marrjen e masave për pajisjen e të dënuarve me librezë shëndetësore dhe vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.

#### **IEVP Peqin- Datë 08.07.2015**

Avokati i Popullit është njoftuar më dt.08.07.2015 për refuzimin e ushqimit dhe fillimin e grevës së urisë nga një grup të dënuarish në IEVP Peqin, si mjet proteste ndaj një sërë problemesh të pazgjidhura, lidhur me të drejtat dhe trajtimin e tyre në këtë institucion.

Në vijim të kësaj situatë, në rolin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues, Institucioni I Avokatit të Popullit ka dërguar më dt.09.07.2015

një grup pune i përbërë nga Alfred Koçobashi, Irista Laçi (juristë) dhe Alma Alibali (mjeke psikiatër) për të verifikuar në vend pretendimet e të dënuarve.

Krahas takimit fillestar të zhvilluar me autoritetet drejtuese të IEVP Peqin për situatën e mësipërme, grupi inspektues ka kryer edhe një takim të gjatë dhe ballafaques me të dënuarit që kishin refuzuar ushqimin, duke marrë prej tyre një sërë të dhënash dhe dëshmish mbi problematikat që hasnin në shërbimet penitenciare.

Krahas sa më lart, grupi inspektues ka kontrolluar dhe verifikuar në terren dhe nëpërmjet stafit të burgut të gjitha pretendimet e parashtruara nga ankesat e shtetasve Kastriot Frashëri dhe Lavdrim Muço dhe 10 të dënuarve të tjerë në IEVP Peqin të depozituar pranë institucionit të Avokatit të Popullit më dt 08.07.2015 të cilët pretendonin se ishin në grevë urie për arsye të kushteve degraduese dhe mungesës së sigurisë kolektive në ambientet e observimit dhe mosrespektimit të grevës së urisë të kërkuar me anë të një kërkesë me shkrim nga ana e të dënuarve dhe drejtuar administratës së burgut,

Gjatë shqyrtimit të ankesave N/Komisionerët administruan procesverbale të intervistave me ankuesit Kastriot Frashëri dhe Lavdrim Muço dhe pjestarët e tjerë të grevës së urisë duke u njohur me kushtet e trajtimit të kërkesave të tyre nga ana e administratës së IEVP Peqin. Nga ana e N/Komisionerëve u administruan dhe procesverbale të marrjes në pyetje të personelit mjekësore, atij psiko-social dhe të sigurisë për të cilët ngrihet dyshimi i arsyeshëm se me veprimet dhe mosveprimet e tyre mund të kishin cenuar të drejtat e personave ankues.

Në përfundim të procedurave dhe veprimeve hetimore bazuar në intervista, marrje dëshmish dhe konsultim me regjistrat përkatës, u vërtetua se të 12 të burgosurve ankues banues të dhomës nr. 4 në ambientet e observimit në IEVP Peqin u është shkelur dhe vazhdojnë t'i shkelet e drejta e protestës paqësore për ushtrimin e greves së urisë duke iu mos miratuar kjo kërkesë e tyre legjitime dhe rrjedhimisht mosrespektimi sipas protokolleve ligjore dhe mjekësore të të drejtës për ushtrim të greves së urisë.

Përgjegjës direkt për këtë shkelje të të drejtës së të dënuarve u identifikuan shtetasit Edlir Kazazi me detyrë specialist i regjimit të brendshëm, Siguri e Zakonshme, Godina A dhe z. Besnik Kaptelli me detyrë shef i sigurisë IEVP Peqin. Këta dy shtetas kishin administruar kërkesën me shkrim nga ana të burgosurve Lavdrim Muço dhe Kastriot Frashëri gjithashtu dhe të dënuarve të tjerë për miratimin dhe krijimin e kushteve për ushtrimin e grevës së urisë por nuk e kishin depozituar atë pranë administratës së institucionit sipas procedurave ligjore<sup>8</sup> të administrimit të kërkesave- ankesave dhe regjistrimit të kërkesës në regjistrin përkatës dhe njoftimit të titullarit të Institucionit. Ky mosveprim i personave të mësipërm ka shkaktuar vuajtje, trajtim degradues dhe vështirësi fizike për personat në grevë urie duke u shkaktuar dhe probleme shëndetësore atyre, të krijuara si rezultat i mosinformimit dhe rrjedhimisht mosveprimit të sektorit shëndetësor dhe atij

---

<sup>8</sup> Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 8283, date 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve": "Të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale". Gjithashtu në Nenin 25 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve parashikohet që: "Kërkesat dhe ankesat bëhen sipas përcaktimeve të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve; Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të dënuarve dhe të paraburgosurve, në formë shkresore dhe elektronike.."

psiko-social të cilët duhet të ishin lajmëruar dhe vënë në lëvizje të menjëhershme kur greva e urisë miratohet dhe zyrtarizohet nga ana e Institucionit. Megjithatë vlerësojmë se dhe në rastet kur këto shërbime nuk lajmërohen zyrtarisht ato duhet të marrin përgjegjësitë e tyre dhe duhet të jenë të disponueshëm dhe në kontakt të përditshëm me të dënuarit në regjim dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur në informimin e Drejtuesve të institucionit dhe të ofrojnë shërbimet e duhura mjekësore dhe psikologjike për raste të tilla.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen në analizë të rastit të shkeljes së të drejtave të grevës së urisë të të burgosurve të dhomës nr.4 sektori i Observimit I EVP Peqin dhe fillimin e procedurave administrative për marrjen e masave disiplinore ndaj z.Edlir Kazazi me detyrë specialist i regjimit të brendshëm dhe z.Besnik Kaptelli me detyrë Shef i Sigurisë, I EVP Peqin.
2. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit të Institucionit lidhur me analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për mos koordinimin nga ana e sektorëve të sigurisë dhe atij shëndetësor dhe psiko-social në krijimin e kushteve të nevojshme për të dënuarit në rastet kur janë në grevë urie.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në I EVP Peqin me objektivin që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person konform nenit 22, pika 1 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit në I EVP Peqin në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 *”Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”*, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
5. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit të Institucionit lidhur me dhënien fund të situatës degraduese dhe kushteve të trajtimit jonjerëzorë të 16 të burgosurve në dhomën nr. 4 të sektorit të Observimit në respekt të plotë të Rregullores së përgjithshme e Burgjeve, nenit 21, pika 1, *“I burgosuri qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë dhe më pas vendoset në ambientin e banimit. Në vendosjen e të burgosurve nëpër dhoma mbahen parasysh kritere që lidhen me masën e dënimit, moshën, gjëndjen shëndetësore, ...*

**IEVP Berat** – Datë 03.09.2015

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në I.E.V.P Berat për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr. K/4I46-2, datë 19.11.2014 me lëndë: *“Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në I.E.V.P Berat”*.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me të burgosurit dhe me stafin e I.E.V.P Berat, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve dhe mjediseve, rezultoi shumë nga rekomandimet e një viti më parë kishin gjetur zbatim pasi me transferimin dhe marrjen në dorëzim të godinës së re të I.E.V.P Berat, do të përmirësoheshin ndjeshëm një sërë problematikash që janë konstatuar në ambientet e mëparshme të I.E.V.P-së Berat. Ndërkohë mbeten të përpunuara një sërë rekomandimesh siç është punësimi i një mjeku me kohë të plotë. Edhe pse ambientet e kësaj I.E.V.P-je ishin të reja, kaldaja zilet e emergjencës në dhoma, brenda në regjim, nuk ishin funksionale. Ndërkohë nga inspektimi i kryer një sërë ambientesh si dhoma e Stomatologut, dyqani i I.E.V.P-së, salla e televizorëve, palestra, ambienti i besimtarëve të krishterë dhe lavateria e I.E.V.P-së, ishin jofunksionale për shkak të mungesës së orendive.

Institucioni ka kapacitet maksimal prej 99 personash. Në momentin e vizitës inspektuese, në mjediset e institucionit ishin 113 persona të paraburgosur si dhe 5 persona që mbaheshin për llogari të Drejtorisë Policisë së Qarkut Berat, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis D.P.Burgjeve me nr. Prot 2157/1, datë 17.03.2015 dhe DPP së Shtetit me nr. Prot 1054/1, datë 16.03.2015. Me hapjen e ambienteve të reja, (godina nr. 2) disa ditë para inspektimit të kryer nga grupi inspektues, mbipopullimi nuk mund të konsiderohej problematik, pasi kishte disa të paraburgosur mbi kapacitetin zyrtar.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 6 të paraburgosur.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për mos përsëritjen e situatës së përdorimit të dhomave të transitit, si dhoma veçimi/izolimi për të paraburgosurit me masa disiplinore, pasi mbajtja e të paraburgosurve në këto mjedise përbën trajtim çnjerëzor, johuman dhe degradues.
2. Marrjen e masave të menjëhershme që i paraburgosuri surdo-mutizëm, (shurdh-memec) dhe i paraburgosuri me një këmbë të amputuar, të vendosen në sektor të veçantë dhe të trajtohen me shërbim të specializuar.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për lejimin e patericës për të paraburgosurin me këmbë të amputuar, pasi kjo pajisje do ta ndihmonte në një trajtim më njerëzor, dinjitoz dhe human.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për punësimin e një mjeku me kohë të plotë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante të mjekut stomatolog, farmacistit dhe një infermieri.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në funksionim të dhomës së stomatologut.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në funksionim të kaldajës së institucionit.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për hapjen e dyqanit në ambientet e brendshme të I.E.V.P-së.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me orenditë përkatëse të ambienteve të kultit për të paraburgosurit e krishterë, sallës së TV, palestrës së I.E.V.P-së.
10. Marrjen e masave për vënien në funksionim të lavdërisë së institucionit.

## 11. Marrjen e masave për rregullimin e zileve të emergjencës brenda dhomave në regjim.

### **IEVP Burrel – Datë 28.09.2015**

Vizita monitoruese pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Në mungesë të Drejtorit nga ana e shefit të sektorit të sigurisë dhe zyrat e shërbimeve të institucionit grupit monitorues iu ofrua mundësia që të kishte akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që u monitoruan.

Gjatë takimit, grupi inspektues kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat e të burgosurve/paraburgosurve si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit me anë të shkresës nr. K-4 I 81-2, datë 19.01.2015. Sipas të dhënave që u morën gjatë kësaj vizite, informacioneve të marra nëpërmjet intervistave konfidenciale me personat e privuar nga liria, si dhe bisedat me stafin e institucionit, rezultoi se një rekomandim i kësaj shkrese kishte gjetur zbatim dhe konkretisht krijimi i një sektori të veçantë për 18-21 vjeçarët. Ndërkohë disa nga rekomandimet e një viti më parë ishin pjesërisht të realizuara, por pjesa më e madhe e tyre nuk kishin gjetur zbatim.

Në bazë të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 329, datë 15/01/2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel kategorizohet “Burg i sigurisë së lartë, me një seksion të sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi. Kapaciteti aktual i institucionit është për 198 persona.”

Në datën 28.09.2015 në këtë institucion gjendeshin 202 persona. Ndarja në sektorë ishte: 79 të paraburgosur, 24 siguri e lartë dhe 99 të dënuar në sektorin e sigurisë së zakonshme. Në institucion përdoreshin 3 dhoma si mjedise observim-veçimi, në të cilat në momentin e inspektimit nuk ndodhej njeri. Kategori të veçanta në këtë institucion ishin 9 të sëmurë, nga të cilët 6 të sëmurë të shëndetit mendor dhe 2 diabetik. Gjatë takimit u informuam se strukturë-organika e institucionit, ka një shkurtim të punonjësve të IEVP-së, nga 162 në 153.

Në IEVP Burrel ka një sektor të veçantë për 18-21 vjeçarët.

Gjatë takimit prezantues, drejtuesit e seksioneve pranuan se në aspektin material infrastruktura e institucionit është e vjetëruar dhe e degraduar pavarësisht përpjekjeve për ta riparuar. Mundësitë janë të kufizuara nga mungesa e fondeve të konsiderueshme për të ndërmarrë një iniciativë të tillë. Vetëm kuzhina e IEVP do të rikonstruktohet me një donacion të Bankës Raiffeisen. Në përgjigje, grupi i monitorimit sqaroi se mendimi i institucionit të Avokatit të Popullit i shprehur dhe në rekomandimet e shkuara është marrja në konsideratë nga ana e DPBurgjeve për hartimin dhe miratimin e një projekti për ndërtimin e një institucioni të ri.

Gjatë vizitave të vazhdueshme në këtë institucion dhe këtë radhë konstatohet mungesa e ambienteve të tualeteve në dhoma në sigurinë e lartë dhe dusheve brenda sektorit, për të cilat në takimin paraprak na u sqarua se janë parashikuar të bëhen investime në këtë sektor. Gjithashtu problematik në këtë IEVP janë tualetet dhe dushet në sektorin e paraburgimit, të cilët janë jofunksional dhe jashtë të gjithë parametrave të higjienës. Mungesa e herëpashershme e ujit të rrjedhshëm e përkeqësonte më tej situatën në këto ambiente.

Në përgjithësi kushtet e godinave ishin jo të mira dhe të pamjaftueshme për aktivitete social-kulturore. Në to vihej re mungesa e një sistemi efikas ngrohjeje për periudhën e dimrit dhe e sistemit të ajrimit të mjaftueshëm. Gjithashtu edhe instalimet elektrike e ato hidrosanitare rezultojnë të amortizuara.

Takimi përmbyllës u zhvillua me drejtorin e I EVP Burrel, të cilit i'u bënë me dije disa nga gjetjet kryesore të monitorimit të cilat do të ishin pjesë e rekomandimit të Avokatit të Popullit.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

#### ❖ **Mbylljen e I EVP Burrel.**

##### **Deri në dhënien zgjidhje rekomandimit të mësipërm, u rekomandua:**

1. Marrjen e masave për rikonstruksionin e plotë të të gjitha ambienteve të këtij institucioni.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për rregullimin e situatës së shpërblimit për punën e kryer të të paraburgosurve/dënuarve, sipas dispozitave të nenit 34 dhe 35 të Ligjit nr. 8328 dt. 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e sistemit të kërkesë-ankesave në institucion, duke kthyer përgjigje me shkrim të paraburgosurve dhe të dënuarve brenda afateve ligjore.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për riparime, mirëmbajtje, eliminim lagështire dhe lyerje të dhomave të të dënuarve. Përmirësimin e ambienteve të përbashkëta të jetesës duke kryer sa më parë riparimet e nevojshme të banjave të përbashkëta në sektorë, riparimin e tubacioneve dhe pajisjeve hidrosanitare të prishura, ndriçuesve dhe lidhjeve elektrike sipas standardeve të sigurimit teknik.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për respektimin e hapësirës personale prej 4m<sup>2</sup> në dhoma.
6. Marrjen e masave për të siguruar që të gjithë të dënuarit të jenë të pajisur me sasinë e mjaftueshme të produkteve bazë të higjienës personale (përfshirë pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) si edhe me materialet e nevojshme për të pastruar qelitë e tyre.
7. Marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes në të gjithë sektorët, sipas standardeve të parashikuara në rregulloren e burgjeve.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për standardizimin e çmimeve në dyqanin e I EVP-së, si dhe të kartave telefonike, me çmimet e tregut jashtë institucionit me qëllim adresimin e shqetësimit të të dënuarve/ paraburgosurve për çmimet e larta të tyre.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjithë të dënuarit/paraburgosurit edhe për sëmundjet akute.
10. Marrjen e masave për kryerjen e konsultimeve më të shpeshta për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, në mënyrë që të rivlerësohet dhe saktësohet diagnoza dhe mjekimi përkatës.
11. Marrjen e masave për ofrimin e një shërbimi të plotë dhe adekuat stomatologjik.
12. Marrjen e masave për sigurimin e të drejtës për ushtrimin e besimeve fetare për të paraburgosurit/dënuarit.



13. Marrjen e masave për përmirësimin e ambienteve të takimeve me familjarët dhe krijimin e një dhome të veçantë dhe të përshtatshme për takime të të dënuarve me fëmijë të mitur.
14. Marrjen e masave për të përmirësuar mjedisin e ajrimit për t'iu përshtatur kushteve klimaterike edhe nevojës për gjelbërim.
15. Marrjen e masave për gjetjen e një zgjidhjeje për të ofruar shërbimin e luanterisë nga institucioni për veshjet dhe rrobat personale për të dënuarit.
16. Marrjen e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi dhe aktivitete social-kulturore-sportive.

### **IEVP Tepelenë – Datë 05.10.2015**

Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Në përputhje me metodologjinë u zhvillua takimi fillestar me Drejtorin e institucionit të cilit iu bë me dije qëllimi i vizitës, dhe iu kërkua një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes së institucionit. Nga ana e tij ekspertëve iu mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat, ambientet dhe objektet që do të monitoroheshin.

Me urdhër nr. 329, datë 15/01/2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve IEVP Tepelenë është kategorizuar si burg i sigurisë së lartë me një seksion sigurie të zakonshme dhe një seksion paraburgimi. Ndërsa kapaciteti maksimal i kësaj I.E.V.P. -je është 70 persona, në ditën e vizitës, I.E.V.P. Tepelenë strehonte 108 të paraburgosur (2 prej të cilëve ishin dërguar për trajtim në IVSHB ndërsa 1 person në reanimacion në QSUT), dhe 24 të dënuar. Në total në institucion trajtoheshin 10 persona të moshës 18-21 vjeçare.

Nga informacioni i grumbulluar në vend përmes kryerjes së intervistave në privatësi pa dëshmitarë me të paraburgosurit dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi se ndonëse ishin bërë disa përpjekje për të përmbushur rekomandimet, p.sh., shtimi i numrit të kamerave të sigurisë apo vendosja e një limitatori nga jashtë ambientit të dusheve, pjesa dërrmuese e rekomandimeve të bëra në shkresën e përmendur më lart, ende nuk kishin gjetur zbatim.

Për sa më sipër u rekomandua:

- Mbylljen e I.E.V.Penale Tepelenë, pasi nuk ofron asnjë kusht për trajtimin dinjitoz të të paraburgosurve/dënuarve në përputhje me standardet. Infrastruktura aktuale pengon në garantimin e të drejtave të personave të trajtuar në këtë institucion, ndaj ata duhet të transferohen në mënyrë të menjëhershme në institucione të tjera që mundësojnë procesin e rehabilitimit përmes ofrimit të shërbimeve të nevojshme.

Deri në përmbushjen e këtij rekomandimi, duhet të merren masa për:

1. Plotësimin e organikës së sektorit shëndetësor me një mjek me kohë të plotë që të mundësojë kryerjen e vizitave të rregullta si dhe pajisjen e të gjithë të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore me qëllim vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve, në mënyrë që edhe furnizimi me ilaçe si për sëmundjet akute ashtu dhe ato kronike të kryhet sipas kësaj skeme.

## **IEVP Sarandë – Datë 06.10.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në IEVP Sarandë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e të paraburgosurve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201402313 Prot. K1/I82-2, datë 19.01.2015, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të paraburgosurve në IEVP Sarandë”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat që trajtoheshin në këtë qendër dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që vetëm dy rekomandime kishin gjetur zbatim; ai lidhur me administrimin dhe menaxhimin e regjistrave të masave disiplinore e dosjeve personale të të paraburgosurve nga sektori juridik dhe ai mbi pajisjen e kuzhinës me frigorifer dhe bolierë, megjithëse mungonte ende aspiratori. Ndërkohë që mbeteshin të porealizuara të gjitha rekomandimet e tjera.

IEVP Sarandë me një kapacitet zyrtar prej 31 personash, në momentin e vizitës inspektuese kishte 51 persona, një problematikë kjo e shfaqur edhe në inspektimin e një viti më parë me një mbipopullim prej 20 të paraburgosur mbi kapacitet.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

- ❖ Mbylljen e menjëhershme të kësaj IEVP-je, pasi me gjithë rekomandimet vit pas viti të bëra nga Avokati i Popullit, për rikonstrukcionin e plotë të këtij institucioni, në mënyrë që të përmirësohen kushtet dhe të ofrohen shërbime në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, ai mbetet një institucion i cili mban persona në kushte johumane dhe degraduese.

Deri në gjetjen e një zgjidhjeje për zbatimin e këtij rekomandimi u rekomandua:

1. Marrjen e masave për adresimin e çështjes së ambienteve të këtij Institucioni të vëna në shërbim të Komisarariatit të Rrethit Sarandë, në përmbushje të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Brendshme. Në kushtet kur institucioni funksionon në

mbipopullim, dhe për mungesë ambienti nuk u ofron dot shërbimet e nevojshme të paraburgosurve të kësaj I.E.V.P-je, përjashtimi i Institucionit nga kjo marrëveshje, do të ishte zgjidhja e duhur për të mundësuar rikonstruksionin e plotë të I.E.V.P. Sarandë me qëllim përmbushjen e kushteve dhe standardeve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

2. Marrjen e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me Burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës të dhomës së observim/veçimit, sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.
4. Marrjen e masave për ndarjen sipas kategorive 18-21 vjeçar, të sëmurë mendorë dhe persona abuzues me substanca narkotike, e parashikuar kjo në nenin 29 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
5. Marrjen e masave për riparimin e plotë të dusheve dhe tualeteve, si dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të tyre.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e të paraburgosurve me paketën bazë të higjienës personale si dhe me detergjente.
7. Marrjen e masave për vënien në shërbim të të paraburgosurve të një dyqani për blerjen e produkteve bazë sipas nevojave të tyre.
8. Marrjen e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigorozitet të urdhrat të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/kërkesave.
9. Marrjen e masave për shtimin në organikë të farmacistit dhe stomatologut, në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më efikas shëndetësor.
10. Marrjen e masave për pajisjen e Institucionit me një autoambulancë.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të skemës së rimbursimit të ilaçeve.
12. Marrjen e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me ilaçe të urgjencës si dhe ilaçe për sëmundjet kronike.
13. Marrjen e masave për sigurimin e regjistrave dhe kartelave të standardizuara nga DPB-ja për këtë institucion.

**IEVP Elbasan** - Datë 15.10.2015

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me Drejtuesin e institucionit. Nga ana e tij u shpreh gadishmëria dhe disponibiliteti për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues. Në bisedën paraparake, grupi monitorues, duke patur parasysh se I.E.V.P-ja Elbasan është një institucion i ri kërkoi kryesisht

informacion në lidhje me mbarëvajtjen e punës, shërbimeve dhe trajtimin e të paraburgosurve. Nga pikëpamja e organizimit infrastrukturor, I.E.V.P. Elbasan realizonte strehimin e të paraburgosurve në 3 godinat e institucionit.

Godinat e banimit, ishin të organizuara në 4 sektorë secila. Në godinën nr.3, kati i dytë në sektorin 2 ishin të strehuar të paraburgosur të grupmoshës 18-21 vjeçare. Secili prej sektorëve të paraburgimit të godinave të larpërmendura ishin të pajisura me dhoma veçimi për vuajtjen e masave disiplinore “veçim i përkohshëm nga aktivitetet e përbashkëta”. Institucioni i paraburgimit Elbasan ishte i pajisur me dhoma observimi, 2 të tilla me nga 2 shtretër secila. Institucioni ishte i pajisur me sistem ventilimi dhe ngrohjeje qendrore, si dhe me sistem të mbrojtjes kundër zjarrit.

Gjithashtu institucioni kishte ambient sportiv (fushë futbollit/kalçeto), lavanteri, kuzhinë moderne, si dhe ambient për dhomë kulti, bibliotekë, spital/infermieri, si dhe ambient palestere. Sektorët, në të cilët ishin dhe dhomat e banimit të të paraburgosurve, ishin të organizuar në këto ambiente: dhoma banimi, ambiente të përbashkëta, dhomë këshillimi, klasa, banjë e jashtme e përbashkët, ambient dushi për një person, magazinë. Dhomat e banimit ishin projektuar për 1, 2, 3, 4 e 5 persona. Dhomat e banimit ishin të pajisura të gjitha me ambient banjoje.

Kapaciteti zyrtar i I.E.V.P-së Elbasan është 120 persona, ndërsa në kohën e monitorimit, institucioni strehonte 225 persona të paraburgosur.

Në kohën e monitorimit në institucion gjendeshin 21 persona të grupmoshës 18-21 vjeçare, të akomoduar në 5 dhoma të veqanta, ndërsa pjesa tjetër ishin të paraburgosur të grupmoshës së rritur. Në institucion, të paraburgosurit e grupmoshës së rinj (18-21 vjeçare), ishin të sistemuar në një sektor më vehte, konkretisht në godinën nr. 3, kati II, sektori 2. Në kohën e monitorimit, nuk kishte asnjë të paraburgosur ndaj të cilit të ishte marrë ndonjë masë disiplinore.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin 13 të paraburgosur të punësuar.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në I EVP Elbasan dhe respektimin e hapësirës personale për të paraburgosurit në dhomat e banimit.
2. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të banimit të paraburgosurve.
3. Marrja e masave për furnizimin me ujë të rrjedhshëm 24 orë të mjediseve të banimit të paraburgosurve në këtë institucion.
4. Marrja e masave për rregullimin e menjëhershëm të sistemit të aspirimit në ambientet e dusheve dhe riparimin e kokave të dusheve.
5. Marrjen e masave për mundësimin e larjes më të shpeshtë në dushe me ujë të ngrohtë për të paraburgosurit.
6. Marrjen e masave të nevojshme për riparimin e stolave dhe orendive të dëmtuara në disa dhoma të paraburgimit.

7. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin me dollape rrobash të dhomave të paraburgosurve.
8. Marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e palestrës me paisjet e nevojshme dhe vënien e saj në fuksion me kapacitet të plotë.
9. Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me DAR për zhvillimin e kurseve arsimore në I.E.V.P. Elbasan.
10. Marrjen e masave të menjëhershme për punësimin e një mjeku me kohë të plotë në I EVP Elbasan.
11. Marrjen e masave të nevojshme lidhur me vendosjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi institucionale me Spitalin Rajonal dhe atë Psikiatrik për të pasur akses për të gjitha llojet e konsultave, ekzaminimeve apo analizave të domosdoshme për të paraburgosurit në këto spitale për rastet specifike.
12. Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e medikamenteve për të paraburgosurit nga vetë institucioni dhe në një kohë sa më të shkurtër, duke e bërë më të funksionueshme marrëveshjen trepalëshe për rimbursimin e medikamenteve.
13. Marrjen e masave për pajisjen e të gjithë të paraburgosurve me librezat shëndetësore, duke përshpejtuar procedurën e plotësimit me dokumente përkatëse edhe në rastet e transferimeve nga një I EVP në tjetrën.
14. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen dhe vënien në funksionim të kujdesit stomatologjik në institucion duke siguruar furnizimin e dhomës së stomatologut me instrumente dhe materialet dentare.
15. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen dhe përmirësimin e cilësisë së rrobave të fjetjes si çarçafëve, jastëkëve dhe batanijeve për të gjithë të paraburgosurit;

### **IEVP Rogozhinë - Datë 21.10.2015**

Vizita monitoruese e Avokatit të Popullit dhe stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Nga Drejtoria e Institucionit Avokatit të Popullit dhe ekspertëve iu mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion, brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që do të monitoroheshin. Objektivi kryesor i vizitës monitoruese ishte vlerësimi i kushteve dhe trajtimi i të dënuarve/ paraburgosurve.

Me Urdhër Nr. 329, datë 15.01.2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, I EVP Rogozhinë kategorizohet “Burg i sigurisë së zakonshme me një seksion paraburgimi.” Kapaciteti maksimal i tij është 345 persona. Në kohën e vizitës, I EVP Rogozhinë strehonte 437 të dënuar/ paraburgosur.

Gjatë vizitës, grupi monitorues pati si fillim një takim me Shefin e Zyrës Juridike i cili në mungesë të Drejtorit bëri një pasqyrë të situatës aktuale në institucion duke evidentuar se një nga problemet kryesore të institucionit ishte mbipopullimi. Në momentin e inspektimit ky institucion

kishte një numër prej 437 personash, të cilët ishin të ndarë sipas kategorive, 189 të paraburgosur dhe 248 të dënuar. I EVP Rrogozhinë ofronte mundësi punësimi për 8 të paraburgosur dhe 44 të dënuar. Kryesisht të dënuarit/ paraburgosurit punonin në kuzhinë, lulishte, pastrim, bibliotekë, mirëmbajtje, etj. Nuk pati ankesa për sa i përket njohjes së ditëve të punës dhe dhënies së dinamikave të punësimit personave të interesuar.

Kategori të veçanta ishin personat me probleme të shëndetit mendor, dhe persona të sëmurë kronik të dërguar për trajtim të specializuar mjekësor pranë IVSHB Tiranë dhe persona të grup-moshës 19-21 vjeçare.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për të kufizuar mbipopullimin në I EVP Rrogozhinë me objektivin që çdo qeli të ofrojë minimalisht 4m<sup>2</sup> hapësirë jetike për person.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të Nenit 24 të ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “*Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve*”, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e përdorimit të ambienteve të izolim/veçimit për të dënuarit/ paraburgosurit përtej kohës së parashikuar nga ana e komisionit të disiplinës, dhe për ndërprerjen e vendosjes për një kohë të gjatë në këto ambiente të personave që nuk janë subjekt i masave disiplinore.
4. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Drejtuesit të institucionit lidhur me çrrënjosjen e rasteve të keqtrajtimit fizik të të burgosurve nga stafi i sigurisë duke përmirësuar menaxhimin dhe mekanizmat mbikëqyrës të cilët mundësojnë vënien para përgjegjësisë të personave të cilët përdorin praktika të keqtrajtimit fizik të paraburgosurve apo përdorim të tepruar të forcës.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të jetesës të dhomave të të paraburgosurve, riparimin e tualeteve dhe përmirësimin e higjienës në dhoma.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e dhomave të veçimit me tavolina, e dollapë rrobash në mënyrë që të mundësohet ushqimi dhe kushtet bazë të jetesës në mënyrë dinjitoze dhe njerëzore.
7. Marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e bojlerëve për sigurimin e ujit të ngrohtë për larje në sektorin e veçimit atë të observimit dhe në ambiente të tjera ku ato ishin me defekt.
8. Marrjen e masave për riparimin e instalimeve elektrike dhe disiplinimin e lidhjeve elektrike provizore të ekspozuara sipas normave të sigurimit teknik.
9. Marrjen e masave nga ana e personelit mjekësor të këtij institucioni për kryerjen e kontakteve të shpeshta me të dënuarit/ paraburgosurit dhe përgjigjen në kohë të kërkesave të tyre për vizita mjekësore, si për evidentimin e rasteve të reja ashtu dhe për ndjekjen e të sëmurëve kronikë.
10. Marrjen e masave për furnizimin e kabinetit të stomatologut me instrumente dhe materiale dentare, me qëllim ofrimin e një shërbimi stomatologjik adekuat dhe në kohë me ndërhyrjet përkatëse.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e të gjithë të dënuarve/ paraburgosurve të këtij institucioni me librezë shëndetësore.

12. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien në zbatim të marrëveshjes trepalëshe ndërmjet DRSKSH-së, IEVP-së dhe depos farmaceutike Omega Farma, në mënyrë që të vihet në funksion të skema e rimbursimit të ilaçeve si për sëmundjet kronike ashtu dhe për ato të urgjencës, duke siguruar kështu një furnizim të rregullt të këtij Institucioni me medikamente.
13. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin e Institucionit me medikamente kryesisht të urgjencës.
14. Marrjen e masave të nevojshme nga ana e personelit përgjegjës për të mundësuar këshillime individuale e në grup në dhoma të planifikuara për këshillim si dhe shtimin e aktiviteteve social-kulturore-sportive me të dënuarit për qëllime rehabilitimi, këshillimi dhe ri-integrimi.
15. Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të veçantë të pajisur me sendet e nevojshme dhe klimë të ngrohtë dhe miqësore për takimet e të dënuarve/paraburgosurve me fëmijët e mitur dhe të moshuarit.

### **IEVP Vlorë – Datë 22.10.2015**

Vizita monitoruese e stafit të MKPT-së pranë këtij institucioni u zhvillua në një frymë shumë të mirë bashkëpunimi. Në përputhje me metodologjinë u zhvillua takimi fillestar me Drejtorin e institucionit të cilit iu bë me dije qëllimi i vizitës, dhe iu kërkua një pasqyrë e përgjithshme e gjendjes së institucionit. Nga ana e tij ekspertëve iu mundësua kryerja e inspektimit të jashtëm dhe të brendshëm në Institucion brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat, ambientet dhe objektet që do të monitoroheshin.

Me urdhër nr. 329, datë 15/01/2009, “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, të ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë kategorizohet “institucion paraburgimi, me një seksion paraburgimi për të mitur dhe një seksion burg i sigurisë së zakonshme.” Ndërsa kapaciteti maksimal i kësaj I.E.V.P. -je është 115 persona, në ditën e vizitës, I.E.V.P. Vlorë strehonte 202 persona (2 prej të cilëve u larguan po të njëjtën ditë), prej nga 23 ishin të mitur dhe 36 të moshës 18-21 vjeçare.

Nga informacioni i grumbulluar në vend përmes kryerjes së intervistave në privatësi pa dëshmitarë me të paraburgosurit dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi se ishin bërë përpjekje për të përmbushur rekomandimet e bëra në shkresën e përmendur më lart, por ende një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kishin gjetur zbatim.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Të merren masa të menjëhershme që të ndalohen në mënyrë absolute rastet e ushtrimit të dhunës, fyerjeve, kanosjeve apo goditjeve ndaj të paraburgosurve të mitur dhe të rritur dhe të merren masa ndaj oficerëve të policisë që kryejnë veprime të këtij lloji.
2. Të merren masa të menjëhershme nga ana e Drejtuesit e institucionit për përforcimin e mekanizmave mbikëqyrës me qëllim parandalimin e rasteve të dhunës dhe vënien para

- përgjegjësisë të personave të cilët përdorin praktika të keqtrajtimit fizik të paraburgosurve apo përdorim të tepruar të forcës.
3. Të merren masa të menjëhershme për ndërprerjen e penalizmave kolektive ndaj të miturve si dhe për ndërprerjen e përjashtimeve të tyre nga aktiviteti mësimor gjatë kohës që rezultojnë me masa disiplinore.
  4. Të merren masa lidhur me përdorimin e masave edukative për të miturit të vlefshme për funksionin e tyre pedagogjik të cilët mundësisht të zëvendësojnë masat disiplinore të parashikuara për të rriturit. Të konsiderohen masat disiplinore në kushte veçimi ndaj të miturve si raste të rralla dhe të përdoren për periudha sa më të shkurtra.
  5. Të merren masa të menjëhershme për mbulimin me kamera të sigurisë të ambienteve të korridorit të hyrjes së godinës “A”.
  6. Të merren masa të menjëhershme për adresimin e situatës së mbipopullimit, në respekt të, Nenit 24 të Ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 *”Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”*, i ndryshuar, ku i sigurohet çdo të dënuari shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.
  7. Të merren masa të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të jetesës në dhoma si dhe në ambientet e observimit dhe izolim/veçimit.
  8. Të merren masa të menjëhershme për pajisjen e të miturve dhe paraburgosurve të rritur me paketa bazë të higjienës personale dhe me detergjente.
  9. Të merren masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit të shëndetësisë, me një mjek me kohë të plotë. dhe me një stomatolog.
  10. Të merren masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së sektorit të shëndetësisë me një stomatolog si dhe për furnizimin e kabinetit të stomatologut me autoklavë dhe materiale dentare, me qëllim ofrimin e një shërbimi stomatologjik adekuat dhe në kohë me ndërhyrjet përkatëse.
  11. Të merren masa të menjëhershme për pajisjen e të gjithë të dënuarve/paraburgosurve të këtij institucioni me libreta shëndetësore.
  12. Të merren masa të menjëhershme për vënien në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe sigurimin kështu të furnizimit të rregullt me to në bazë.
  13. Të merren masa për pajisjen e këtij institucioni me një autoambulancë.
  14. Të merren masa për krijimin e një ambienti në institucion që të funksionojë si lavanderi.
  15. Të merren masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikës së çmimeve në dyqanin e institucionit.
  16. Të merren masa për mbulimin e ambienteve të ajrosjes me qëllim mundësimin e saj edhe për ditët me mot të rënduar.

### **IEVP Kosovë, Lushnjë – Datë 11.11.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në IEVP Kosovë, Lushnjë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr. K/4112-2, datë 11.06.2014 me lëndë: *“Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të burgosurve në IEVP Kosovë, Lushnjë”*.



Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me të burgosurit dhe me stafin e I EVP Kosovë, Lushnjë, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve dhe mjediseve, rezultoi që vetëm tre rekomandime kishin gjetur zbatim: ai i dezinfektimit të mjediseve të dhomave të banimit, ndarja e të dënuarve të grup moshës 18-21 vjeç, në një sektor të veçantë dhe vendosja në dhoma të veçanta të të sëmurëve kronik, ndërkohë që mbeten të porealizuara të gjitha rekomandimet e tjera. Investimi i vetëm i kryer në këtë I.E.V.P ishte izolimi i tarracës dhe pritej që shumë shpejt të investohej në tualetet e përbashkëta të godinës nr.1 dhe kuzhinës së institucionit.

Institucioni ka kapacitet maksimal prej 170 personash. Në momentin e vizitës inspektuese, në mjediset e institucionit ishin 240 persona të dënuar. Mbipopullimi ishte problematikë prezente me 70 të dënuar mbi kapacitetin zyrtar.

Referuar në informacionin e marrë dhe të konfirmuar me listën zyrtare të të punësuarve, në institucion në kohën e monitorimit figuronin të punësuar 37 të burgosur.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në regjim dhe respektimin e hapësirës personale prej 4m<sup>2</sup> në dhoma.
2. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me kushtet higjieno-sanitare të të gjitha mjediseve të regjimit, veçanërisht në lidhje me lagështirën dhe me kanalizimet e ujërave të zeza.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e godinave me mjedise të përshtatshme dushesh.
4. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve materiale dhe higjieno-sanitare të tualeteve.
5. Marrjen e masave lidhur me dezinfektimin periodik të mjediseve të dhomave të banimit.
6. Marrjen e masave nga ana e sektorit të edukimit për zbatimin me rigorozitet të urdhrin të DPB lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/kërkesave.
7. Marrjen e masave për mbulimin me kamera në korridoret pranë dhomave të veçim/observimit.
8. Marrjen e masave për pajisjen, përshtatjen dhe krijimin e kushteve të jetesës sipas standardeve të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të dhomave të observim/veçimit.
9. Marrjen e masave për plotësimin e organikes se këtij institucioni me një mjek me kohe të plotë.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për zbatimin me rigorozitet të kontratës tre palëshe midis I.E.V.P Lushnje, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike, në mënyrë që të sigurohen medikamente për sëmundje kronike dhe akute në kohë dhe në sasi të mjaftueshme duke vënë në funksion të plotë skemën e rimbursimit me ilaçe.
11. Marrjen e masave për trajtimin në sektorë të veçantë, të të dënuarve me probleme të shëndetit mendor, sipas rastit.

12. Marrjen e masave urgjente për pajisjen e farmacisë me ilaçe si dhe orenditë e përshtatshme për mbajtjen e tyre.
13. Marrjen e masave për furnizimin e dhomës së stomatologut me materiale dentare.

**IVSHB**, Tiranë - Datë 25.11.2015

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në IVSHB Tiranë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e të dënuarve/paraburgosurve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201500083/2 Prot. K4/I6-2, datë 22.01.2015, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve/paraburgosurve, pacientë në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve Tiranë”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat që trajtoheshin në këtë institucion dhe me stafin e tij, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që asnjë rekomandim i një viti më parë nuk kishte gjetur zbatim.

IVSHB me një kapacitet zyrtar prej 99 personash, në momentin e vizitës inspektuese kishte 103 persona, ku trajtoheshin 60 të dënuar me masë sigurie "*mjekim i detyruar*" dhe "*shtrim i përkohshëm*" dhënë nga gjykatat respektive, si dhe dëshmitarë procesi gjyqësor në gjykim apo të dënuar që prisnin të kryenin ekspertizën mjeko-ligjore. Pjesa tjetër e të dënuarve/paraburgosurve që gjendeshin në këtë institucion, silleshin për trajtim më të specializuar sipas patologjive të ndryshme që kishin manifestuar në I.E.V.P-të përkatëse. Shërbimi kryesor në I.V.SH.B mbetej ai i kujdesit shëndetësor dhe psiko-social, por trajtimi i tyre vazhdonte të ishte në kushte jo humane dhe degraduese.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Marrjen e masave urgjente për sigurimin e një fondi të posaçëm nga Ministria e Drejtësisë në mënyrë që të realizohet një rikonstruksion i plotë i IVSHB Tiranë, pasi ky institucion ofron kryesisht shërbim shëndetësor, ndaj dhe kushtet e trajtimit të pacientëve aty duhet të përmbushin standardet e një shërbimi shëndetësor adekuat konform legjislacionit në fuqi dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
2. Marrjen e masave për ndarjen e pacientëve sipas sektorë të veçantë për të paraburgosur e të burgosur sikurse është parashikuar edhe në nenin 8 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.
3. Marrjen e masave për krijimin e një dhome kufizimi fizik, e cila duhet të vihet në funksion sipas kriterëve të mirë përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “ Për Shëndetin Mendor” dhe akteve nënligjore të tij, duke qenë se ky institucion trajton edhe persona me probleme të shëndetit mendor.

4. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti të përshtatshëm dhe konform standardeve për takimet e pacientëve me familjarët e rritur e të mitur.
5. Marrjen e masave për pajisjen e çdo dhome të regjimit të brendshëm me zile elektronike, në mënyrë që të lehtësohet komunikimi i pacientëve me stafin në rastin e nevojave emergjente për ndihmë nga ana e tyre.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e ngrohjes në të gjithë ambientet e këtij institucioni përmes vënies në zbatim të marrëveshjes me drejtorinë e QSUT-së.
7. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në dhoma dhe riparimin e plotë të dusheve dhe tualeteve, si dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare të tyre.
8. Marrjen e masave për pajisjen e dhomave të pacientëve me orendi, çarçafë, dyshekë, karrige e tavolina dhe pajisjen e pacientëve me paketën bazë të higjienës personale me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës sipas standardeve të vendosura nga kuadri ligjor në fuqi dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.
9. Marrjen e masave për vënien në shërbim të pacientëve të një dyqani brenda institucionit, në mënyrë që pacientët të kenë mundësi të sigurojnë produktet bazë jetike.
10. Marrjen e masave për krijimin e ambienteve të përbashkëta për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve fetare, kulturore dhe sportive nga ana e sektorit të kujdesit psiko-social.
11. Marrjen e masave për shtimin në organikë të personelit të mesëm mjekësor duke pasur parasysh kategorinë e veçantë të personave që trajtohen në këtë Institucion.
12. Marrja e masave për krijimin e një fondi rezervë për të sëmurët me sëmundje tumorale, trajtimi i të cilët kërkon medikamente të kushtueshme.
13. Marrjen e masave për shtimin në organikë të një stomatologu në mënyrë që të ofrohet një shërbim adekuat dentar.
14. Marrja e masave për shtimin e organikës së stafit policor në mënyrë që të mundësohet shoqërimi i të sëmurëve në qendrat e tjera spitalore brenda QSUT-së pa cenuar kushtet e sigurisë.

**Rekomandim drejtuar Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Punëve të Brendshme, Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit mbi transferimin e menjëhershëm i të arrestuarve dhe i të dënuarve, në seksionet përkatëse të IEVP-ve sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Datë 03.09.2015**

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, gjatë inspektimeve të kryera në Institucionet Penitenciare në vend si dhe në ambientet e sigurisë të organeve të Policisë së Shtetit, ka konstatuar se:

1. Në disa prej IEVP-ve të parashikuara si institucione paraburgimi si dhe në seksionet e paraburgimit të disa IEVP-ve të tjera, mbahen persona të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat respektive.

2. Në disa raste këta të dënuar janë të vendosur në të njëjtat dhoma me të paraburgosurit, e për rrjedhojë të gjitha aktivitetet i kryejnë bashkë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.
3. Në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit, mbahen dhe trajtohen të paraburgosur ndaj të cilëve gjykatat respektive kanë dhënë vendime për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg” ndaj tyre, pasi nuk janë pranuar nga IEVP-të me justifikimin e mbipopullimit të ambienteve të tyre.
4. Në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit, mbahen dhe trajtohen persona të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-20 ditë, pasi nuk pranohen nga IEVP-të pa urdhër të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Konstatimet tona të parashtruara më sipër, janë pranuar dhe konfirmuar edhe nga:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresat nr. 105/1 Prot., 19.01.2015 dhe nr. 6136/1 Prot., datë 21.07.2015.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 76/2 Prot., datë 17.02.2015.

Për sa më sipër, rezulton se ndaj personave të arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar nuk respektohen dispozitat e ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar; VKM nr. 327, datë 15.05.2003 “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”; Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Drejtësisë nr. 3750/1, datë 10.07.2003 dhe i Ministrit të Rendit Publik nr. 1883, datë 16.07.2003; Urdhri i Përbashkët i Ministrit të Drejtësisë nr. 582/1, datë 24.01.2007 dhe i Ministrit të Brendshëm nr. 432, datë 23.01.2007 “Për kalimin e plotë të paraburgimit nga Ministria e Brendshme në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”; Manuali i Rregullave dhe Procedurave standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar në njësitë policore, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 763, datë 27.09.2011.

Për sa më sipër u rekomandua:

Marrja e masave për zbatim të akteve ligjore e nënligjore të cituara më lart, duke kryer:

1. Transferimin e menjëhershëm të të arrestuarve ndaj të cilëve është caktuar një masë sigurimi personal “arrest në burg” nga gjykata, si dhe të dënuarve me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim në mungesë, nga ambientet e sigurisë të organeve të Policisë së Shtetit, në seksionet përkatëse të IEVP-ve;
2. Transferimin e menjëhershëm të dënuarve me burgim, për të cilët vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, nga seksionet e paraburgimit, në seksionet përkatëse të IEVP-ve ku trajtohen personat e dënuar.

## **5. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektiveve të kryera gjatë vitit 2015 në Drejtorinë e Policisë së Vendore dhe në Komisarariatet e varësisë**

### **DPV- të**

**Komisariati i Durrësit** – Datë 28.05.2015

Monitorimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin ( në fuqi në momentin e inspektimit dhe hartimit të raportit ) nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” dhe në Manualin “*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”, si dhe vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të nevojshme për informimin e të gjithë personave të ndaluar/ arrestuar nga policia mbi të drejtat themelore të tyre që në momentin e parë të kufizimit të lirisë si dhe mbajtjen në analizë dhe verifikimin e rasteve ku pretendohet se janë dhunuar apo keqtrajtuar nga punonjës të policisë gjatë arrestimit të tyre.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e medikamenteve bazë për kutinë e ndihmës së shpejtë në Komisariatin e Policisë Durrës, në mënyrë që për personat e ndaluar/ arrestuar të ofrohet shërbim mjekësor sipas kërkesave të ligjit.
3. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë e mundur, të librit të ankesave për personat e shoqëruar, dhe ndaluar/arrestuar në të gjithë Komisariatin e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Durrës.
4. Marrjen e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.P.P. lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve, duke mos i trajtuar fillimisht si të shoqëruar.
5. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit dhe në veçanti atij të marrjes në pyetje në Komisarariatit e Policisë Durrës.
6. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Durrës.
7. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.

8. Marrjen e masave të nevojshme për të pasqyruar qartësisht kontaktet me familjarët në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar.

#### **DPV Shkodër dhe komisariatet e varësisë:**

- Komisariatin e Policisë Shkodër, datë 02.06.2015
- Komisariatin e Policisë Pukë, datë 03.06.2015
- Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe datë 02.06.2015

#### **Shënime Paraprake**

Monitorimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit të dhënave mbi veprimet dhe praktikatat e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin ( në fuqi në momentin e inspektimit dhe hartimit të raportit ) nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, si dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për përcaktimin e rregullave teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambjentet e policisë në përmbushje të Nenit 109 pika 8 të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
2. Marrjen e masave për ndërtimin ose rikonstruktimin e ambienteve të shoqërimit në Komisariatet e Policisë Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, për të krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
3. Marrjen e masave për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisariatin e Policisë Shkodër sipas kërkesave ligjore dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”.
4. Marrjen e masave të nevojshme për informimin e të gjithë personave të ndaluar/ arrestuar nga policia mbi të drejtat themelore të tyre që në momentin e parë të kufizimit të lirisë.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e Metadonit dhe medikamenteve bazë për kutinë e ndihmës së shpejtë në Komisariatin e Policisë Shkodër, në mënyrë që për personat e ndaluar/ arrestuar të ofrohet shërbim mjekësor sipas kërkesave të ligjit.
6. Marrjen e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar në Komisaritet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë.
7. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë e mundur, të librit të ankesave për personat e shoqëruar, dhe ndaluar/arrestuar në të gjithë Komisaritet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Shkodër.
8. Marrjen e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.P.P. lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve, duke mos i trajtuar fillimisht si të shoqëruar.
9. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të marrjes në pyetje në Komisaritet e Policisë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë.
10. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Shkodër dhe në komisaritet në varësi të saj.
11. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.
12. Marrjen e masave të nevojshme për të pasqyruar qartësisht kontaktet me familjarët në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar.

#### **DPV Dibër dhe Komisaritet e varësisë:**

- Komisariatin e Policisë Peshkopi, datë 15.06.2015
- Komisariatin e Policisë Bulqizë, datë 15.06.2015
- Komisariatin e Policisë Burrel datë 15.06.2015

#### ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i ekspertëve i autorizuar nga Avokati i Popullit, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e organit, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i ekspertëve, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Më konkretisht, gjendja e përgjithshme si dhe problematikat e konstatuara në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër dhe në organet e policisë në varësi të saj pasqyrohen më poshtë:

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Mbylljen e menjëhershme të dhomave të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Burrel dhe Peshkopi, pasi qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përbën trajtim degradues, si edhe cënon dinjitetin e çdo personi që mbahet në këto ambiente.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin apo rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit në të gjitha komisarlatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së, sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
3. Marrjen e masave për ndërtimin e tualeteve për dhomat e shoqërimit në komisarlatet e inspektuara, sipas parashikimit dhe parametrave të Manualit të “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të veçanta për mbajtjen dhe ruajtjen e provave materiale në komisarlatet të cilët kanë funksionale dhomat e ndalim/arrestimit.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit në të gjitha komisarlatet e lartpërmendura.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret ku ndodhen dhomat e ndalim/arrestimit në të gjitha Komisarlatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
7. Marrjen e masave për krijimin e dhomës së mjekut në Komisarlatin e Policisë Burrel, sipas kritereve të përcaktuara në Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
8. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të dhomës së mjekut në Komisarlatin e Policisë Peshkopi, sipas kritereve të përcaktuara ligjore.
9. Marrjen e masave për furnizimin me ilaçe dhe aparat për matjen e tensionit në Komisarlatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
10. Marrjen e masave për pajisjen e personave të ndaluar/arrestuar me literaturë informuese/didaktike/letrare.
11. Marrjen e masave për përditësimin e regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në të gjitha Komisarlatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.
12. Marrjen e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në të gjitha rubrikat e tyre në të gjitha Komisarlatet e lartpërmendura të inspektuara nga ekspertët e MKPT-së.



13. Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin me përpikëri të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 109, lidhur me shoqërimin e personave, me qëllim dhënien fund të praktikës së konstatuar në të gjitha Komisaritet e inspektuara, sipas së cilës, në regjistrin e personave të shoqëruar përfshihen edhe persona të ndaluar/arrestuar.
14. Marrjen e masave të menjëhershme për trajnimin e personelit në të gjitha Komisaritet e inspektuara lidhur me zbatimin e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” për shoqërimin e personave, si edhe me zbatimin e ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

#### **DPV Kukës dhe Komisaritet e varësisë:**

- Komisaritin e Policisë Has, datë 17.06.2015
- Komisaritin e Policisë Tropojë, datë 18.06.2015
- Komisaritin e Policisë Kukës datë 17.06.2015

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i ekspertëve i autorizuar nga Avokati i Popullit, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e institucionit , për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i ekspertëve, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Avokati Popullit konstaton se në kundërshtim me rekomandimet e vitit paraardhës, datë 19.06.2014 / Nr.Doc.201401261, në Komisaritet e Policisë Tropojë dhe Has nuk është marrë asnjë masë në zbatim të tyre, pasi dhomat e shoqërimit në këta komisaritate ose mungojnë ose janë jashtë çdo standarti të kërkuar. Në këto komisaritate nuk ka tre dhoma shoqërimi sikurse parashikon ligji nr. nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manuali i “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011”, të ndara më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për ndërtimin e ambienteve të reja të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Tropojë dhe Has sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femrat, meshkujt dhe të miturit.
2. Marrjen e masave për përshtatjen e ambienteve të sigurisë në Drejtorinë e Policisë Qarkut Kukës, me qëllim krijimin e ambienteve të ajrimit, të ushtrimit të riteve fetare apo aktivitete të tjera sipas kërkesave të ligjit.

3. Marrjen e masave për rregullimin e të gjitha defekteve teknike të konstatuara në ambientet e sigurisë në Komisarariatet e Policisë Kukës.
4. Marrjen e masave për plotësimin me përgjegjësi dhe hollësi të librit të personave të shoqëruar ndaluar dhe arrestuar në Komisarariatet Kukës, Has, Tropojë.
5. Marrjen e masave nga ana e strukturave drejtuese të organeve vendore të policisë që të punohet me të gjithë efektivat për njohjen e ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.
6. Marrjen e masave për njoftimin e familjarëve, të afërme apo personit që i shoqëruari beson, shënimin në regjistrat përkatës së orës së njoftimit të tyre, emrit të njoftuarit dhe numri e telefonit të tij.
7. Marrjen e masave për zbatimin e kriterit ligjorë ku të garantohet nënshkrimi i të shoqëruarit në regjistrin e shoqërimit në kohën që ai lihet i lirë.
8. Marrjen e masave për plotësimin rigoroz në regjistrat përkatës në Komisarariatet e varësisë të arsyes së shoqërimit duke evituar shkrimet e përgjithshme si “verifikim” apo “konflikt”.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, intervistimit apo dhomave ku kryhen policore me të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në të gjitha komisarariatet e lartpërmendura.

#### **DPV Berat dhe Komisarariatet e varësisë:**

- Komisarriati i Policisë Berat, datë 03.09.2015
- Komisarriati i Policisë Kuçovë, datë 02.09.2015
- Komisarriati i Policisë Çorovodë, datë 02.09.2015

Monitorimi kishte si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr. K4/ I 43-2, datë 13.11.2014 me lëndë: “Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat dhe Komisarariatet në varësi të tij”, lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/arrestimit të shtetasve.

Përpara vizitave, grupi i monitorimit konsultoi bazën ligjore (kode, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime) të nevojshme për procesin e monitorimit. Gjatë vizitave, në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takime me drejtuesit e institucioneve dhe u komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. **Grupi i punës gjithashtu inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet**

**përkatëse, si dhe kontaktoi me të gjithë personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar që gjendeshin në vend.**

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike e konstatuar ishte ajo e një viti më parë, me përmirësime kryesisht në mbajtjen dhe plotësimin e rubrikave të regjistrave. Nga ana tjetër, rekomandimet për ambientin shëndetësor, dhomat e sigurisë si dhe për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi ende nuk kishin gjetur zbatim.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen dhe vulosjen e dhomave të sigurisë në komisariatet e Policisë Kuçovë e Çorovodë.
2. Marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit/ndalimit/arrestimit në të tre Komisarariatet në varësi të kësaj DPV-je.
3. Marrjen e masave krijimin e ambienteve të përshtatshme të shoqërimit dhe të ndalimit/arrestimit brenda ambienteve të komisariateve të kësaj DPV-je, dinjitoze dhe të pajisura me orëditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur, në përputhje me standardet e përcaktuara në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
4. Marrjen e masave pajisjen me regjistër për personat e ndaluar/arrestuar në Komisarariatet e Policisë Çorovodë si dhe për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar në të gjitha rubrikat e tij në komisariatet e policisë Çorovodë e Kuçovë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e një ambienti të përshtatshëm për vizitat dhe manipulimet mjekësore në komisariatet e Policisë Berat, si dhe furnizimin e tij me medikamente të urgjencës.
6. Marrjen e masave për afishimin e listës së avokatëve kryesisht në ambiente lehtësisht të aksesueshme për personat e ndaluar/arrestuar në Komisarariatet e Policisë së Berat dhe Kuçovë.
7. Marrjen e masave për pajisjen e të ndaluarve/arrestuarve me mjete të higjienës personale në Komisarariatet e Policisë së Beratit.

**DPV Korçë dhe Komisariate të vartësisë:**

- Komisarariatet e Policisë Pogradec, datë 01.10.2015
- Komisarariatet e Policisë Ersekë, datë 30.09.2015
- Komisarariatet e Policisë Devoll, datë 30.09.2015
- Komisarariatet e Policisë Korçë, datë 01.10.2015

### ***Objektivat specifike të monitorimit***

Monitorimi kishte si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikave të ndjekura në komisariate me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr. K4/156-4 Prot., datë 04.12.2014 me lëndë “Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë dhe Komisarariatet në varësi të saj” dhe përgjigjes së marrë nga DPP me Nr.6410 Prot., datë 13.01.2015 mbi rekomandimin e bërë.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe ju komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve të këtyre organeve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. **Në vijim të inspektimit, ekipi pati konsultime të frytshme me Shefat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në Komisarariatet e Policisë, Pogradec dhe Devoll si dhe Shefat e Komisariateve Ersekë dhe Korçë dhe me zyrtarë të tjerë të këtyre njësisve policore.**

**Grupi i punës mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës si dhe kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria. Inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.**

**Gjithashtu grupi i punës është informuar se Drejtoria e Policisë Qarkut Korçë, ishte njohur me rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe mbi këtë bazë Drejtoria e Policisë Qarkut Korçë kishte urdhëruar detyra konkrete në përmbushje të këtyre rekomandimeve. Konkretisht ishin mbyllur, vulosur dhe nxjerrë jashtë përdorimi dhomat e ndalim/arrestimit të komisarariatit Pogradec.**

**Në bisedë me personelin e policisë të ngarkuar për zbatimin e detyrave të lëna grupi i punës është informuar se në këtë Drejtori Policie ishin marrë disa masa për përmirësimin e kushteve në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë. Gjithashtu kishte përfunduar trajnimi i personelit policorë që shërbente në këto ambiente si dhe atij të ngarkuar me zbatimin e kriterëve ligjore gjatë shoqërimit dhe ndalim/arrestimit të shtetasve por mungesa e alokimit të fondeve të nevojshme për përmirësime infrastrukture nuk u vërejtën përmirësime të dukshme.**

**Gjatë inspektimit grupi i punës ka konstatuar se, megjithëse në këtë Drejtori Policie ishin realizuar disa masa, përsëri vazhdonin të ishin prezent disa problematika.**

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit në Komisarariatet e Policisë, Pogradec, Devoll dhe Ersekë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” duke krijuar ambiente të përshtashme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për respektimin e hapsirës jetike dhe garantimin e një trajtimi njerëzorë dhe jo degradues të të ndaluarve/arrestuarve në dhomat e sigurisë së Komisarariatit Korçë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së DPQ Korçë me mjek me kohe të plotë pune.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për korigjimin e mangësive të konstatuara në librin e personave të shoqëruar/ndaluar dhe arrestuar me qëllim standardizimin sipas kërkesave të përcaktuara në nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*” dhe Manualin “*Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”.
5. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat drejtuese të organeve qendrore e vendore të Policisë së Shtetit për njohjen e të gjithë efektivit me ligjin “*Për Policinë e Shtetit*” dhe zbatimin me rigorozitet të kriterëve ligjore lidhur me rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, si dhe për trajtimin dinjitoz të tyre.
6. Marrjen e masave për respektimin me korrektesë të dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe mostrajtimin e tyre fillimisht si të shoqëruar.
7. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të hetimit në të gjithë Komisarariatet e Policisë të DPQ Korçë ku ai mungon. Monitorimi duhet të fillojë nga hyrja e ndërtesës së organit të policisë, me qëllim për të mos patur asnjë moment shkëputjeje deri në ambientin ku personi do qëndrojë.
8. Marrjen e masave për vendosjen e telefonit me numër në ambientet e sigurisë në Komisarariatet e Policisë Korçë, me qëllim që të ndaluarit/arrestuarit të kenë mundësi të komunikojnë më familjarët e tyre sipas përcaktimeve të bëra në Manualin “*Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”.
9. Marrjen e masave të plotësimit me rigorozitet të librit për ankesat e shtetasve të shoqëruar, ndaluar/arrestuar duke i kushtuar rëndësi të veçantë rubrikave për pasqyrimin e shenjave të lëndimit, emri i zyrtarit, i cili ka kryer veprimet si dhe vendi ku është mbajtur.

#### **DPV Gjirokastrë dhe Komisarariatet e varësisë:**

- Komisarriati i policisë Gjirokastrë, datë 07.10.2015
- Komisarriati i policisë Përmet, datë 05.10.2015
- Komisarriati i policisë Tepelenë, datë 07.10.2015

Monitorimi kishte si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluara dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr. K4/ I 43-2, datë 13.11.2014 me lëndë: “Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat dhe Komisaritet në varësi të tij”, lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/arrestimit të shtetasve.

Përpara vizitave, grupi i monitorimit konsultoi bazën ligjore (kode, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime) të nevojshme për procesin e monitorimit. Gjatë vizitave, në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi takime me drejtuesit e institucioneve të cilët në të gjitha rastet treguan bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

**Grupi i punës gjithashtu inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse, si dhe kontaktoi me të gjithë personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar që gjendeshin në vend.**

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit në Komisaritetin e Policisë Tepelenë dhe Komisaritetin e Policisë Përmet.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen dhe vulosjen e dhomave të sigurisë, sipas procedurës, me procesverbal në Komisaritetin e Policisë Përmet.
3. Marrjen e masave për plotësimin me përgjegjësi të plotë të regjistrave të personave të shoqëruar në të gjitha rubrikat në të gjithë Komisaritetet në varësi të DPV Gjirokastër dhe në përputhje me nenin 109 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
4. Marrjen e masave për hapjen e tualeteve të përshtatshme sipas kërkesave të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011, pranë dhomave të shoqërimit në Komisaritetin e Policisë Tepelenë.
5. Marrjen e masave për hapjen e një dhome tjetër shoqërimi, për të mundësuar mbajtjen në dhoma të ndryshme të femrave dhe të miturve në Komisaritetin e Policisë Gjirokastër.
6. Marrjen e masave për mbajtjen e kampioneve ushqimorë si dhe për afishimin e menysë ditore e javore për personat e arrestuar/ndaluar në mensën e Komisaritetit të Policisë Gjirokastër.

7. Marrjen e masave për pajisjen e të ndaluarve/arrestuarve me mjete të higjienës personale në Komisariatin e Policisë Gjirokastër.

#### **DPV Elbasan dhe Komisaritet e varësisë:**

- Komisarati i policisë Elbasan, datë 16.10.2015
- Komisarati i policisë Librazhd, datë 14.10.2015
- Komisarati i policisë Gramsh, datë 14.10.2015
- Komisarati i policisë Peqin, datë 14.10.2015

Monitorimi kishte si objekt kryerjen e inspektimit, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr. K4/ I 13-2, datë 12.08.2014 me lëndë: “Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Elbasan dhe Komisaritet në varësi të tij”.

Përpara vizitave, grupi i monitorimit konsultoi bazën ligjore (kode, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime) të nevojshme për procesin e monitorimit. Gjatë vizitave, në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi takime me drejtuesit e institucioneve të cilët në të gjitha rastet treguan bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

**Grupi i punës gjithashtu inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse, si dhe kontaktoi me të gjithë personat e shoqëruar, ndaluar/ arrestuar që gjendeshin në vend.**

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave krijimin e ambienteve të përshtatshme të shoqërimit, të ndalim/arrestimit dhe ajrosjes brenda ambienteve të komisariateve të varësisë së DPV Elbasan, dinjitoze dhe të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, në përputhje me standardet e përcaktuara Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011.
2. Marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit të Komisariatit të policisë Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

3. **Marrjen e masave për plotësimin me korrektesë e përgjegjësi të regjistrave të shtetasve të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar në Komisariatin e Policisë Elbasan.**

#### **DPV Vlorë dhe Komisaritet e varësisë:**

- Komisariatin e Policisë Vlorë, datë 22.10.2015
- Komisariatin e Policisë Sarandë, datë 06.10.2015
- Komisariatin e Policisë Delvinë, datë 06.10.2015

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, grupi i ekspertëve i autorizuar nga Avokati i Popullit, në secilin prej subjekteve të lartpërmendura, u takua fillimisht me titullarin e organit, për t'i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se të gjithë drejtuesit e organeve të inspektuara treguan bashkëpunim gjatë gjithë kohës që grupi ishte në inspektim.

Gjithashtu, pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i ekspertëve, mori takim privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit e të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse. Marrjen e masave për përfundimin e rikonstruksionit të ambienteve të reja të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Vlorë, ndërtimin e ambienteve të reja të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Sarandë dhe Delvinë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për përfundimin e rikonstruksionit të ambienteve të reja të sigurisë në Komisariatin e Policisë Vlorë, ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisariatin e Policisë Sarandë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualit “*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”.
2. Marrjen e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar në Komisaritet Sarandë dhe Delvinë.
3. Marrjen e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve dhe të mos trajtohen fillimisht si të shoqëruar.
4. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të intervistimit në të gjithë Komisaritet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Vlorë.

#### **DPV Fier dhe Komisaritet e vartësisë:**



- Komisarjatin e Policisë Fier, datë 10.11.2015
- Komisarjatin e Policisë Lushnje datë 10.11.2015
- Komisarjatin e Policisë Mallakastër datë 10.11.2015

Përpara vizitës, grupi i monitorimit mbledhi të gjithë informacionin ligjor të nevojshëm për procesin e monitorimit (kode, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra dhe udhëzime). Monitorimi kaloi nëpër fazën e planifikimit të problematikës ku do përqendrohej, metodologjisë që do përdorej, identifikimin real të performancës, të treguesve që kanë bërë progres dhe të atyre treguesve që kanë nevojë për përmirësim.

Monitorimi kishte si objekt inspektimin, kryerjen e vizitave, vëzhgimin, mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, veprimeve dhe praktikave të ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në Ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluara dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, dhe marrjen e masave për plotësimin e rekomandimeve të tij”, si dhe verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës Nr.K4/I64-2, datë 26.01.2015 me lëndë: “Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier dhe Komisarjatet në varësi të tij”, lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit gjatë shoqërimit apo ndalim/arrestimit të shtetasve.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së inspektimit, rezultoi se gjendja faktike ishte si një vit më parë, me disa ndryshime të vogla si psh pajisja me orendi e ambienteve të shoqërimit në Mallakastër dhe Lushnje. Gjithashtu një rekomandim i zbatuar konsiderohet shërbimi mjekësor në Komisarjatin e Policisë Lushnje brenda afatit 12 orë sipas kërkesave ligjore si dhe rekomandimi për informimin mbi të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar nga ana e policisë. Pjesa tjetër e rekomandimeve mbetet e pazbatuar.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe u komunikoi atyre qëllimin e vizitës. Nga ana e drejtuesve të këtyre organeve u shpreh gatishmëri për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit inspektues. **Grupi i punës gjithashtu inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.**

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për përfundimin e ndërtimit dhe vënien e tyre në funksion të ambienteve të shoqërimit në Komisarjatet e Policisë Mallakastër dhe Lushnjë sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluara dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore” duke

krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

2. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e ambienteve ekzistuese të sigurisë si dhe ndërtimin e ambienteve të reja në Komisarlatin e Policisë Lushnjë sipas kërkesave të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit “*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*” .
3. Marrjen e masave për rregullimin e tualeteve në ambientet e sigurisë në Komisarlatin Fier, si dhe vendosjen e një telefoni në korridoret e ambienteve të sigurisë të Komisarlatit të Policisë Fier.
4. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në ambientet e dhomave të shoqërimit dhe ndalim/arrestimit në Komisarlatin e Policisë Fier.
5. Marrjen e masave të nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e ndaluar/arrestuar nga policia të informohen plotësisht për të drejtat themelore që nga fillimi i heqjes së lirisë së tyre.
6. Marrjen e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar në Komisarlatet Mallakastër, Lushnjë dhe Fier.
7. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë të jetë e mundur, të librit të ankesave për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar në të gjithë Komisarlatet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë Vendore Fier.
8. Marrjen e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.Pr.Penale lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve.
9. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në korridoret e ambienteve të shoqërimit, sigurisë në Komisarlatet e Policisë Lushnjë dhe Mallakastër.
10. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për informimin e personave të ndaluar/arrestuar për të drejtën e një avokati mbrojtës, si dhe për mundësinë reale për të kontaktuar me një të tillë, përpara se të kryhet hetimi.
11. Marrjen e masave të nevojshme për të siguruar që të gjithë personat e shoqëruar/ndaluar/arrestuar nga policia, të kontaktojnë me familjarët në momentin më të parë të arrestimit/ndalimit, si dhe ta pasqyrojnë qartësisht këtë fakt në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ndaluar/arrestuar.

### **Komisarlati Nr. 3, Tiranë – Datë 19.11.2015**

Inspektimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin, si dhe vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, fillimisht ekspertët morën kontakt me titullarin e këtij komisarati për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se nga drejtuesi u tregua bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, vizitoi ambientet e shoqërimit/ndalim/arrestimit dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për ndërtimin ose rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit/ndalim/arrestimit në Komisaratin e Policisë nr.3 Tiranë në zbatim të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore” me qëllim krijimin e ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, si dhe trajtimin e shtetasve konform standardeve të parashikuara në ligj.
2. Marrjen e masave për vënien e sistemit të monitorimit me kamera në ambjentet e sigurisë dhe shoqërimit.
3. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.

**Komisariati Nr. 6, Tiranë – Datë 19.11.2015**

Inspektimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin, si dhe vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, fillimisht ekspertët morën kontakt me titullarin e këtij komisariati për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se nga drejtuesi u tregua bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, vizitoi ambientet e shoqërimit/ndalim/arrestimit dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për ndërtimin ose rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit në Komisaratin e Policisë nr.6 Tiranë në zbatim të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore” duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë të jetë e mundur, të aparatëve telefonik.
3. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.

#### **Komisariati Nr. 1, Tiranë – Datë 23.11.2015**

Inspektimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin, si dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, fillimisht ekspertët morën kontakt me titullarin e këtij komisariati për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se nga drejtuesi u tregua bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, vizitoi ambientet e shoqërimit/ndalim/arrestimit dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore në Komisaratin e Policisë nr.1 Tiranë në zbatim të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.
2. Marrjen e masave nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.
3. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me prezencën e mjekut brenda afatit 24/orësh, me qëllim trajtimin e personave në këtë institucion konform legjislacionit në fuqi, dhe kryesisht trajtimin e të miturve nga shërbimi shëndetësorë i DVP me prioritet, për të evituar situatat e padëshiruara.
4. Marrja e masave për krijimin e dhomave të shoqërimit për femra dhe të mitur konform ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”.

#### **Komisariati Nr. 4, Tiranë – Datë - 23.11.20115**

Inspektimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin, si dhe vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 763, datë 27.09.2011 dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet që ofrohen në këto ambiente dhe kryesisht dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, për të cilat është rekomanduar të ndërtohen apo përshtaten sipas standardeve ligjore.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, fillimisht ekspertët morën kontakt me titullarin e këtij komisariati për t’i komunikuar qëllimin e inspektimit. Vlen të theksohet fakti se nga drejtuesi u tregua bashkëpunim gjatë kohës që grupi ishte në inspektim, në zbatim të ligjit nr. Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Pasi mori informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrës, grupi i inspektimit, vizitoi ambientet e shoqërimit/ndalim/arrestimit dhe zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për ndërtimin ose rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit në Komisaratin e Policisë nr.4 Tiranë në zbatim të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin e “Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore” duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.
2. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë të jetë e mundur, të librit të regjistrimit për personat e ndaluar/arrestuar dhe aparatëve telefonik.
3. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.

**Rekomandim drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për fillimin e hetimeve në ngarkim të punonjësit të policisë A.P., për veprën penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal – Data - 08.08.2015**

Në institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e shtetasit B.M., i cili pretendon se më datë 07.08.2015, është dhunuar fizikisht nga punonjësi i Policisë së Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër A.P. Sipas shtetasit B.M., gjatë kohës që ai ndodhej në dhomën e shoqërimit pranë hyrjes së Komisarariatit Shkodër, është goditur në këtë dhomë në prani dhe të dy të shoqëruarve të tjerë, K.P.dhe G.P.. Gjithashtu, ai pretendon se është thirrur dhe nxjerrë nga dhoma e shoqërimit dhe goditur e dhunuar fizikisht në oborrin e komisarariatit Shkodër. Punonjësi

i policisë, A.P ka goditur me grushte duke i shkaktuar komocion të lehtë celebral dhe leziona në pjesën e veshit, si shkak i të cilës shtetasi B.M. nga ambientet e Komisarariatit Shkodër në orën 04.35 të dt. 08.08.2015 është shtruar me urgjencë në Spitalin Rajonal Shkodër.

Sipas pretendimeve të shtetasit B.M., dhuna fizike ushtruar ndaj tij nga ana e punonjësit të policisë, A.P, është bërë me qëllim ndëshkimin e tij pasi gjatë shoqërimit të tij në Komisariatin e Shkodrës së bashku me kamionin me të cilin transportohej material drusor, si rezultat i një defekti teknik ishte aktivizuar sistemi i vetëshkarkimit të karrocërës së kamionit duke hedhur në rrugë një pjesë të ngarkesës dhe shkaktuar vonesë të shoqërimit të personave dhe kamionit për në Komisariatin Shkodër.

Nga punonjësi i institucionit tonë në datën 08.08.2015 u mor takim me shtetasin B.M., i cili ndodhej i shtruar në pavionin e Kirurgjisë pranë Spitalit Rajonal Shkodër. Gjatë marrjes në pyetje të tij me procesverbal, ndërmjet të tjerave ai deklaroi se, më datën 07.08.2015, rreth orës 22:30 – 23:00, mjeti kamion riportabël tip Benz, me të cilin po transportohej material drusor me qëllim tregtimi nga mali Cukal, komuna Rrethina, në drejtim të qytetit të Shkodrës, kishte qenë i parkuar në afërsi të vendndodhjes Ura e Mesit. Sipas ankuesit, B.M., drejtuesi i mjetit kishte parkuar kamionin dhe ishte larguar për të blerë ushqim pranë një dyqani aty afër.

Në ato momente dy oficerë policie me veshje civile dhe oficeri i policisë rrugore, z. H.M., i janë afruar kamionit të ndalur dhe kanë kërkuar dokumentet e makinës dhe dokumentet lidhur me origjinën dhe destinacionin e ngarkesës. Në kabinën e mjetit ishte vetëm ankuesi, B.M., pasi drejtuesi i mjetit u largua për pak kohë për të kryer blerjet e sipërpërmendura. Pas disa minutash pranë kamionit arriti dhe një grup efektiv i FNSH-së, të cilët urdhëruan z. B.M., të drejtojë mjetin në drejtim të Komisarariatit Shkodër ku do kryej sekuestimi i mjetit derisa të vihej në dispozicion të organeve të policisë dokumentacioni përkatës. Sipas rrëfimit, B.M. i ka bërë të ditur punonjësve të policisë se ai ishte vetëm punonjës ngarkim-shkarkimi dhe nuk ishte drejtues i mjetit, por ata nuk i kanë marrë në konsideratë thëniet e tij dhe e kanë urdhëruar të nisë kamionin në drejtim të Komisarariatit Shkodër.

Sipas rrëfimit të B.M., ai ka drejtuar kamionin e ngarkuar me lëndë drusore i shoqëruar vetëm nga një efektiv i policisë. Dhe drejtuesi i mjetit nuk është lejuar të hyji në kabinën e kamionit. Në vazhdim të rrëfimit ankuesi shpjegon se në vendin e quajtur Hot i Ri kamioni ka pësuar një defekt teknik si rrjedhojë e të cilit ishte aktivizuar mekanizmi i vetëshkarkimit automatik dhe në udhëtim e sipër një pjesë e ngarkesës është hedhur në rrugë. Në ato momente B.M. ka ndaluar makinën dhe menjëherë është kryer prangosja dhe arrestimi i tij nga efektiv i policisë i cili ndodhej në kabinën e kamionit dhe e shoqëronte atë. Në momentet në vazhdim është lajmëruar grupi i FNSH-së dhe punonjësit e tjerë të policisë që ishin larguar për një veprim policor tjetër të cilët kanë arritur në vendin e ndalimit të kamionit menjëherë sapo punonjësi i policisë që shoqëronte mjetin i ka lajmëruar duke akuzuar B.M se ka qenë ai që ka aktivizuar mekanizmin e vetëshkarkimit me qëllim për të penguar veprimet e policisë. Sipas B.M, në vendin e ndalimit ka arritur një punonjës i policisë, i veshur me rroba civile, të cilin ai e identifikon me emrin A.P. dhe pretendon se e ka goditur me shpullë në kokë dhe e ka kërcënuar me fjalët “do shihemi së shpejti në Komisariat”. Mbas kësaj B.M., së bashku me dy persona të tjerë, G.P. dhe K.A., janë shoqëruar në Komisariatin e Policisë, Shkodër rreth orës 02.00 të dt.08.08.2015, ku janë vendosur të tre së bashku në dhomën e shoqërimit në hyrje të Komisarariatit Shkodër. Sipas dëshmimeve të B.M dhe të

shoqëruarit K.A., rreth orës 3.00 të dt.08.08.2015 punonjësi i policisë A.P. ka hyrë në dhomën e shoqërimit dhe ka goditur rreth pesë herë me grushte në kokë në prezencën e të shoqëruarve B.M. duke e ofenduar dhe sharë. Mbas kësaj A.P. është larguar për rreth 5 minuta dhe është kthyer përsëri pranë dhomës së shoqërimit duke e marrë B.M. nga dhoma e shoqërimit dhe nxjerrë në oborrin e Komisarariatit Shkodër dhe vazhduar keqtrajtimin e tij fizik për rreth 15 minuta, duke e goditur ankuesin me shpulla dhe grushte në kokë me qëllim marrjen e informacionit nga ana e tij lidhur pronësinë e lëndës drusore të siguruar dhe transportuar në mënyrë të paligjshme.

Sipas dëshmive të B.M. gjatë ushtrimit të dhunës fizike ndaj tij në oborrin e Komisarariatit Shkodër kanë qenë prezent dhe punonjësi i policisë H.M. dhe përgjegjësi i turnit të dhomave të ndalim arrestimit të Komisarariatit Shkodër. Menjëherë pas kthimit në dhomën e shoqërimit, sipas dëshmive të B.M.t dhe dëshmitarit K.A., B.M. ka pasur shenja goditje në kokë dhe krah dhe ka shfaqur dhimbje koke dhe hemoragji nga veshi. Në një moment ai ka humbur ndjenjat dhe mbas kësaj të shoqëruarit K.P.dhe G.P. i kanë rënë derës dhe kanë kërkuar më insistim thirrjen e ambulancës dhe trajtimin e menjëhershëm mjekësor ndaj shtetasit B.M.. Sipas pohimeve të tyre, pas rreth një ore në ambientet e Komisarariatit ka arritur një ambulance me personel mjekësorë të cilët kanë rekomanduar shtrimin e menjëhershëm për trajtim të specializuar të shtetasit pranë repartit të urgjencës të Spitalit Rajonal Shkodër.

Meqenëse nga punonjësi i institucionit tonë gjatë takimit të bërë me shtetasin B.M. u konstatuan shenja në fytyrën dhe në trupin e tij, me shkresën e datës 09.08.2015 iu kërkuar mjekut ligjor pranë Spitalit Rajonal Shkodër kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të tij. Mjeku ligjor, Dh.T., më datë 10.08.2015, është paraqitur pranë Spitalit Rajonal, Shkodër për të bërë egzaminimin e shtetasit B.M. dhe po në këtë datë ia ka dorëzuar atë grupit hetimor të Avokatit të Popullit.

Nga Akt ekspertimi Mjeko-Ligjor Nr.177, datë 10.08.2015, kryer nga eksperti i mjekësisë ligjore i Shërbimit të Mjekësisë Ligjore Shkodër, z.Dh.T., rezulton se, nga këqyrja objektive më datë 10.08.2015 e shtetasit B.M. dhe shqyrtimi i kartelës klinike Nr.2103, vërehet se shtetasi është shtruar në spitalin Rajonal Shkodër më dt.08.08.2015 nga rep.i urgjencës me kartelë klinike ditore Nr. 1528 dt.08.08.2015 rreth orës 04.35 me Diagnozë: **Contusion capitis et corpori.**

Duke u mbështetur në të dhënat e kartelës mjekësore dhe vizitës kryer ndaj personit, eksperti i mjekësisë ligjore ka arritur në konkluzionin se:

1. Tek shtetasi B.M. konstatohet se ka comocion të lehtë cerebral me edemë të llapës së veshit të majtë pa lezione serioze dhe kockore.
2. Dëmtimet janë shkaktuar nga mjet i fortë mbretës
3. Këto dëmtime hyjnë në kategorinë e dëmtimeve që kanë sjellë humbjen e shkallës së aftësisë së përkohshme për punë në masën deri në 9 ditë.

Gjatë dëshmive të marra nga ana e N/ Komisionerëve të Avokatit të Popullit, punonjësit e policisë, A.P dhe H.M., të pyetur nga ana jonë nuk pranuan që të kishin keqtrajtuar shtetasin B.M.. Gjithashtu, H.M. deklaroi se nuk kishte parë që B.M. të keqtrajtohej në oborrin e Komisarariatit Shkodër nga ana e punonjësit të policisë A.P.



Deklarimet mohuese të punonjësit të policisë, A.P, se shtetasi B.M. nuk është dhunuar prej tij, dhe gjithashtu deklaramet mohuese të punonjësit të policisë, H.M., se ai nuk ka parë që B.M. të jetë dhunuar nga punonjësi i policisë A.P, rrëzohen nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga ana jonë.

Pretendimet e ankuesit se, ai është dhunuar fizikisht nga punonjësi i policisë, A.P, provohen nga deklaramet e shtetasve, K.A., G.P., D.M, F.R., etj. Gjithashtu, dhunimi fizik i shtetasit B.M. nga punonjësit e policisë të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër provohet edhe nga dy fotografitë e bëra atij në Spitalin Rajonal Shkodër nga ekspertët e Avokatit të Popullit, më dt.08.08.2015, ndërsa ndodhej i shtruar në pavionin e Kirurgjisë së Spitalit Rajonal Shkodër, si dhe nga kartela klinike e shtetasit, B.M., përpiluar nga mjekët e urgjencës dhe pavionit të kirurgjisë, më datën 08.08.2015 dhe gjithashtu nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor, përpiluar nga eksperti Mjeko-Ligjor i Shërbimit të Mjekësisë Ligjore, Shkodër. Sipas ankuesit dhe disa deklaramet, dhuna e ushtruar ndaj tij është bërë në shenjë hakmarrjeje, sepse pretendohet se ai gjatë drejtimit të mjetit ka aktivizuar qëllimisht mekanizmin e vetëshkarkimit të karrocërisë së kamionit duke vonuar veprimtarinë e policisë dhe duke shkaktuar rrezikshmëri ndaj personave dhe mjeteve të policisë që e shoqëronin nga pas.

Në përfundim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe dokumentacionit të administruar nga ana jonë, arritëm në konkluzionin se ndaj shtetasit B.M. është ushtruar dhunë fizike nga punonjësi i policisë A.P në momentin e arrestimit dhe gjatë mbajtjes së tij në dhomën e shoqërimit në Komisariatin Shkodër. Nga kjo sjellje ndaj shtetasit e punonjësit të policisë, A.P, duke e goditur me shpulla dhe grushte, ankuesit i janë shkaktuar pasoja fizike dhe psikologjike.

Veprimi i punonjësit të policisë të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, A.P, vjen në kundërshtim me nenin 133 të Ligjit Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe është bërë me qëllim ndëshkimit të tij për shkak se ai nuk i është bindur urdhrave të tyre dhe me veprime apo mosveprime ka shkaktuar vonesa në veprimtarinë e policisë. Ankuesit i është shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, *për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.*

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti kemi arritur në konkluzionin se, kryerja e këtij veprimi nga punonjësi i Policisë së Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, A.P, përmban elementët e figurës së veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal. Këtë veprë penale ai e ka kryer duke qenë në cilësinë e funksionit shtetëror që kryen si punonjës i Policisë së Shtetit dhe gjatë ushtrimit të kësaj detyre në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër, nëpërmjet kryerjes së veprimit arbitrar dhe të kundërligjshëm në dëm të të drejtës së ankuesit të mos cenimit të integritetit fizik të tij të garantuar nga aktet normative në fuqi. Këtë veprim ai e ka kryer me cilësinë e subjektit të posaçëm si punonjës i Policisë së Shtetit, me dashje direkt dhe duke e ditur që veprimi i tij ishte i kundërligjshëm dhe jo në përputhje me përmbushjen e rregullt të detyrës së tij.

Për sa më sipër, u rekomandua:

1. Fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të shtetasit, A.P, me detyrë punonjës i Policisë së Shtetit, efektiv i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër, për veprën penale të “*Kryerjes së veprimeve arbitrare*”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.

## **6. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektiveve të kryera gjatë vitit 2015 në Forcat e Armatosura**

**Informacion për inspektimin e kryer në Repartin Ushtarak Nr. 1010 Vau i Dejës, Shkodër**  
Datë – 03.06.2015

Vizita inspektuese u krye në kuadër të planit të vizitave periodike monitoruese të Avokatit të Popullit për vitin 2015. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të inspektimit, u krye fillimisht takimi me Shefin e Shtabit të këtij reparti ushtarak, i cili tregoi bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të vizitës, në zbatim të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Në Repartin Ushtarak Nr. 1010 Vau i Dejës, Shkodër, dhomat e sigurisë ishin mbyllur. Në bazë të ligjit Nr. 8671, datë 26.10.2000 “*Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit të FA të RSH*”, i ndryshuar, dhe ligjit Nr. 9183, datë 05.02.2004 “*Për Disiplinën Ushtarake në Forcat e Armatosura në RSH*”, urdhrat për masën “*ndalim disiplinor*”, të dhëna nga ky Institucion, duhej të zbatoheshin në Batalionin e Policisë Ushtarake (BPU) Sauk, Tiranë. Për ekzekutimin e urdhrave dhe ndjekjen e gjithë procedurave në zbatim të tyre ngarkohej një person përgjegjës i këtij Institucioni. Pas nxjerrjes së urdhrat për dhënien e masës disiplinore, ushtaraku i cili kishte marrë këtë masë, duhej të paraqitej në BPU. Në rast refuzimi, policia ushtarake merrte masa për shoqërimin e ushtarakut në ambientet e këtij të fundit.

Nga ana e Shefit të Shtabit të këtij institucioni, u bë me dije se asnjë masë “*ndalim disiplinor*” nuk ishte dhënë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, kjo e bazuar edhe nga rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit. Për verifikimin e sa më sipër, ekspertët e MKPT-së administruan një fotokopje të librit të ndalimit disiplinor të këtij institucioni.

**Policia Ushtarake Sauk, Tiranë - Datë 18.11.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e ushtarakëve të cilëve masa “*ndalim disiplinor*” zbatohet në këtë institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201500026 Prot. K1/I5-2, datë 17.02.2015, me lëndë: “Rekomandime për inspektimin e kryer në Batalionin e Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistës konfidenciale me personin e vetëm që u gjend aty gjatë këtij inspektimi, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që katër rekomandime kishin gjetur zbatim; ai lidhur me afishimin e posterave me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masë “ndalim disiplinor”, ai mbi sigurimin e paketave të plota të produkteve të higjienës personale, ai mbi plotësimin me përgjegjësi të plotë të të gjitha rubrikave në regjistrat për ndalimin disiplinor dhe për heqjen e mjeteve të forcës, shkop gome dhe pranga nga zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë. Ndërkohë që mbeteshin të parealizuara rekomandimet e tjera.

Në Policinë Ushtarake kishte dhoma të sigurisë, të cilat shërbenin për zbatimin e masave “ndalim disiplinor” sipas ligjit nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe konform udhëzimit nr. 5, datë 22.04.2015, të Ministres së Drejtësisë “Për procedurën Disiplinore në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për rikonstrukcionin e plotë të dhomave të sigurisë në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë dhe pajisjen e tyre me zile elektrike.
2. Marrjen e masave për afishimin e posterave me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masën “*ndalim disiplinor*” në ambientet ku të jenë të aksesueshme nga ushtarakët.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin ku ndodhen dhomat e sigurisë.
4. Marrjen e masave për sigurimin e ngrohjes në dhomat e sigurisë.
5. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në dhomën e takimit me familjarët sipas standardeve të vendosura nga “*Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore*” si dhe protokollin e saj shtesë, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996.

## **7. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2014 në Spitalet Psikiatrike**

### **Shërbimi i Psikiatrisë, QSU, Tiranë – Datë 04.03.2015**

Kjo ishte vizita e parë periodike monitoruese e MKPT-së në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza” Tiranë për vitin 2015. Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kërkoi fillimisht takim me shefin e këtij shërbimi, por në mungesë të tij, takimi u krye me shefen e shërbimit të urgjencës së spitalit, e cila u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

Gjatë bisedës me shefen e urgjencës, ekspertet e MKPT-së u informuan se zona e mbulimit të këtij shërbimi spitalor me shtretër përfshin rrethin e Tiranës dhe të Kavajës. Kapaciteti maksimal i këtij shërbimi spitalor është 89 shtretër të ndarë në dy shërbime: shërbimi i psikiatrisë për të rriturit me kapacitet zyrtar 74 shtretër, dhe shërbimi i psikiatrisë për fëmijë dhe adoleshentë me kapacitet zyrtar 15 shtretër.

Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit gjendeshin 72 persona, në shërbimin e psikiatrisë për të rritur dhe 5 në atë për fëmijët dhe adoleshentët.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e QSU “Nënë Tereza” Tiranë për krijimin e një zyre informacioni në këtë shërbim, si dhe vendosjen e tabelave orientuese në ambientet e brendshme të tij.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e plotë të dhomës së izolimit duke e kompletuar atë në përputhje me Paketën e Akteve Nënligjore të mbështetur në ligjin Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, dhjetor 2013, pika 4.
3. Marrjen e masave për rikonstruksionin e katit të nëndheshëm të godinës katërkatëshe të këtij spitali me shtretër dhe kthimin e tij në një ambient komod rehabilitimi dhe aktiviteteve për pacientët.
4. Marrjen e masave për krijimin e një pavijoni të posaçëm për persona abuzues me substanca narkotike, të cilët manifestojnë çrregullime të sjelljes apo/dhe psikotike.
5. Marrjen e masave për furnizimin e këtij institucioni me mjete të kufizimit fizik konform standardeve të parashikuara në Paketën e Akteve Nënligjore të ligjit Nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, dhjetor 2013 pika 1.1.
6. Marrjen e masave për vendosjen e një sistemi monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të këtij institucioni, ku nuk cenohet privatësia e pacienteve, si masë parandaluese e trajtimit çnjerëzor dhe degradues të pacientëve si dhe me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor në nivel sigurie në marrëdhëniet personel mjekësor-pacient, për vetë specifikën që ky institucion ka.
7. Marrjen e masave për vënien në funksion të plotë të sistemit qendror të ngrohjes.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e regjistrave të sekretuar nga ana e drejtorisë juridike pranë QSUT-së.
9. Marrjen e masave për sigurimin e regjistrave të posaçëm për kufizimin fizik, bazuar në nenin 27 të ligjit për shëndetin mendor, si dhe për shtrimet e pavullnetshme, si domosdoshmëri e një paraqitjeje transparente dhe të detajuar të procedurave të ndjekura për këto shtrime bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 20 pika 2 (a, b dhe c).
10. Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për hapjen e qendrave ditore, të cilat do mund t’i ofronin një kujdes social si dhe rehabilitues personave të cilëve iu mungon mbështetja familjare apo/dhe sociale.
11. Marrjen e masave për shtimin në organikën e këtij Institucioni të numrit të infermierëve, berberit dhe një punonjësi për mirëmbajtjen, duke pasur parasysh specifikën e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër.

### **Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër, Shkodër – Datë 02.06.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në Spitalin Psikiatrik Shkodër për vitin 2015, u krye në përputhje me procedurën monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte

grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. K4/I66-2 Prot., datë 14.01.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të pacientëve në Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat e trajtuar në këtë institucion, me stafin e tij, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që rekomandimet mbi; zbatimin e procedurave për shtrimet e pavullnetshme, atashimin e një juristi nga ana e DSHP-së Shkodër pranë spitalit psikiatrik, vënien në funksion të plotë të sistemit vëzhgues me kamera, mbajtjen e kampionëve ushqimorë në kushte frigoriferike dhe me dry, si dhe përfshirjen e stafit të spitalit në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me heqjen e zotësisë për të vepruar të pacientëve të këtij institucioni, kishin gjetur zbatim, ndërkohë që mbeteshin të parealizuara rekomandimet e tjera.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për gjetjen e një zgjidhjeje për trajtimin e personave me masën mjekësore “mjekim i detyruar” konform nenit 28 të ligjit Nr. 44/2012 ”Për Shëndetin Mendor”.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e një dhome të posaçme të kufizimit fizik në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.
3. Marrjen e masave për furnizimin e këtij institucioni me mjete të kufizimit fizik konform standardeve evropiane dhe akteve nën ligjore të ligjit për shëndetin mendor.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së këtij institucioni me mjekë psikiatër.
5. Marrjen e masave për afishimin e të drejtave të pacientit në të gjithë ambientet e këtij institucioni.
6. Marrjen e masave nga ana e stafit psiko social, për dokumentimin e ecurisë dhe trajtimeve terapeutike të pacientëve në dosje të veçanta psiko sociale, duke qenë se hapësira e parashikuar në kartelat mjekësore është e pamjaftueshme.

### **Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan - Datë 16.10.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan për vitin 2015, u krye në përputhje me procedurën monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201401340 Prot. K1/I31-2, datë 25.07.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit pacienteve në Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat që trajtoheshin në këtë institucion dhe me stafin e tij, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që vetëm tre rekomandime kishin gjetur zbatim; ai mbi përfshirjen e mjekut psikiatër me të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në funksion

të një shërbimi sa më efikas, ai mbi përfshirjen e stafit psiko-social në vendimmarrje për rastet që trajtohen në këtë institucion, si dhe ai në lidhje me plotësimin e regjistrit të konsultave sipas zërave të pasqyruar në të. Pjesërisht i realizuar ishte rekomandimi në lidhje me lagështirën në pavijone, dushe dhe tualete në sajë të një ri konstruksioni me donacion, ndërkohë që mbeteshin të parealizuara të gjitha rekomandimet e tjera.

Spitali psikiatrik “Sadik Dinçi” Elbasan me një kapacitet zyrtar prej 310 shtretërisht, në momentin e vizitës inspektuese akomodonte 320 persona, një problematikë kjo e shfaqur edhe në inspektimin e një viti më parë me një mbipopullim prej 10 pacientësh mbi kapacitet.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit në spital dhe respektimin e hapësirës personale, duke rritur numrin e daljeve, si dhe realizimin e shtrimeve konform kriterëve, me referim nga QKSHM-të e rretheve përkatëse të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me gjetjen e një zgjidhjeje për rreth 57 persona me aftësi të kufizuar intelektuale, rezidentë të këtij spitali prej vitesh, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
3. Marrjen e masave për hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet spitalit psikiatrik dhe Drejtorive Vendore të Policisë apo komisariateve të varësisë, për shoqërimin e personave me probleme të shëndetit mendor nga policia në kushte dinjitoze dhe humane kur bëhet fjalë për rastet që përbëjnë rrezik për vetën apo të tjerët.
4. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me krijimin e një sektori juridik, si pjesë e qenësishme dhe funksionale e organikës së institucionit, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të personave nën trajtim, si edhe të vetë institucionit.
5. Marrjen e masave urgjente për krijimin e një dhome të kufizimit fizik, si dhe sigurimin e mjeteve shtrënguese (këmisha force dhe rripa lëkure) të domosdoshme për realizimin e imobilizimit sipas nenit 27 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, për rastet e veçanta të trajtimit (axhitimit psiko-motor, tentativa suicidale apo homocidale).
6. Marrjen e masave për gjetjen e zgjidhjes për rastet abuzues me substancat narkotike apo/dhe alkoolin, të cilët duhen trajtuar në repartin e toksikologjisë, pasi ky institucion nuk ofron burime njerëzore si dhe infrastrukturë të tillë për të ofruar një shërbim mjekësor për këtë kategori pacientësh.
7. Marrjen e masave urgjente për shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në këtë institucion.
8. Marrjen e masave për riorganizimin dhe ndarjen e pacienteve akutë nga ato rezidentë në këtë institucion, në mënyrë që të lehtësohet edhe puna e personelit në pavijonet përkatëse.
9. Marrjen e masave të vendosjes së një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi në të gjithë ambientet e këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
10. Marrjen e masave për ndarjen në mënyrë proporcionale të personelit në pavijone, në raport me numrin e pacienteve për pavijon.

11. Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në pavijone, duše dhe tualete në mënyrë që të ofrohet një shërbim sa më dinjitoz i personave që trajtohen në këtë spital.
12. Marrjen e masave për zbatimin e ligjit për shëndetin mendor për sa i përket ekipit multidisiplinar duke përfshirë stafin psiko-social në vendimarrjen për të gjitha rastet që trajtohen në këtë institucion, me fokus të veçantë vendimet e rëndësishme të heqjes së zotësisë për të vepruar dhe dhënies së kujdestarisë për persona që trajtohen në këtë spital.
13. Marrjen e masave të menjëhershme për mundësimin e kryerjes rutinë të matjeve të nivelit të Lithiemisë dhe Tegretolemisë, si një domosdoshmëri e përcaktuar dhe në protokollin e mjekimit.
14. Marrjen e masave të menjëhershme në vënien në funksion të plotë të aparatit të EKG-së.
15. Kompletimin e dhomës së stomatologes me instrumente dhe materiale dentare.

### **Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, Vlorë - Datë 23.10.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e pacientëve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201402312 Prot. K1/I80-2, datë 06.01.2015, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të pacientëve në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat që trajtoheshin në këtë institucion dhe me stafin e tij, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që dhjetë rekomandime kishin gjetur zbatim, kjo pasi ky spital i ngritur si një spital i ri me godinë të re dhe konform standardeve ndërkombëtare, si dhe legjislacionit në fuqi ka bërë që shumë problematika të gjetura një vit më parë të kenë gjetur zgjidhje. Ndërkohë që mbeteshin të porealizuara rekomandimet e tjera, të cilat kanë të bëjnë me kushtet dhe trajtimin e pacientëve që janë rezidentë prej vitesh në këtë institucion.

Spitali Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë me një kapacitet zyrtar prej 160 pacientësh, nga të cilët 110 kronikë dhe 50 pacientë akut dhe sub-akut. Në momentin e vizitës inspektuese spitalin e ri trajtonte 30 pacientë, ndërsa pjesa e pavijoneve kronike ishte me kapacitet të plotë.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me gjetjen e një zgjidhjeje për rreth 40 persona me aftësi të kufizuar intelektuale, 9-të pacientëve që nuk i takojnë zonës së mbulimit të këtij spitali, të cilët janë rezidentë prej vitesh në këtë institucion në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
2. Marrjen e masave për hartimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet spitalit psikiatrik dhe Drejtorive Vendore të Policisë apo komisariateve të varësisë, për shoqërimin

e personave me probleme të shëndetit mendor nga policia e shtetit në kushte dinjitoze dhe humane, kur bëhet fjalë për rastet që përbëjnë rrezik për veten apo të tjerët.

3. Marrjen e masave për vendosjen e një sistemi monitorues kamerash vëzhgimi edhe në pavijonet kronikë të këtij institucioni, si një ndër aspektet më të rëndësishme të parandalimit të veprave të dhunshme ndaj shtetasve dhe anasjelltas, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
4. Marrjen e masave të menjëhershme lidhur me lagështirën e theksuar në godinën e vjetër, dhoma, dushe e tualete dhe përmirësimin e këtyre të fundit.

## **8. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 në Qendra**

### **Qendrën e Mbyllur për Të Huajt, Kareç - Datë - 18.03.2015**

Qendra e Mbyllur për Të Huajt, Kareç është ngritur me VKM nr. 1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me qëllim strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Riparimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme. Rregullorja e brendshme e Qendrës është miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në mjediset e institucionit gjatë inspektimit ndodheshin 92 shtetas të huaj, prej nga 4 shtetase të huaja femra. Kapaciteti zyrtar i kësaj qendre është 125 persona.

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi inspektues kreu fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit, i cili u shpreh i gatshëm për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit. Gjatë takimit, grupi inspektues, kërkoi fillimisht informacion në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e personave në qendër, si dhe mbi mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të problematikave të ndeshura.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për shtimin e stafit të kësaj qendre me një punonjës social, një psikolog, një përkthyes të gjuhës arabe, një jurist, punonjës sigurie dhe një punonjës sanitar, me qëllim respektim e të drejtave të të huajve në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.



2. Marrjen e masave të menjëhershme për të parashikuar një mjek dhe një stomatolog në organikën e sektorit shëndetësor në mënyrë që në institucion të ofrohet një shërbim shëndetësor i plotë dhe efikas.
3. Marrjen e masave për të plotësuar ambientet rekreative të brendshme e të jashtme me pajisjet e nevojshme për aktivitete sportive.
4. Marrjen e masave për pajisjen me televizorë me antenë satelitore për të mundësuar informimin e të huajve me ngjarjet nga vendet e tyre e në botë në gjuhët që ata kuptojnë.
5. Marrjen e masave për izolimin e tarracës për të parandaluar lagështirën në institucion.
6. Marrjen e masave për vënien në funksionim të kamerave të perimetrit të jashtëm.
7. Marrjen e masave për pajisjen me lavastovilje e materiale lehtësuese për kuzhinën e institucionit.
8. Marrjen e masave për ndrimin e menjëhershëm të dymave në dhomat e izolimit, vënien sa më parë në funksion të kamerave të sigurisë në këtë ambient, zbatimin e afateve kohore të izolimit në përputhje me Rregulloren për Qendrën e Mbyllur dhe vënien e sistemit të alarmit në çdo dhomë izolimi, me qëllim evitimin e situatave të padëshiruara.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për të parashikuar një mjek dhe një stomatolog në organikën e sektorit shëndetësor në mënyrë që në institucion të ofrohet një shërbim shëndetësor i plotë dhe efikas.

### **Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç – Datë - 19.03.2015**

Institucioni i Avokatit të Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ka filluar hetimin administrativ lidhur me protestën e 19 shtetasve të huaj të parregullt të Qendrës së Mbyllur, Kareç, të cilët po zhvillojnë grevën e urisë që prej datës 19.03.2015, ora 08.00.

Stafi i Avokatit të Popullit e ka monitoruar situatën nga afër dhe ka mundur të komunikojë me autoritetet e institucionit si dhe me personat e strehuar në qendër, përfshirë ata në grevë urie të cilët kërkojnë të mos trajtohen të mbyllur në qendër, por të kthehen në vendin prej të cilit kanë hyrë në territorin Shqiptar.

Vendimi i shtetasve të huaj për të protestuar në këtë mënyrë e formë është personal dhe duhet respektuar nga çdo organ i administratës shtetërore, pjesë e të cilës është edhe Ministria e Shëndetësisë.

Nga Drejtori i Qendrës së Mbyllur për të Huajt, Kareç, është bërë me dije se përgjatë grevës, personat me probleme shëndetësore janë trajtuar pranë Spitalit Rajonal të Durrësit, e se janë shoqëruar atje me automjetet e institucionit, në mungesë të ambulancës në Qendër, si dhe në pamundësi të mbulimit 24 orësh me ambulancën që ka në dispozicion Spitali. Sjellim në vëmendjen tuaj se stafi mjekësor i Qendrës nuk ka kapacitetet për ta monitoruar nga afër gjendjen e personave në ambientet e grevës së urisë në 24 orë.

Aktet normative që janë në fuqi në vendin tonë nuk parashikojnë të drejtën e grevës së urisë. Pra marrëdhëniet juridiko-shoqërore që rregullojnë grevën e urisë nuk janë të rregulluara nga legjislacioni ynë dhe për këtë problem i kemi sugjeruar Ministrisë së Drejtësisë që të shikojë mundësinë e përgatitjes së një projekt-ligji dhe dërgimin e tij për miratim në Kuvend me qëllim plotësimin e këtij vakumi ligjor.

Në nenin 21 Kushtetutës parashikohet se jeta e personit mbrohet me ligj. Pra, Kushtetuta jonë është shprehur qartë për mbrojtjen e jetës me ligj dhe për garantimin e kësaj të drejte themelore dhe më të rëndësishme të njeriut kanë detyrim në radhë të parë organet e administratës publike, shërbimi mjekësor dhe policia si pjesë e saj. Një nga të drejtat themelore të njeriut të garantuara nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 3 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, *për të mos iu mos u nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruarës*. Ndërkohë kujtojmë se sipas nenit 17 të Kushtetutës, *kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ*.

Sjellim në vëmendje se për problemin e grevës së urisë, ndonëse ka vakum ligjor në të drejtën e brendshme, në fakt janë miratuar disa akte ndërkombëtare dhe rajonale sikurse mund të përmendim:

1. “Deklaratën për Grevën e Urisë (Deklarata e Maltës e vitit 1991 e rishikuar në vitin 1992)”, miratuar nga Asambleja e 43-të Botërore e Mjekësisë mbajtur në Maltë, në Nëntor 1991, e rishikuar nga Asambleja e 44-të Botërore e Mjekësisë mbajtur në Marbella të Spanjës, në Shtator 1992 dhe nga Asambleja e 57-të Botërore e Mjekësisë, mbajtur në Pilanesberg të Afrikës së Jugut, në Tetor 2006”. Sipas nenit 1 të kësaj Deklarate, *grevat e urisë janë shpesh një formë e protestës nga njerëzit që nuk kanë mënyra të tjera për të bërë të njohura kërkesat e tyre. Me refuzimin e të ushqyerit për një periudhë të konsiderueshme, ata zakonisht shpresojmë që protesta të marrë qëllime të caktuara duke shkaktuar publicitet negativ mbi autoritetet. Në pjesën udhëzime për menaxhimin e grevistëve të urisë të po të njëjtës Deklarate parashikohet se:*
  - *Mjekët duhet të vlerësojnë kapacitetin mendorë të individëve. Kjo përfshin verifikimin e aftësisë mendore të individëve me qëllim që individët e paaftë mendërisht të mos lejohen të bëjnë grevë urie.*
  - *Mjekët duhet të bisedojnë me grevistët e urisë në privatësi dhe larg dëgjimit të gjithë njerëzve të tjerë dhe duhet të respektojnë konfidencialitetin. Ata duhet të bëjnë një ekzaminim të plotë të grevës së urisë që në fillim të saj dhe duhet t’u shpjegojnë pasojat dhe implikimet mjekësore që mund të vijnë prej saj.*
  - *Mjekët duhet të binden se refuzimi për ushqim ose trajtim është zgjedhja vullnetare e individit. Grevistët e urisë duhet të mbrohen nga shtrëngimi. Mjekët shpesh mund të ndihmojnë për të arritur këtë dhe duhet të jenë të vetëdijshëm se shtrëngimi mund të*

*vijë nga grupi i kolegëve, autoritetet apo të tjerët. Mjekët ose personeli tjetër i kujdesit shëndetësor nuk mund të ushtrojnë presion të panevojshëm të çdo lloj te grevisti i urisë për të pezulluar grevën. Kujdesi apo trajtimi i grevistit të urisë nuk duhet të kushtëzohet me pezullimin e grevës së urisë.*

- *Të ushqyerit artificial mund të jetë i përshtatshëm nga ana etike nëse grevistët e urisë e pranojnë atë në mënyrë të ndërgjegjshme. Ajo gjithashtu mund të jetë e pranueshme nëse individët kanë lënë paraprakisht udhëzime për ta refuzuar atë.*
- *Të ushqyerit me forcë nuk është etike dhe e pranueshme. Edhe në qoftë se ka për qëllim të përfitojnë, të ushqyerit e shoqëruar nga kërcënimet, detyrimi me forcë apo përdorimi i kufizimeve fizike është një formë e trajtimit çnjerëzor dhe degradues.*

2. Deklaratën e Tokio-s - Udhëzime për mjekët lidhur me torturën dhe trajtimin mizor, çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimit në lidhje me ndalimin dhe burgosjen”, miratuar nga Asambleja e 29-të Botërore e Mjekësisë, mbajtur në Tokio të Japonisë, në Tetor 1975 dhe rishikuar nga sesioni i 170- të i Këshillit të Asamblesë Botërore të Mjekësisë, mbajtur në Divonne-Les-Bains, të Francës, në Maj 2005.

3. Rekomandimin Nr. R (96) 11 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Në pikën 60-të të tij përshkruhet refuzimi i trajtimit mjekësor të grevistëve të urisë. Kjo pikë e Rekomandimit parashikon se: *“Në rastin e refuzimit të trajtimit, mjeku duhet t’i kërkojë deklaratë me shkrim pacientit, në praninë e një dëshmitari. Mjeku duhet t’i japë informacion të plotë pacientit lidhur me përfitimet e mundshme nga mjekimi, alternativat e mundshme terapeutike si dhe ta paralajmërojë për rreziqet që sjell refuzimi i trajtimit mjekësor. Në çdo rast, duhet që pacienti të kuptojë në mënyrë sa më të plotë situatën e tij. Nëse të kuptuarit pengohet nga faktorë të tillë si gjuha që flet pacienti, duhet të kërkohet një përkthyes me përvojë”.*

Nga përmbajtja e këtyre akteve rezulton e qartë se, kushtet e grevës së urisë i vendosin vetë grevistët, ndërsa **menaxhimin e grevës e bëjmë vetëm mjekët**. Sipas këtyre akteve rezulton se grevistët e urisë vendosin vet edhe për ushqyerjen artificiale të tyre, por ndalohej ushqyerja me forcë. Ndërkohë nga këto akte rezulton se grevistët e urisë nuk mund të pengohen për të përdorur lëngje të tilla që kanë si përbërës sheqerin, si çaj, serum (glukozë), kafe, apo ujë me trisol. Gjithashtu këto akte ndalojnë veprimet kërcënuese, kufizimet fizike e veprime të tjera të kryera nga mjekët apo ndonjë autoritet tjetër shtetëror me qëllim ndërprerjen ose pezullimin e grevës së urisë.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Të merren masat e nevojshme për ofrimin e kujdesit shëndetësor 24 orësh për shtetasit e huaj në grevë urie, në ambientet e Qendrës së Mbyllur për të Huajt, Kareç.
2. Të merren masat e nevojshme për njohjen e personelit mjekësor me aktet ndërkombëtare e rajonale që trajtojnë grevën e urisë, të cilat i kemi përshkruar më sipër.

## **Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues Babrru, Tiranë – Datë 17.09.2015**

Vizita periodike monitoruese e ekspertëve të Avokatit të Popullit në Qendrën Kombëtare Pritëse Për Azilkërkues (QKPA) Babrru, Tiranë për vitin 2015 u krye në përputhje me procedurën monitorimit të MKPT-së. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin e azilkërkuesve në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201401745 Prot. K1/I42-2, datë 19.11.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të azilkërkuesve në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat që trajtoheshin në këtë qendër dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që vetëm dy rekomandime kishin gjetur zbatim; ai mbi përfundimin e rikonstruksionit të mjediseve të brendshme të qendrës, si dhe ai lidhur me furnizimin me veshmbathje sipas stinës dhe grup-moshave të personave të strehuar në qendër, ndërkohë që mbeteshin të parealizuara të gjitha rekomandimet e tjera, të cilat do përmenden në pikat e mëposhtme të këtij dokumenti.

QKPA me një kapacitetit zyrtar prej 170 personash, në momentin e vizitës inspektuese strehonte 27 persona, nga të cilët 20 të rritur dhe 7 fëmijë. Këta të fundit ishin të akomoduar në këtë qendër bashkë me familjet e tyre, 5 të tilla. Shtetasit me kombësi të ndryshme që gjendeshin në këtë qendër ishin nga Afganistani, Bullgaria, Armenia, Kosova, Turqia etj..

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për shtimin në organikën e këtij institucioni të një juristi, një punonjësi social, një psikologu, një edukatori, një kujdestari, si dhe një personeli mjekësor, duke marrë në konsideratë faktin se kur kjo qendër akomodon me kapacitet të plotë 170 persona, nevoja për personel shtesë rezulton e domosdoshme.
2. Marrjen e masave për afishimin e të drejtave dhe detyrimeve të përfituesve të kësaj qendre konform standardeve ndërkombëtare.
3. Marrjen e masave për hartimin e një marrëveshjeje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me ofrimin e mundësive për formim profesional në Qendrat e Formimit Profesional në varësi të kësaj Ministrie, si edhe mundësi për punësim pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, përsëri në varësi të kësaj Ministrie për të gjithë personat e strehuar në QKPA, që janë të interesuar.
4. Marrjen e masave për trajtimin e personave të strehuar në QKPA me ndihmë ekonomike siç parashikohet në ligjin nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.

5. Marrjen e masave për ruajtjen e kësaj qendre me personel nga DPSH, sipas pikën 5 të VKM-në nr. 262, datë 23.04.2014.

### **Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë - Datë - 25.09.2015**

Kjo ishte vizita periodike monitoruese e Avokatit të Popullit në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut për vitin 2015. Qëllimi i vizitës ishte grumbullimi i informacionit në lidhje me të drejtat, kushtet dhe trajtimin i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në institucion, si dhe verifikimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit përmes shkresës me Nr. 201401744, Prot. K4/I 41-2, datë 13.11.2014, me lëndë: “Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në Qendrën Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut”.

Nga informacioni i grumbulluar në vend, gjatë kryerjes së intervistave konfidenciale me personat që trajtoheshin në këtë qendër dhe me stafin e institucionit, si dhe përmes verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve dhe mjediseve, rezultoi që vetëm 3 rekomandime kishin gjetur zbatim; ai mbi plotësimin e dosjeve personale të përfituesve, ai mbi furnizimin me veshjet e dimrit të përfituesve, vënien në funksion të makinave larëse si dhe të kompjuterëve në bibliotekë, ndërkohë që mbeteshin të parealizuara ose pjesërisht të realizuar rekomandimet e tjera.

Në momentin e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 10 viktimat/viktima të mundshme të trafikimit (VT/VMT), nga të cilët një femijë, në raport me kapacitetin zyrtar të kësaj qendre prej 80 shtretërish.

Kjo qendër është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, i cili, ndër të tjera, përveçse parashikon në pikën 3 të tij se në këtë qendër trajtohen edhe emigrantë klandestinë që kalojnë përmes Shqipërisë, nuk parashikon detyrat funksionale të këtij institucioni apo shërbimet që ofrohen në të. Grupi i inspektimit vë re QKPVT-ja, bazuar edhe në ligjin nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” duhet të ndryshojë bazën ligjore të funksionimit, duke marrë në konsideratë vërejtjet sa më lartë.

Për sa më sipër në përfundim të raportit të monitorimit u rekomandua:

1. Marrjen e masave për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, bazuar në ligjin nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, për të parashikuar detyrat funksionale të këtij institucioni, shërbimet që ofrohen në të, si edhe përcaktimin e përfituesve sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit.
2. Marrjen e masave për sigurimin e fondeve për rikonstruksionin e plotë të ambienteve të brendshme, dhomave, ambienteve të përbashkëta, kuzhinës, dusheve dhe tualeteve të këtij institucioni.
3. Marrjen e masave për punësimin me kohë të plotë të juristit dhe psikologut.

4. Marrjen e masave për rikonstruksionin e sistemit qendror të ngrohjes në këtë institucion.
5. Marrjen e masave për pajisjen me libreza shëndetësore dhe vënien në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve për të gjitha përfitueset e kësaj qendre.
6. Marrjen e masave për ruajtjen e kampionëve ushqimor në kushte frigoriferike me dry.

## **9. Rekomandimet e dërguara në bazë të Inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 në Drejtoritë e Policisë Kufitare dhe Komisaritet e Stacionet e Varësisë**

### **Rekomandim drejtuar Drejtorit të përgjithshëm për Kufirin dhe Migracionin mbi marrja e masave të menjëhershme për plotësimin sipas standardeve të kushteve të trajtimit në pikat kufitare**

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në mbështetje të nenit 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë (UNHCR), gjatë vitit 2015 ka monitoruar disa prej pikave të kalimit/ndalimit kufitar të cilat konsiderohen si ato me lëvizje më të shpeshta të të huajve të parregullt në Shqipëri dhe më konkretisht:

#### **Drejtoria e Policisë Kufitare Shkodër – Datë 02.06.2015**

Kjo drejtori ndodhet brenda godinës së Drejtorisë së Policisë Vendore Shkodër. Nuk ka asnjë ambient për të shoqëruar. Në rastet kur nevojitet shoqërimi i personave për llogari të kufirit/migracionit, kjo drejtori e realizon shoqërimin e tyre në ambientet e shoqërimit të Komisarimit Shkodër. DPK Shkodër nuk disponon një zë buxhetor për ushqimin e personave të shoqëruar. Gjithashtu nuk ka në të përkthyes për shtetasit e huaj.

Lidhur me mjetet logjistike (sistem TIMS/Skaner për gjurmët), kjo drejtori për rastet e identifikimit nuk disponon materialet e nevojshme. Nga të gjitha pikat kufitare në varësi të kësaj drejtorie, vetëm Stacioni e Policisë Kufitare dhe Migracionit Hani-Hotit disponon ambiente shoqërimi. Në atë stacion janë 2 ambiente një për meshkuj dhe një për femra/të mitur. Dhoma e shoqërimit për meshkuj është me hapësirë rreth 6 metra katror me lartësi 3.5 metra, me dritare me hekura që mundëson ndriçimin natyral. Dhoma është e pajisur vetëm me një 1 karrige. Dera është prej hekuri dhe mbyllet me shul nga jashtë (e njëjtë me ambientet e sigurisë). Dhoma për gra/të mitur është e madhe dhe në gjendje të mirë, ka pajisje akomoduese.

Në këtë stacion ka 4 tualete funksionale. Godina ekzistuese është e amortizuar. Shërbimi shëndetësor nuk ofrohet në këtë stacion, por për rastet emergjente bashkëpunohet me Spitalin e Koplikut. Çdo regjistrim i personave të shoqëruar kryhet në librin e veprimtarisë ditore.

#### **Stacioni i Policisë Kufitare Kapshticë – Datë 30.09.2015**

Ky Stacion i Policisë Kufitare është pjesë dhe vartësi e DPK të Qarkut Korçë. Stacioni vepron me struktura dhe logjistikes pranë pikës së kalimit kufitar Kapshticë dhe Stacionit të Policisë Kufitare Kapshticë, 2 km larg pikës së kalimit kufitarë te vendosur në një godinë në vete. Pranë pikës së kalimit kufitar përveç kioskave të kontrollit të pasaportave dhe personelit përgjegjës për këtë funksion, në godinën kryesore të kësaj pike kalimi gjendeshin dy zyra të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar për të identifikuar dhe proceduar lidhur me rastet e paraqitura problematike në momentin e hyrjes në territorin Shqiptarë pranë Kioskave të kontrollit.

Lidhur me rastet e identifikuar dhe konsultuara në sistemin TIMS nga ana e personelit të Policisë Kufitare për personat me probleme dokumentacioni, persona të shpallur në kërkim policor, persona të cilët kishin kaluar kufirin ilegalisht, të deportuar apo të larguar nga vendet e luftës në kërkim të statusit të refugjatit, merreshin masat e transportimit të tyre për veprime të mëtejshme pranë Stacionit të Policisë Kufitare të sipërpërmendur. Në këtë stacion policie kishte 2 dhoma intervistimi të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar intervistues. Gjithashtu kishte dhe dy dhoma shoqërimi (njëra për meshkuj dhe tjetra për gra dhe të mitur). Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me orenditë minimale për një qëndrim deri në 10 orë sipas ligjit. Përgjithësisht brenda kësaj kohe kryheshin të gjitha veprimet e duhura dhe personat liheshin të lirë apo shoqëroheshin pranë komisariateve apo institucioneve përkatëse. Në momentin e inspektimit kishte 3 persona të deportuar nga shteti Grek dhe po kryheshin intervistat dhe procedurat e duhura. Në dhomat dhe korridoret e Stacionit të Policisë mungonin posterat me të drejtat e personave të shoqëruar apo informacion informues lidhur me të drejtën për të kërkuar statusin e azilkërluesit/ refugjatit.

Megjithatë personeli intervistues kishte formularë për kërkimin e statusit të refugjatit dhe sipas tyre i viheshin në dispozicion së bashku me sqarimet e duhura të gjithë të interesuarve. Grupit inspektues iu bë me dije se javët e fundit nuk kishte pasur raste të personave jo Shqiptarë të cilët të kishin kaluar kufirin shtetëror pranë kësaj pike kufitare në kërkim të këtij statusi.

### **Stacioni i Policisë Kufitare në pikën e kalimit kufitar Tre Urat – Përmet – Datë 06.10.2015**

Në këtë pikë kufitare, mjediset e pritjes ishin shumë të kufizuara duke qenë se shumica e personave që ndalon në këtë pikë kufitare janë të kategorisë INAD (persona të shpallur si të papranuar për t'u futur në shtetin fqinj), ose persona të cilët kthehen forcërisht nga territori grek. Për të dy kategoritë, ka pasqyrim të ndarë e korrekt në regjistrat përkatës. Personat e kategorisë INAD, lejohen që të vazhdojnë sërish udhëtimin drejt territorit grek pasi ata plotësojnë kushtet për dokumentacion të kërkuara nga pala greke. Personat e deportuar, intervistohen në mjediset e pikës së kalimit kufitar, mjediset të vlefshme vetëm për qëndrim fare të përkohshëm. Përveç rasteve të rralla kur ndonjë prej tyre mund të rezultojë në sistem si i kërkuar nga organet e zbatimit të ligjit, në gjithë rastet e tjera ata lihen të lirë që të kthehen në shtëpitë e tyre në territorin shqiptar.

Kjo pikë kufitare ka një efektiv prej 26 agentë dhe oficerë të Policisë Kufitare dhe të Migracionit, të cilët punojnë me turne dhe mbulojnë si vendkalimin e paracaktuar kufitar, ashtu edhe zonën e kufirit të gjelbër përreth.

Një kopje e udhëzimit të dhënë nga Drejtoria e Departamentit të Policisë Kufitare dhe të Migracionit për këto kategori u nda edhe me ekipin intervistues. Sipas tij, personat që janë deportuar vetëm një herë nga territori grek lejohen që të udhëtojnë në drejtim të këtij territori në mënyrë të ligjshme. Ato mjedise të kufizuara pritur që janë në pikën e kalimit kufitar, shërbejnë vetëm për personat që konstatohen se janë shpallur në kërkim apo për personat e deportuar, por edhe kjo për një periudhë prej jo më shumë se 10 orësh. Më pas këta persona merren ose nga komisarati i policisë që e ka shpallur personin në kërkim – në rastin e këtyre të fundit, ose nga Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare dhe të Migracionit Gjirokastrë.

Në lidhje me shtetasit e ashtuquajtur “të vendeve të treta”, pra jo shtetas shqiptarë dhe jo shtetas të Bashkimit Europian BE, gjatë vitit 2015 ishin ndaluar vetëm 2 shtetas sirianë të cilët ishin dërguar menjëherë nën autoritetin e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare dhe të Migracionit në Gjirokastrë. Si edhe në rastet e pikave të tjera, sipas informacionit të dhënë nga zyrtari i intervistuar, këta persona, nëse nuk ktheheshin për në territorin grek menjëherë, shoqëroheshin për në Qendrën e Mbyllur në Karreç, Durrës.

Nga shqyrtimi i regjistrave, rezultoi se ato ishin në gjendje shumë të rregullt e aty ishin bërë pasqyrimet e duhura si për personat e kategorisë INAD ashtu edhe për të deportuarit. Po kështu ishte edhe gjendja e regjistrit që pasqyron daljen e përkohshme të materialeve për patrullën e gjelbër, e regjistrit që pasqyron instruktazhin përgjegjës të turnit, si edhe libri i marrjes dhe dorëzimit të shërbimit të përgjegjësi i turnit. Një tjetër regjistër në të njëjtën gjendje ishte edhe ai për hyrjet dhe daljet e shtetasve me mjete të regjistruara në Shqipëri (në përdorim në rastet kur nuk ishte në funksionim sistemi TIMS).

Në regjistrin e shtetasve të kapur në kufi, i cili regjistron shtetasit që tentojnë të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme, figuronin 10 shtetas sirianë të shënuar për vitin 2015. Datat e hyrjes ishin 18 shkurt 2015 dhe 3 të fundit ishin ndaluar në dt. 12 mars 2015. Sipas informacionit të dhënë nga zyrtari i kontaktuar, ata ishin dërguar të gjithë në Drejtorinë Rajonale Gjirokastrë. Nuk kishte informacion në regjistër nëse këta shtetas kishin kërkuar azil gjatë ndalimit dhe qëndrimit në Vendkalimin Kufitar Tre Urat në Përmet.

Mjedisi i shoqërimit të shtetasve përbëhej nga 1 dhomë që ishte e përmasave 4 x 4 m, me dritare të përmasave standarde rreth 1 x 1 m, të përforcuara me kangjella, i pajisur me 2 divane gjithashtu të përmasave standarde të tregut. Mjedisi përkatës i tualetit përbëhej nga 1 hapësirë me 3 tualete, 1 pajisje dushi jashtë funksionit dhe 2 lavamanë në gjendje pune.

Transporti i personave bëhej në mënyrë të organizuar për personat dhe shoqëruesit e tyre, të paktën deri në Përmet.

Kushtet e pritjes parashikohet të jenë në funksion të flukseve të mundshme migratore, për sa mund të jetë e synuar dhe e kalueshme në pjesën e kufirit të gjelbër pika e kalimit kufitar Tre Urat.

Kërkesa kryesore e personelit lidhej me mundësinë për mjedise akomodimi të paktën në Çarçovë, si pikë më e arritshme nga pika e kalimit kufitar, si edhe për mjete e transport të organizuar si për personat e kapur edhe për personelin e Pikës Kalimit Kufitar Tre Urat.



Në kuadrin e hartimit të masave paraprake të emergjencës në rast të paraqitjes në kufi që një numri të madh shtetasish në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare e ndihmesë humanitare, për ndihmesë të menjëhershme, para dërgimit të tyre në Qendra të tjera apo para kthimit mbrapsht për në territorin grek, pika më e mirë e mundshme e akomodimit do të ishte në Çarçovë.

### **Stacioni i Policisë Kufitare pranë Pikës së kalimit kufitar Kakavijë – Datë 07.10.2015**

Ky vendkalim kufitar është pjesë dhe vartësi e Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit të Qarkut Gjirokastrë. Pranë pikës së kalimit kufitar përveç kioskave të kontrollit të pasaportave dhe personelit përgjegjës për këtë funksion në godinën kryesore të kësaj pike kalimi gjendeshin dy zyra të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar për të identifikuar dhe proceduar lidhur me rastet e paraqitura problematike në momentin e hyrjes në territorin shqiptar pranë kioskave të kontrollit. Stacioni vepronte me struktura dhe logjistikë pranë pikës së kalimit kufitar Kakavijë.

Mjediset e pritjes pranë kësaj pike të kalimit kufitar gjenden në kodrinën ngjitur me këtë vendkalim, në të cilën shkohet përmes një tuneli të gjatë rreth 100 metra, ku 77 metra është pjesa e mbuluar. Sipas zyrtarëve të kontaktuar, kishte edhe një rrugë që mundësonte vajtjen deri në majë të kodrinës, tek ndërtesa e Grupit Operacional Special (GOS), me automjete. Gjithsesi ky tunel është ai që përdoret për personat e ndaluar në pikë dhe për ata që sillen si të ndaluar e të kapur në kufirin e gjelbër.

Grupi monitorues u njoh me punën e bërë dhe praktikën e ndjekura në këtë pikë në raste të problemeve me kategori të ndryshme. Një nga kategoritë më shqetësuese ishte ajo e personave të deklaruar si të papranuar apo të papranueshëm në territorin grek për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare, pamjaftueshmëri që konstatohet nga pala greke mbi arsyetimin e diskutueshëm se personi, sipas rregullave të zonës Schengen, duhet të ketë me vete apo të disponueshme një shumë që garanton 50 euro shpenzim në ditë, çka për të 90 ditët e lejuara të qëndrimit arrin shumën 4500 euro.

Edhe këtu u verifikuan regjistrat për personat e ndaluar. Në regjistrin e personave të kategorisë INAD u vu re se kishte paqartësi në shënimet tek kolonat që shënonin vendbanimin dhe numrin e pasaportës. U rekomandua që të zgjidhej ky problem sa më shpejt.

Lidhur me rastet e identifikuar dhe konsultuara në sistemin TIMS nga ana e personelit të Policisë Kufitare për personat me probleme dokumentacioni, persona të shpallur në kërkim policor, persona të cilët kishin kaluar kufirin ilegalisht, të deportuar apo persona të ikur nga vendet e luftës në kërkim të statusit të refugjatit, ata dërgoheshin në mjedisin e pritjes të përmendur më lart. Në këtë mjedis apo qendër të vogël pritje kishte 2 dhoma intervistimi të pajisura me teknologjinë e informacionit (sistemi TIMS) dhe personelin e specializuar intervistues. Gjithashtu kishte dhe 2 dhoma shoqërimi (njëra për meshkuj dhe tjetra për gra dhe të mitur). Në mjedisin që mbante numrin më të madh të personave kishte 8 shtretër në 2 ndarje. Ushqimi në raste të një numri të madh personash shpërndahej e konsumohej po aty.

Grupi monitorues u njoh edhe me 2 mjediset që përdorshin për izolimin e personave të ndaluar apo me personat që shkaktonin probleme gjatë qëndrimit në këtë mjedis pritje. Në të gjitha mjediset e përmendura, dritaret ishin të përmasave standarde të tregut, të mbrojtura me kangjiella nga jashtë.

Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me orenditë minimale për një qëndrim deri në 10 orë sipas ligjit. Përgjithësisht brenda kësaj kohe kryheshin të gjitha veprimet e duhura dhe personat liheshin të lirë apo shoqëroheshin pranë komisariateve apo institucioneve përkatëse. Në momentin e inspektimit nuk kishte persona që po intervistoheshin apo që strehoheshin qoftë edhe përkohësisht në qendër. Në dhomat dhe korridoret e stacionit të policisë në vendkalimin kufitar mungonin posterat me informacion informues lidhur me të drejtën për të kërkuar statusin e refugjatit. Megjithatë personeli intervistues kishte formularë për kërkimin e statusit të refugjatit dhe sipas tyre i viheshin në dispozicion së bashku me sqarimet e duhura të gjithë të interesuarve. Këta formularë plotësoheshin si pjesë e procedurës së përzgjedhjes e cila synon kategorizimin e personave jo shtetas shqiptarë që ndalohen nga policia, në emigrantë ekonomikë të cilët pranojnë të kthehen vullnetarisht në vendin e tyre e kërkojnë për këtë ndihmën e IOM, në persona të trafikuar apo në rrezik trafikimi dhe në azilkërkues. Në rastin e konstatimit në pikën kufitare apo në kufirin e gjelbër të personave jo shtetas shqiptarë të cilët nuk plotësonin kushtet për hyrje apo qëndrim në territorin shqiptar, ata intervistoheshin edhe nga specialistët e Drejtorisë Rajonale në Gjirokastrë dhe pastaj dërgoheshin ose në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, ose në Qendrën e Mbyllur për të Huajt e Parregullt në Karreç, Durrës.

Grupit inspektues iu bë me dije se javët e fundit nuk kishte pasur raste të personave jo shqiptarë të cilët të kishin kaluar kufirin shtetëror pranë kësaj pike kufitare në kërkim të statusit të refugjatit.

### **Drejtoria e Policisë Kufitare Kukës – Datë 20.10.2015**

Kjo drejtori nuk ka asnjë ambient për të shoqëruar brenda saj. Në rastet kur nevojitet shoqërimi i personave për llogari të (kufirit/migracionit), kjo drejtori delegon shoqërimin e tyre në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit Kukës. Kjo drejtori nuk disponon një zë buxhetor për ushqimin e personave të shoqëruar për llogari të saj.

Lidhur me mjetet logjistike (sistem TIMS/Skaner për gjurmët), kjo drejtori për rastet e identifikimit nuk dispononte materialet e nevojshme. Nga të gjitha pikat kufitare në varësi të kësaj drejtorie, vetëm Stacioni i Policisë Kufitare dhe Migracionit Morinë dhe Bllatë disponojnë ambiente shoqërimi.

Në Stacionin Bllatë ka 2 ambiente një për meshkuj dhe një për femra/te mitur. Dhomat e shoqërimit janë 7metra katrore me lartësi 3 metra, me dritare që mundëson ndriçimin natyral me hekura dhe ka vetëm karrige. Dyert janë prej hekuri. Regjistrim i personave të shoqëruar kryhet në librin e veprimtarisë ditore.

Në Stacionin Morinë është 1 ambient shoqërimi i emërtuar dhe me të drejta të afishuara. Me hapësirë 4 metra katrore me dere hekuri dhe nuk ka dritare (e njëjtë me dhomat e sigurisë). Godina ekzistuese është tejet e amortizuar. Ka tualete, por janë në gjendje të papërshtatshme.

Regjistrimi i personave të shoqëruar kryhet në regjistrin për hyrje-daljet e shtetasve shqiptarë dhe mjeteve shqiptarë. Nuk mundësohet shërbimi shëndetësor emergjent duke pasur parasysh që ky stacion ka fluks të tejkajshëm ditor dhe sezonal. Gjithashtu nuk ka zë buxhetor për ushqimin.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për mbajtjen dhe përditësimin e një liste përkthyesish për gjuhët kryesore nga vijën e huajt e parregullt në çdo pikë kalimi kufitar.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për përpilimin, shpërndarjen, përdorimin dhe afishimin në mjedise të dukshme e lehtësisht të aksesueshme në çdo pikë kalimi kufitar të formularëve të intervistimit të huajve të gjuhët që ata i kuptojnë.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për përpilimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese me të drejtat e detyrimit e secilës prej kategorive të huajve të parregullt që rezultojnë nga intervistimi / përzgjedhja në gjuhët që ata kuptojnë në çdo pikë ku të huajt e parregullt shoqërohen e mbahen të ndaluar.
4. Marrjen e masave të menjëhershme që sistemi TIMS të jetë vazhdimisht funksional e të pasqyrojë të gjitha kategoritë e huajve të parregullt që rezultojnë nga intervistimi.
5. Marrjen e masave për të krijuar mjedise pritje funksionale dhe të mirëmbajtura, sipas standardeve, duke filluar nga pikat kufitare të largëta ku ka kalim më të madh të mundshëm të huajve të parregullt. Në këto mjedise duhet të ofrohet furnizimi me ushqim dhe ujë të pijshëm, si edhe kujdesi shëndetësor i nevojshëm, sidomos për rastet kur grupet e të ndaluarve janë më shumë nga sa mund të trajtojë zakonisht një vendkalim kufitar.

**Rekomandim drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë, Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Policisë së Shtetit mbi marrjen e masave të menjëhershme dhe të nevojshme për trajtimin në përputhje me instrumentet kombëtare e ndërkombëtare të flukseve ekzistuese dhe atyre të pritshme të migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri - Datë 30.03.2016**

Çështja e trajtimit të krizës së refugjatëve dhe migrantëve sot në Evropë është një çështje e të drejtave të njeriut dhe si e tillë duhet të përshkojë në mënyrë tërësore politikat shtetërore të vendeve pritëse, të tranzitit dhe të atyre vendeve që kanë shuma gjasa të preken nga kjo krizë e paprecedent në hapësirën e gjerë të Mesdheut. Kjo krizë, e cila kërkon një përgjigje dhe ndërveprim global, paraqet sfida komplekse si në kontekstin aktual imediat, ashtu dhe në planin afat-gjatë.

Duke mirëkuptuar prirjen që shtetet kanë për ta parë çështjen edhe nga aspekti i sigurisë, vlerat dhe udhërrëfyesit për tejkalimin e sfidave të krijuara duhet të jenë solidariteti, partneriteti dhe ndarja e përgjegjësive për menaxhimin e krizës dhe garantimin e të drejtave të refugjatëve, azil-kërkuesve dhe migrantëve të parregullt. Janë pikërisht këto parime që sot kanë një rëndësi kritike për përballjen me situatën në disa rrafshet e ndërlidhura: për garantimin e të drejtave të emigrantëve dhe menaxhimin e krizës humanitare, për zbutjen e flukseve migratore dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si edhe për integrimin e emigrantëve në shoqëritë e reja që do t'i mirëpresin apo integrimi i tyre pas riatdhesimit në vendet e origjinës.

Trajtimi humanitar i refugjatëve dhe migrantëve është detyrim për çdo vend, po aq sa ç'është edhe njohja e të drejtave që u takojnë bazuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut,

Konventën e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin shtesë të saj të vitit 1967, si dhe në Direktivat e Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 95 të vitit 2011 dhe nr. 32 e 33, të vitit 2013. Vendi ynë nuk mund të shmanget nga këto detyrime, t'i modifikojë, pezullojë apo t'i shtyjë në kohë, por përkundrazi duhet t'i trajtojë ato si edhe më të domosdoshme në kohë krize. Vlerat dhe parimet e solidaritetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nuk mund të përfaqësojnë vetëm “ushtrime ligjërimore”, por duhet të jenë udhërrëfyese të njëmendta të reflektimit dhe vizionit tonë në përballje me krizën e migracionit. Janë pikërisht shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në vende dhe rajone të përfshira nga konflikti i armatosur dhe të pllakosura nga varfëria ato që ushqejnë flukset masive migratore. Masat e ndërmarra nga shtetet që bien ndesh me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, jo vetëm që janë të dëmshme për kohezionin social, por janë inefektive dhe në fakt kundër-produktive për menaxhimin e krizës. Duhet vërtet një ndryshim “paradigmatik” lidhur me migracionin, për t'i dhënë fund “garës” së vendeve Evropiane për të kthyer emigrantët dhe për të ngritur mure, rrjeta teli apo barriera të tjera.

Në lidhje me flukset ekzistuese dhe ato të pritshme të migrantëve dhe refugjatëve, një fenomen i pranishëm dhe i padiskutueshëm në Evropën e sotme, Shqipëria mbetet ende e papërgatitur në mënyrën e duhur. Ndërsa idetë e hedhura për qendra të mundshme pritje apo regjistrimi e ndihme për kalim transit janë të shumta, në terren nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për të pasur mjedise të tilla. Duke pasur parasysh nevojën e bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare të specializuara në këtë fushë, transparencë më e madhe duhet në këtë drejtim për t'i lejuar publikut të gjerë dhe shoqërisë që të jenë të mirinformuar, çka do të sillte njëherazi edhe uljen e çdo mendimi diskriminues e ksenofobik. Fryma e solidaritetit dhe standardet e të drejtave të njeriut duhet të jenë në fokus të angazhimeve të lidershit politik dhe aksionit të përbashkët në ndërveprim të gjerë me shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare në fushën e të drejtave të njeriut. Këta partnerë kanë ekspertizë të vyer dhe instrumentet e mekanizmat të veprimit, që janë të domosdoshme për një impakt sa më të gjerë gjeografik dhe demografik.

Ndërsa vazhdimisht shihet një numër i madh njerëzish që përpiqen të kalojnë në territorin e disa vendeve të Bashkimit Evropian me çdo mjet, duke u mirëpritur për më tepër në këto vende, autoritetet shqiptare të azilit nuk ndjekin të njëjtin ritëm dhe kuptim me këto zhvillime. Personat që kapen duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin për të ardhur apo për t'u larguar nga Shqipëria, edhe pse janë qartësisht pjesë e këtyre flukseve, edhe pse kërkojnë në vijim mbrojtje nga Republika e Shqipërisë dhe janë qartësisht në kushtet e fitimit të kësaj mbrojtje, u mohohet tërësisht apo u shtyhet pa fund hyrja në procedurat e azilit. Kjo i lë ata tërësisht të zbuluar përballë rrezikut të vendimeve të gjykatave që nuk marrin parasysh nevojën e tyre për mbrojtje dhe pozitën e tyre specifike si refugjatë, çka çon së fundmi drejt kthimit në vendet nga kanë ardhur dhe shkeljen nga Shqipëria të parimit të moskthimit, non – refoulement. Kjo panoramë shfaqet në kohën kur në një kontekst rajonal e më gjerë të krizës mbetet shqetësim tepër i madh profilizimi i refugjatëve bazuar tek nacionaliteti dhe mosgarantimi i të drejtës së aksesit ndaj procedurave të azilit pa diskriminim. Kësaj problematike i shtohet edhe fakti që dështimi në zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar ka prekur gjerësisht grupet vulnerabël, pjesë të flukseve migratore, duke përfshirë këtu fëmijët, gratë, të moshuarit, viktimat e torturës, personat me aftësi të kufizuara, LGBTI etj. I gjithë ky proces duhet të garantojë dinjitetin njerëzor dhe të drejtat bazike, duke shmanhur kthimin në vende ku nuk garantohet siguria e tyre.

Në kontekstin e krizave të thella shoqërore dhe konflikteve të armatosura, institucioni i Avokatit të Popullit, si garantues dhe promotor i të drejtave dhe lirive themelore, të cilat përfaqësojnë tabanin e vlerave dhe parimeve të demokracisë, rendit ligjor dhe mirëqeverisjes, luan një rol të rëndësishëm në trajtimin konform standardeve të të huajve në Shqipëri. Për këtë qëllim, institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë (UNHCR), ka monitoruar në vijimësi Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe ka parë nga afër territoret të cilat shihen si të mundshme për të ngritur kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin transit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nga inspektimet në qendrat e pritjes e të ndalimit të përmendura më sipër është vënë re që kapaciteti i tyre në hapësirë dhe në burime financiare e njerëzore është i pamjaftueshëm, jo vetëm për raste të flukseve masive, por edhe për raste të rritjes graduale të numrit të azilkërkuesve, apo të migrantëve të parregullt në një kohë të shkurtër.

Po ashtu nga inspektimet në pikat e kalimit kufitar, si dhe në territoret e mundshme – kampe të pritjes apo të ndihmesës për kalimin transit të migrantëve, konfirmuar edhe nga burime të Policisë Kufitare, është konstatuar se ka shumë sfida që duhen tejkaluar – qoftë edhe në një kuadër emergjence, në mënyrë që ato të konceptohen si qendra funksionale jo vetëm për regjistrimin dhe ndihmesën shumë afatshkurtër ndaj personave në nevojë, por edhe si qendra rezidenciale që do të mundësojnë një qëndrim më afatgjatë të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në to.

Nga shpjegimet dhe parashikimet e bëra nga zyrtarë të policisë kufitare, nga informacionet e marra përmes medias si dhe nga informacionet nga vendet e tjera, është e qartë që një numër shumë i madh personash hyjnë çdo ditë në Greqi dhe prej andej nisen të kalojnë përmes vendeve të Ballkanit Perëndimor – përfshirë këtu potencialisht edhe Shqipërinë, për në vende të caktuara të Bashkimit Evropian. Në pjesën më të madhe të tyre ata janë qartësisht persona në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare e duhet të trajtohen si refugjatë, pavarësisht nëse ata kërkojnë të qëndrojnë në një vend të caktuar apo jo. Si rrjedhim, është e nevojshme që të ketë një mirëkuptim rajonal dhe evropian në lidhje me trajtimin humanitar të tyre. Theksojmë se qëllimi i tyre për të shkuar drejt disa vendeve të BE, nuk duhet të paragjykojë trajtimin që duhet t'u ofrohet, sidomos duke parë nevojën urgjente për ndihmë humanitare, por është pikërisht ky qëllim ai që duhet të jetë përcaktues në mënyrën se si duhet të konceptohen dhe ndërtohen qendrat e pritjes apo të profilizimit sipas rastit.

Duke mbajtur parasysh se:

1. Shqipëria e ka të pamundur të ndërtojë në një kohë të shkurtër kampe rezidenciale ku supozohet se personat në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare do të mund të jetonin për kohë të gjatë;
2. Ndihma ndërkombëtare për këtë qëllim do të donte kohë për të qenë efektive;
3. Kjo ndihmë dhe gjithçka tjetër është në një shkallë të rëndësishme e ndërvarur me prirjen e vazhdueshme të këtyre personave për të shkuar drejt vendeve të caktuara të BE; dhe se

4. Vendet e tjera të rajonit janë kufizuar deri më tani që të japin vetëm ndihmesë për kalimin transit të këtyre personave për në territorin e BE,

është e nevojshme që Republika e Shqipërisë të marrë masat e nevojshme për pritjen dhe trajtimin e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare që paraqiten në kufij apo kapen brenda territorit.

Trajtimi humanitar i refugjatëve dhe migrantëve është detyrim për çdo vend, po aq sa ç'është edhe njohja e të drejtave që u takojnë atyre nga aktet e sipërpërmendura.

Për sa më sipër u rekomandua:

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë të vazhdojë të nxisë nismat rajonale e më gjerë për të mundësuar bashkërendimin e trajtimit dhe të ofrimit të ndihmës në Ballkanin perëndimor. Kriza migratore me të cilën po përballen vendet e rajonit ka rrënjë të thella e nevojë për vendimmarrje politike, por edhe për një qasje thellësisht humane nga të gjithë vendimmarrësit e zbatuesit. Bashkëpunimi rajonal mes vendeve të ndryshme duhet të nxitet duke parë me interes jo vetëm kuotat për çdo vend, por edhe bashkërendim në regjistrimin, trajtimin dhe ofrimin e zgjidhjeve afatgjata për refugjatët. Zgjidhja më e mirë e krizës është vetëm zgjidhja e çështjeve në burimin e tyre ndaj edhe qeveria shqiptare duhet ta shohë këtë zgjidhje me përparësi e t'i përkushtojnë asaj të gjitha mjetet e duhura.
2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë të mundësojë së pari njohjen e këtyre personave para ligjit duke i pajisur ata me dokumentacionin bazë të nevojshëm për një sërë procesesh administrative që lidhen me statusin e tyre në territorin e saj, por që është edhe parakusht për të mundësuar një ndarje funksionale të ndihmës humanitare.
3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë të shpallë, në përputhje me Ligjin "Për Azilin në Republikës së Shqipërisë", njohjen e mbrojtjes së përkohshme për shkaqe të fluksit masiv për personat e ardhur nga vende me një sfond të përbashkët dhe botërisht të njohur persekutimi që përcakton gjasat që personat të jenë në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Është e paarsyeshme që procedurat standarde për përcaktimin e statusit të ndiqen për ta individualisht, si edhe për çdo të ardhur nga çdo vend tjetër.
4. Në rast të ngritjes së kampeve pritëse apo të transitit – ku për të gjithë faktorët e përmendur më lart është e qartë që ngritja e qendrave për një profilizim të përkohshëm dhe për lejimin e lëvizjes së lirë drejt vendeve të tjera mund realisht të jetë zgjidhje, të zbatohen me përpikëri standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.
5. Organet e drejtësisë dhe ato policore duhet të trajtojnë me kujdes fenomenin e personave që kapen duke u përpjekur të lënë territorin shqiptar me dokumente të falsifikuara në mënyrë të ndjeshme ndaj nevojave të tyre për mbrojtje ndërkombëtare, duke qenë se këta persona mund të jenë refugjatë. Ky këndvështrim duhet të ketë synim që të përcaktojë pozitën e tyre në kuadrin e flukseve migratore e atyre të përbëra nga persona në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare dhe veçimin nga trajtimi si rastet e tjera të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara. Trajtimi sikurse në rastin e dytë, jo vetëm rëndon gjendjen humanitare të personave, por edhe rrit edhe shpenzimet publike të Republikës së Shqipërisë, që detyrohet t'i mbajë ata të ndaluar në qendra të mbyllura ose institucione për ekzekutimin e vendimeve penale.

6. Të përforcohen me bazë materiale dhe me shërbime të përkthimit ekipet që kryejnë procedurën e përzgjedhjes së të huajve të parregullt në kufi, apo në drejtoritë rajonale të kufirit në mënyrë që të sigurohet mundësia që, çdo i huaj që gjendet në mënyrë të parregullt në territorin shqiptar, të kuptojë qartë të drejtat e veta dhe të shprehë qartësisht nëse kërkon azil në Republikën e Shqipërisë. Në një rast të tillë, të sigurohet lidhje e menjëhershme me autoritetet e azilit të Republikës së Shqipërisë.
7. Personat të cilëve u jepet urdhër largimi për t'u ekzekutuar prej tyre në mënyrë vullnetare, t'u lihet në dispozicion afati minimal i përcaktuar nga ligji për këtë qëllim duke mos u detyruar të largohen drejt territorit prej nga kanë hyrë në mënyrë të parregullt.
8. Të mundësohet i plotë monitorimi dhe vëzhgimi i pavarur i zbatimit të procedurës së përzgjedhjes si edhe kushtet e pritjes apo të ndihmesës humanitare në qendrat e tranzitit, nga pjesë të shoqërisë civile apo organizma të ndara nga pushteti ekzekutiv të tilla si UNHCR, IOM, etj.

## Aneks 1

### Aktiviteti i MKPT mbi Problematikën migratore 2015

Me qëllim ndjekjen e masave dhe politikave që po ndërmerren për çështjet e emigracionit, kthimin e shtetasve shqiptare pas emigrimit më të fundit në vendet e Evropës e të masave që po ndërmerren për riintegrimin e tyre, si dhe të masave të ndërmarra dhe procedurave të azilit, për azilkërkuesit potencialë nga shtetet e tjera zona aktuale të luftës, në vendin tonë, gjatë vitit 2015 janë kryer aktivitetet e mëposhtme:

1. Janë monitoruar proceset e riatdhesimit të vullnetshëm dhe të pavullnetshëm të shtetasve Shqiptarë nga vende të zonës Shengen.

NR.	INSTITUCIONI I INSPEKTUAR	QELIMI I INSPEKTIMIT	DATA E INSPEKTIMIT
1.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	29.01.2015
2.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	24.03.2015
3.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	28.05.2015
4.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit (vullnetar)	04.09.2015
5.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	15.09.2015
6.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	16.09.2015
7.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	01.10.2015
8.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	14.10.2015

Në këtë kuadër, MKPT ka marrë pjesë në procedurat e shoqërimit në avion të dy operacioneve të riatdhesimit të emigrantëve të paligjshëm nga zona Schengen me qëllimi monitorimin e procedurave të largimit nga territori vendeve anëtare të BE dhe vendeve të zonës Schengen të shtetasve shqiptarë për të cilët është dhënë vendim për riatdhesim si dhe monitorimin e respektimit të Kartës të Drejtave Themelore, dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të cilat sigurojnë respektimin e dinjitetit njerëzor të të gjithë personave pjesëmarrës në programin e riatdhesimit.

2. Janë monitoruar qendrat ku trajtohen të huajt e parregullt dhe azilkërkuesit/refugjatët në territorin e Shqipërisë si dhe në pikat kufitare të kalimit të tyre si dhe janë përgatitur e përcjellë rekomandimet përkatëse.



NR.	INSTITUCIONI I INSPEKTUAR	QËLLIMI I INSPEKTIMIT	DATA E INSPEKTIMIT
1.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	18.03.2015
2.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	19.03.2015
3.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	20.03.2015
4.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	24.03.2015
5.	Drejtoria e Policisë Kufitare Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
6.	Drejtoria e Policisë Kufitare Han i	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
7.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	17.09.2015
8.	Qendra Kombëtare Pritëse e	Vizitë Monitoruese	25.09.2015
9.	Drejtoria e Policisë Kufitare Korçë	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
10.	Pika Kufitare “Tre urat”	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
11.	Pika Kufitare “Qafë Botë”	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
12.	Pika Kufitare “Kakavijë” GOS	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
13.	Drejtoria Rajonale e Kufirit	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
14.	Drejtoria e Policisë Kufitare Kukës	Vizitë Monitoruese	20.10.2015
15.	Drejtoria e Policisë Kufitare Dibër	Vizitë Monitoruese	20.10.2015
16.	Drejtoria e Policisë Kufitare Vlorë	Vizitë Monitoruese	23.10.2015
17.	Komisariati i Policisë Rinas	Vizitë Monitoruese	10.12.2015

1. Janë mbajtur kontakte me përfaqësues të UNHCR-së, të përfaqësive diplomatike në Shqipëri, si dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë që operojnë në Shqipëri në fushën e të drejtave të njeriut me qëllim përditësimin me informacione dhe bashkërendimin e planeve të veprimit.
  - Takime të vazhdueshme të Avokatit të Popullit dhe MKPT me organizmat/përfaqësitë e huaja.
  - Është punuar me UNCHR për hartimin e fletëpalosjeve mbi të drejtat e azilkërkuesve dhe të refugjatëve.
  
2. Është punuar në drejtim të informimit të institucioneve dhe publikut mbi nivelin e trajtimit të shtetasve të kategorive të sipërpërmendura, në rrugë zyrtare përmes publikimit të rekomandimeve dhe raporteve vjetore si dhe përmes medias së shkruar dhe asaj audio-vizive.
  - Dërgimi i rekomandimeve specifike (p.sh., mbi grevën e urisë së të huajve në Qendrën e mbyllur Kareç);
  - Rekomandimet në përfundim të vizitave;
  - Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit 2014;
  - Raporti i Veçantë i MKPT 2014;
  - Konferencë për shtyp mbi Raportin e Veçantë të MKPT 2014;
  - Publikime të rekomandimeve në Revistën e Avokatit të Popullit;
  - Emission televizive ballafaques me pjesëmarrjen e Drejtorit të Përgjithshëm Migracionit Z. Merepeza, përfaqësues të grupit parlamentar për të drejtat e njeriut Znj. Vasilika Hysi dhe të Komisionerit të UNHCR-së Z. Hortenc Balla.

3. Është trajtuar çështja e shërbimeve shëndetësore në qendra gjatë ëorkshop-it të organizuar më datë 29-30 Qershor 2015 nga Institucioni i Avokatit të Popullit përmes MKPT-së me përfaqësues të grupit shëndetësor të Mekanizmave të Rrjetit të Evropës Jug-Lindore në Shqipëri si dhe të Drejtorisë së Migracionit dhe Kufirit, etj.
4. Është ngritur një grup pune ndër sektorial me qëllim ndjekjen e zhvillimeve dhe hartimin e materialeve për qëndrimin institucional.
5. Është dërguar më datë 08 Shtator 2015 pranë Presidentit të Komisionit Evropian një shkresë zyrtare mbi krizën migratore nga presidenti i Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut, AOM, Z. Totozani.
6. Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) dhe me mbështetjen e projektit “*Mbështetja e Danimarkës për Ombudsmanin e Popullit Shqiptar - Më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)*”, më datat 29 dhe 30 Tetor 2015, zhvilloi aktivitetin dy-ditor me temë: “Trajtimi i azilkërkuesve, refugjatëve dhe emigrantëve të rikthyer në Evropën Juglindore - Diskutime mbi shqetësimet e përbashkëta dhe standardet monitoruese”. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte të sillte së bashku përfaqësues të Mekanizmave Kombëtarë për Parandalimin e Torturës, organizatave të ndryshme ndërkombëtare si dhe autoriteteve shtetërore shqiptare për të diskutuar mbi sfidat e përbashkëta të monitorimit të standardeve të trajtimit migrantëve të parregullt dhe refugjatëve në vendet e Evropës Jug-Lindore e më gjerë në rajon. Në aktivitet, për të diskutuar dhe ndarë përvojat lidhur me trajtimin e azilkërkuesve, refugjatëve dhe emigrantëve të kthyer, morën pjesë ekspertë të mekanizmave kombëtarë nga shtetet e Austrisë, Bosnje-Hercegovinës, Francës, Hungarisë, Kosovës, Kroacisë, Mali të Zi, Maqedonisë, Serbisë, Sllovenisë, Shqipërisë, përfaqësues të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor ose Poshtëruar, apo Ndëshkimit (CPT), Nën-Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (SPT), Shoqatës për Parandalimin e Torturës (APT), Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional të Kufijve të Jashtëm të Vendeve Anëtare të Bashkimit Evropian (Frontex), Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për Kufirin dhe Migracionin në Shqipëri.

8.1 Aktiviteti i ditës së parë me titull “Sfida, shqetësime, dhe nevoja për standarde të përbashkëta monitorimi të Mekanizmave të Evropës Jug-Lindore në kontekstin e Migracionit”, u konceptua në formën e Ëorkshopit për t’u mundësuar Mekanizmave të diskutonin në tre grupe pune, përkatësisht mbi:

- Kushtet dhe trajtimin e personave të ndaluar:
  - o Dallimi thelbësor midis monitorimit të burgjeve dhe paraburgimeve ku ndodhen emigrantët;
  - o Rëndësia e zhvillimit të një grupi gjithëpërfshirës të standardeve specifike të paraburgimit dhe strategjitë e monitorimit;
  - o Asistenca ligjore;
  - o Shërbimet shëndetësore;

- Personat në situata vulnerabël apo me nevoja të veçanta;
    - Viktimat e trafikimit;
    - Fëmijët dhe të moshuarit; etj.
  - Kushtet materiale;
  - Siguria dhe rendi.
- Praktikak e monitorimit të operacioneve të riadhesimit:
    - Monitorimi i procesit të kthimit të emigrantëve nga toka, deti dhe ajri;
    - Sfidat në qasjen e unifikuar konform standardeve gjatë monitorimit.
    - Praktikak më të mira në monitorimin e operacioneve të rikthimit;
  - Metodologjinë e monitorimit:
    - Vendosja e piketave të monitorimit;

Në përmbyllje të workshopit, bazuar mbi diskutimet e bëra rreth praktikave të mira të monitorimit, u konkludua mbi një qasje të përbashkët ndaj shqetësimeve kryesore të hasura gjatë punës së Mekanizmave në terren në përmbyllje të misionit të tyre.

8.2. Aktiviteti i ditës së dytë me titull “Drejt standardeve të përbashkëta të monitorimit të trajtimit të Azilkërkuesve, Refugjatëve dhe Emigrantëve të paligjshëm në Evropën Jug-Lindore”, u konceptua në formën e Konferencës, dhe u drejtua nga Ombudsmeni Shqiptar. Gjatë saj u diskutua mbi:

- Qasjen shqiptare ndaj krizës migratore;
- Rezultatet e Ëorkshopit të mekanizmave mbi shqetësimet e përbashkëta dhe standardet e unifikuara monitoruese;
- Udhëzimet e Këshillit të Evropës për trajtimin e migrantëve dhe azilkërkuesve;
- Rolin e Mekanizmave në krizën e refugjatëve dhe migrantëve të parregullt;
- Monitorimin e vendeve të privimit nga liria, ku mbahen e trajtohen migrantët e parregullt;
- Lidhjen midis flukseve të parregullta migratore dhe mbrojtjen e refugjatëve;
- Rëndësinë e një qasje ndër-dimensionale ndaj çështjes së migracionit;
- Rolin e Mekanizmave në trajtimin e migrantëve dhe refugjatëve në Evropë, në paraburgime, në qendrat e mbyllura apo akomodimit të tyre në kampe kolektive.
- Asistenca dhe nevoja për monitorim të jashtëm të pavarur.

**Aneks 2**

**TABELA E INSPEKTIMEVE TË KRYERA NGA MKPT GJATË VITIT 2015  
BAZUAR NË PLANIN VJETOR TË INSPEKTIMEVE**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI I INSPEKTUAR</b>	<b>QËLLIMI I INSPEKTIMIT</b>	<b>DATA E INSPEKTIMIT</b>
1.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	29.01.2015
2.	I.E.V.P. Vaqar	Vizitë Monitoruese	24.02.2015
3.	Shërbimi i Psikiatrisë pranë QSU "Nënë	Vizitë Monitoruese	04.03.2015
4.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	18.03.2015
5.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	19.03.2015
6.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	20.03.2015
7.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	24.03.2015
8.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	24.03.2015
9.	Instituti i të Miturve Kavajë	Vizitë Monitoruese	26.03.2015
10.	I.E.V.P Durrës	Vizitë Monitoruese	09.04.2015
11.	I.E.V.P " Mine Peza" (302)	Vizitë Monitoruese	21.04.2015
12.	I.E.V.P Zahari, Krujë	Vizitë Monitoruese	04.05.2015
13.	I.E.V.P. Drenovë, Korçë	Vizitë Monitoruese	07.05.2015
14.	I.E.V.P " Ali Demi" (325), Tiranë	Vizitë Monitoruese	15.05.2015
15.	I.E.V.P Peqin	Vizitë Monitoruese	27.05.2015
16.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	28.05.2015
17.	Drejtoria e Policisë Vendore Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
18.	Komisariati i Policisë Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
19.	Komisariati i Policisë Shijak	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
20.	Drejtoria e Policisë Kufitare Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
21.	Komisariati i Policisë Krujë	Vizitë Monitoruese	29.05.2015
22.	Drejtoria e Policisë Vendore Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
23.	Komisariati i Policisë Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
24.	Komisariati i Policisë Malësi e Madhe	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
25.	Drejtoria e Policisë Kufitare Han i Hotit,	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
26.	Spitali Psikiatrik Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
27.	Komisariati i Policisë Pukë	Vizitë Monitoruese	03.06.2015
28.	Reparti Ushtarak 1010 Vau i Dejës	Vizitë Monitoruese	03.06.2015
29.	Komisariati i Policisë Mirditë	Vizitë Monitoruese	10.06.2015
30.	I.E.V.P Shën Koll Lezhë	Vizitë Monitoruese	11.06.2015
31.	Drejtoria e Policisë së Vendore Lezhë	Vizitë Monitoruese	12.06.2015
32.	Komisariati i Policisë Lezhë	Vizitë Monitoruese	12.06.2015
33.	Komisariati i Policisë Laç	Vizitë Monitoruese	12.06.2015
34.	Drejtoria e Policisë Vendore Dibër	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
35.	Komisariati i Policisë Peshkopi	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
36.	Komisariati i Policisë Burrel	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
37.	Komisariati i Policisë Bulqizë	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
38.	I.E.V.P. Kukës	Vizitë Monitoruese	16.06.2015
39.	I.E.V.P. Tropojë	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
40.	Drejtoria e Policisë Vendore Kukës	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
41.	Komisariati i Policisë Kukës	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
42.	Komisariati i Policisë Has	Vizitë Monitoruese	17.06.2015

43.	Komisariati i Policisë Tropojë	Vizitë Monitoruese	18.06.2015
44.	I.E.V.P. "Mine Peza", Tiranë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
45.	Institucioni i Veçantë Shëndetësor i	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
46.	I.E.V.P. "Ali Demi", Tiranë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
47.	I.E.V.P. Durrës	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
48.	I.E.V.P. Rrogozhinë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
49.	I.E.V.P. Peqin	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
50.	I.E.V.P. Elbasan	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
51.	Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë	Hetim	30.06.2015
52.	Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë	Hetim	01.07.2015
53.	I.E.V.P. Peqin	Hetim	08.07.2015
54.	I.E.V.P. "Shën Koll", Lezhë	Hetim	13.07.2015
55.	I.E.V.P. Fier	Hetim	16.07.2015
56.	I.E.V.P. "Mine Peza", Tiranë	Hetim	21.07.2015
57.	I.E.V.P. "Mine Peza", Tiranë	Hetim	22.07.2015
58.	I.E.V.P. "Mine Peza", Tiranë	Hetim	24.07.2015
59.	I.E.V.P. "Shën Koll", Lezhë	Hetim	27.07.2015
60.	I.E.V.P. Zahari, Krujë	Hetim	30.07.2015
61.	Komisariati i Policisë Shkodër	Hetim	08.08.2015
62.	I.E.V.P. Drenovë, Korçë	Hetim	12.08.2015
63.	Komisariati i Policisë Pogradec	Hetim	17.08.2015
64.	Komisariati i Policisë Nr. 5, Tiranë	Hetim	25.08.2015
65.	Komisariati i Policisë Kuçovë	Vizitë Monitoruese	02.09.2015
66.	Komisariati i Policisë Çorovodë	Vizitë Monitoruese	02.09.2015
67.	Drejtoria e Policisë Vendore Berat	Vizitë Monitoruese	02.09.2015
68.	Komisariati i Policisë Berat	Vizitë Monitoruese	03.09.2015
69.	IEVP Berat	Vizitë Monitoruese	03.09.2015
70.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riadhesimit	04.09.2015
71.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riadhesimit	15.09.2015
72.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riadhesimit	16.09.2015
73.	Qendra e Azilkërkuesve, Babrru	Vizitë Monitoruese	17.09.2015
74.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	17.09.2015
75.	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të	Vizitë Monitoruese	25.09.2015
76.	I.E.V.P Burrel	Vizitë Monitoruese	28.09.2015
77.	Drejtoria e Policisë Kufitare Korçë	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
78.	Komisariati i Policisë Devoll	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
79.	Komisariati i Policisë Ersekë	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
80.	Drejtoria e Policisë Vendore Korçë	Vizitë Monitoruese	01.10.2015
81.	Komisariati i Policisë Korçë	Vizitë Monitoruese	01.10.2015
82.	Komisariati i Policisë Pogradec	Vizitë Monitoruese	01.10.2015
83.	I.E.V.P Tepelenë	Vizitë Monitoruese	05.10.2015
84.	Komisariati i Policisë Përmet	Vizitë Monitoruese	05.10.2015
85.	Pika Kufitare "Tre urat"	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
86.	I.E.V.P Sarandë	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
87.	Komisariati i Policisë Sarandë	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
88.	Komisariati i Policisë Delvinë	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
89.	Pika Kufitare "Qafë Botë"	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
90.	Drejtoria e Policisë Vendore Gjirokastër	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
91.	Komisariati i Policisë Gjirokastër	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
92.	Drejtoria Rajonale e Kufirit Gjirokastër	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
93.	Komisariati i Policisë Tepelenë	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
94.	I.E.V.P Fier	Vizitë Monitoruese	09.10.2015
95.	Komisariati i Policisë Peqin	Vizitë Monitoruese	14.10.2015

96.	Komisariati i Policisë Gramsh	Vizitë Monitoruese	14.10.2015
97.	Komisariati i Policisë Librazhd	Vizitë Monitoruese	14.10.2015
98.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	14.10.2015
99.	IEVP Elbasan	Vizitë Monitoruese	15.10.2015
100.	Spitali Psikiatrik Elbasan	Vizitë Monitoruese	16.10.2015
101.	Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan	Vizitë Monitoruese	16.10.2015
102.	Komisariati i Policisë Elbasan	Vizitë Monitoruese	16.10.2015
103.	I.E.V.P. Rrogozhinë	Vizitë Monitoruese	21.10.2015
104.	Drejtoria e Policisë Kufitare Kukës	Vizitë Monitoruese	20.10.2015
105.	Drejtoria e Policisë Kufitare Dibër	Vizitë Monitoruese	20.10.2015
106.	I.E.V.P Vlorë	Vizitë Monitoruese	22.10.2015
107.	Drejtoria e Policisë Vendore Vlorë	Vizitë Monitoruese	22.10.2015
108.	Komisariati i Policisë Vlorë	Vizitë Monitoruese	22.10.2015
109.	Spitali Psikiatrik Vlorë	Vizitë Monitoruese	23.10.2015
110.	Drejtoria e Policisë Kufitare Vlorë	Vizitë Monitoruese	23.10.2015
111.	Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë	Hetim	02,03.11.2015
112.	Drejtoria e Policisë Vendore Fier	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
113.	Komisariati i Policisë Fier	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
114.	Komisariati i Policisë Lushnje	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
115.	Komisariati i Policisë Mallakastër	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
116.	IEVP Kosovë- Lushnje	Vizitë Monitoruese	11.11.2015
117.	Policia Ushtarake Sauk, Tiranë	Vizitë Monitoruese	18.11.2015
118.	Komisariati i Policisë Nr.3, Tiranë	Vizitë Monitoruese	19.11.2015
119.	Komisariati i Policisë Nr.5, Tiranë	Vizitë Monitoruese	19.11.2015
120.	Komisariati i Policisë Nr.1, Tiranë	Vizitë Monitoruese	23.11.2015
121.	Komisariati i Policisë Nr.4, Tiranë	Vizitë Monitoruese	23.11.2015
122.	Komisariati i Policisë Nr.2, Tiranë	Vizitë Monitoruese	24.11.2015
123.	IVSHB Tiranë	Vizitë Monitoruese	25.11.2015
124.	IEVP "Ali Demi" (325)	Hetim	07.12.2015
125.	Komisariati i Policisë Nr.5, Tiranë	Hetim	10.12.2015
126.	Komisariati i Policisë Nr.6, Tiranë	Hetim	10.12.2015
127.	Komisariati i Policisë Rinas	Vizitë Monitoruese	10.12.2015
128.	IEVP Berat	Vizitë Monitoruese	14.12.2015
129.	IEVP "Jordan Misja"	Vizitë Monitoruese	15.12.2015
130.	IEVP Fushë-Krujë	Vizitë Monitoruese	28.12.2015